

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E enjte, 15 shtator 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes.

8 Znj. Sekretare e Seancës, a mund të thërrisni çështjen ju
9 lutem.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i
12 Specializuar kundër Salih Mustafës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, Sekretare.

15 Së pari, do shohim kush është i pranishëm në sallë.

16 Ju lutem, z. Prokuror, a mund të thoni kush është i
17 pranishëm nga Zyra e Prokurorisë së Specializuar.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

19 Gjykatës. Mirëmëngjes, të gjithëve brenda dhe jashtë sallës së
20 gjyqit.

21 ZPS-ja sot përfaqësohet nga Jack Smith, Prokuror i

22 Specializuar; Prokurorët Silvia d'Ascoli dhe Prokurori

23 Fillippo De Minicis; gjithashtu edhe Julie Mann, që është

24 Menaxherja e Çështjes; dhe unë jam Cezary Michalczuk, Prokuror

25 i ZPS-së.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Mbrojtësja e Viktimave.

4 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Mirëmëngjes, të
5 gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje sot
6 përfaqësohen ashtu siç edhe dje, nga Jack Provan; nga
7 Ndihmësja Ligjore, Brechtje Vossenberq; dhe unë jam Anni Pues,
8 Mbrojtësja e Viktimave.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 Mbrojtja.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse.
13 Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius Von Bone; nga z. Betim
14 Shala, që është bashkëavokat; z. Fatmir Pelaj, hetues dhe
15 përkthyes. Dhe z. Mustafaj na ndjek me videolidhje.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Për procesverbal, kjo çështje zhvillohet përpara Trupit
19 Gjykses I.

20 Të martën dhe të mërkurën ne dëgjuam deklaratat mbyllëse
21 nga ZPS-ja dhe nga Avokatja e Viktimave dhe pjesërisht edhe
22 parashtrimet e Mbrojtjes. Sot do të vazhdojmë me deklaratat
23 përmbyllëse të Mbrojtjes.

24 Përpara sesa ta bëjmë këtë, dëshiroj t'ju them diçka
25 juve, i nderuar Avokat. Dje, neve bëmë një redaktim në Gjykatë

1 dhe do të doja t'ju kërkoja që të jeni të kujdesshëm sa i
2 takon kësaj çështjeje. Në qoftë se ka informacion i cili mund
3 të çojë në identifikimin e dëshmitarëve të mbrojtur, ju lutem,
4 kërkon që të kalojmë në seancë private, në mënyrë të tillë që
5 çështje të tillë të mund t'i diskutojmë në seancat që janë
6 private.

7 E shoh që po tundni kokën në shenjë pohimi.

8 Ju thatë dje që do ju nevojitet rreth një orë e gjysëm
9 ose ndoshta edhe më pak, për të përfunduar me parashtrimet
10 tuaja, por që do përfundoni gjithsesi, domethënë, deri në
11 pushimin e parë të kafes. Megjithatë, në qoftë se keni nevojë
12 për më tepër kohë, ju lutem na thoni.

13 Fjala është për ju tani.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar
15 Gjykatëse. Unë e rishikova dokumentacionin të cilin desha të
16 sqaroj sot dhe do të mundohem që pjesën më të madhe të
17 parashtrimeve ta bëj në seanca publike. Megjithatë, ndonjëherë
18 do të duhet të kalojmë në seancat private në mënyrë që të
19 shpjegojmë gjëra të caktuara. Shumë faleminderit.

20 Mbrojtja tani dëshiron që të trajtojë çështjen e torturës
21 së pretenduar të shtatë individëve.

22 Të nderuar Gjykatës, tortura parashikohet në nenin
23 14(1)(c)(i) të Ligjit. Krimi i luftës i torturës në asnjë
24 mënyrë nuk është i përcaktuar, nuk është i përkufizuar në
25 ligjin e Dhomave të Specializuara. Ai vetëm përmendet pranë

1 gjyktimit dhe trajtimit mizor.

2 Në mënyrë që të mos përsëris veten, të nderuar Gjykatës,
3 Mbrojtja rithekson qëndrimin e saj sa i takon përshkrimit dhe
4 mënyrës sesi e konsideron konfliktin e armatosur si dhe
5 gjërave të cilat ne i kemi thënë dhe dje lidhur me personat e
6 mbrojtur të cilat përcaktohen në nenin e përbashkët 3 të
7 Konventave të Gjenevës.

8 Mbrojtja ka qëndrimin që, në qoftë se individët bien në
9 fushën e veprimit të personave të mbrojtur, është e njëjtë me
10 diskutimin që ne bëmë dje. Dhe në këtë linjë, ne kemi theksuar
11 dhe më përpara që këto individë nuk gëzojnë mbrojtjen për
12 personat që parashikohen sipas nenit 14 të Konventës së
13 Gjenevës të 1949.

14 Qëndrimi i përgjithshëm i Mbrojtjes lidhur me këtë krim
15 është si më poshtë.

16 Mbrojtja ka qëndrimin që z. Mustafa nuk e ka kryer këtë
17 krim. Kaq është e thjeshtë është gjëja. Ai nuk ka qenë në
18 dijeni të faktit që këta persona në fakt janë mbajtur të
19 ndaluar apo për çfarë arsyesh ata mund të kenë qenë të
20 ndaluar. Ai nuk e di se ku janë mbajtur të ndaluar këta
21 persona. Ai nuk ka urdhëruar dhe as nuk ka nxitur krime të
22 tilla. Z. Mustafa nuk ka kryer asnjë torturë përmes formave të
23 përgjegjësisë penale, siç ato dëshmohen nga ZPS-ja.

24 Nuk ka asnjë provë që provon ndonjë mosveprim nga ana e
25 tij dhe dëshmon që tortura është kryer ndaj këtyre personave.

1 Kështu që nuk ka kryerje përmes mosveprimit.

2 Siç e kemi diskutuar dhe më përpara, ai madje as nuk i
3 njeh fare tre nga katër individët që diskutuam. Individit i
4 katërt, është 03594 është një person që e njihte disi.
5 Megjithatë, dëshmitar 3594 deklaroi se ai nuk e ka parë
6 asnjëherë në terren Salih Mustafën atje. Dhe në qoftë se 03594
7 do ta kishte parë Salih Mustafën do ta kishte thënë një gjë të
8 tillë. Kjo doli shumë e qartë në dëshminë e dhënë përpara
9 Gjykatës. Siç e formuloi ai: "Edhe po të kishte qenë vëllai
10 im, nuk do ta kisha mbrojtur atë".

11 Do diskutojmë tani për krimin e torturës. Konventa kundër
12 torturës dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore dhe
13 degraduese apo dënime të kësaj natyre është hartuar në vitin
14 1984 dhe ka hyrë në fuqi në 1987. Përkufizimi i krimit të
15 torturës ndryshon në Konventën mbi Torturën nga mënyra sesi
16 kjo veprë kuptohet në nenet e përbashkëta 3 të Konventave të
17 Gjenevës.

18 Konventat e Gjenevës dhe Protokollet shtesë të tyre nuk e
19 përkufizojnë torturën. TPNJ-ja e përkufizon torturën, për
20 qëllime të së drejtës humanitare në mënyrën e mëposhtme:

21 "Për krimet e torturës, në mënyrë që të vërtetohen krimet
22 e torturës, pavarësisht në qoftë se ato janë si pjesë e
23 krimeve të luftës apo të krimeve kundër njerëzimit, duhen të
24 përmbushen elementet e më poshtëm:

25 (1) Duhet të ketë veprim ose mosveprim që ka çuar në

1 dhimbje dhe vuajtje ose fizike ose mendore;

2 (2) Veprimi ose mosveprimi duhet të jenë të qëllimshëm;
3 dhe

4 (3) Veprimi ose mosveprimi duhet të jetë kryer me një
5 qëllim konkret të tillë, si për shembull, për të marrë
6 informacion ose për të dhënë një deklaratë për të dënuar, për
7 të shtrënguar, për të kërcënuar viktimat ose një palë të tretë
8 ose për të diskriminuar për çfarëdolloj arsyeje kundër
9 viktimës ose një personi të tretë.”

10 Kjo jepet në paragrafin 235 të çështjes Limaj.

11 Sa i takon trajtimit mizor, TPNJ-ja ka përdorur
12 përkufizimin e mëposhtëm.

13 Në të njëjtën çështje, pra, në çështjen Limaj, në
14 paragrafin 231, ajo ka arritur në përfundimin që:

15 “Trajtimi mizor, sipas nenit 3 të Statutit, përkufizohet
16 si një veprim i qëllimshëm ose mosveprim i qëllimshëm që
17 shkakton vuajtje ose lëndim mendor ose fizik ose përbën një
18 sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor ndaj një personi i cili
19 nuk merr pjesë aktive në luftime”.

20 Sa i takon parimit *mens rea*, ajo mbërrin në përfundim në
21 të njëjtën çështje që:

22 “Sa i takon *mens rea*, kryesi duhet të ketë vepruar me
23 synimin e drejtpërdrejtë për të kryer trajtim mizor ose me
24 synim të tërthortë, domethënë, që ketë pasur dijeni për
25 trajtimin mizor dhe kjo të ishte një pasojë e mundshme e

1 veprimet ose mosveprimet të tij”.

2 Konventa Kundër Torturës e vitit 1987 e përkufizon
3 torturën si më poshtë:

4 “Për qëllimet e kësaj Konvente, termi ‘torturë’ do të
5 thotë çdo veprim përmes së cilës është shkaktuar vuajtje ose
6 lëndim fizik ose mendor në mënyrë të qëllimshme mbi një person
7 ...”

8 Pra, këtu e kam përfunduar unë përkufizimin sepse
9 përkufizimi vazhdon më tej, por për qëllimet e diskutimeve
10 tona kaq na mjafton.

11 Ka një dallim ndërmjet trajtimit mizor dhe torturës. Dhe
12 dallimet janë në dy aspekte. Dhimbja e shkaktuar dhe nga ana
13 tjetër qëllimi për të cilin është shkaktuar dhimbja. Në
14 përkufizimin e nenit të përbashkët 3 të Konventës së Gjenevës,
15 sipas komentarit të KNKK-së, trajtimi mizor shkakton dhimbje
16 të rëndë mbi një person tjetër. Edhe pse nuk ka një përkufizim
17 në nenet e përbashkëta 3 të Konventave të Gjenevës sa i takon
18 torturës dhe komentarit përkatës që e përmenda më lart dhe ky
19 komentari, komentari KNKK-së, nuk duket sikur ka një përcaktim
20 specifik, megjithatë, është e rëndësishme që dhimbja të jetë e
21 rëndë.

22 Dhe për këtë qëllimi është i thjeshtë. Dhe për këtë arsye
23 Mbrojtja i drejtohet Konventës së Torturës. Në Konventën e
24 Torturës, ashtu siç edhe në nenin e përbashkët të konventave
25 të Gjenevës, sa i takon dhimbjes së shkaktuar, kryesi duhet të

1 ketë shkaktuar një dhimbje të rëndë.

2 Sa i takon trajtimit mizor, dhimbja e shkaktuar duhet të
3 jetë e rëndë. Pra, ka një standard të ndryshëm sa i takon
4 dhimbjes së shkaktuar. Kriteret lidhur me dallimet ndërmjet dy
5 llojeve të ndryshme të dhimbjes së shkaktuar mund të jenë
6 kohëzgjatja, shpeshtësia, përdorimi i instrumenteve të
7 caktuara, numri i kryesve, pavarësisht në qoftë se bëhet fjalë
8 për një veprim të vetëm ose në qoftë se shkaktimi i dhimbjes
9 është përsëritës, pavarësisht në qoftë se kjo ndodhë gjatë
10 ditës ose gjatë natës. Këta faktorë, të paktën në një formë
11 kombinimi me njëri-tjetrin mund të shkaktojnë dhimbje të rëndë
12 dhe jo domosdoshmërisht dhimbje serioze mbi një person.

13 Ne i kemi mbuluar disa prej këtyre faktorëve kur kemi
14 folur dje rreth trajtimit mizor. Dje kur fola, të nderuar
15 Gjykatës, unë kalova njëri pas tjetrit të gjithë individët që
16 kishin deklaruar që kishin vuajtur një dhimbje të tillë.
17 Kështu që jemi të qartë se çfarë dëshmie kanë dhënë
18 dëshmitarët lidhur me këtë.

19 Dallimi i dytë është që në rastin e torturës, dhimbja e
20 rëndë fizike dhe mendore ose vuajtja fizike dhe mendore e
21 rëndë mbi një ose më shumë persona duhet, shkaktohet për një
22 qëllim të caktuar. Një qëllim i tillë ndërmjet të tjerave
23 duhet të jetë marrja e informacionit ose bërja e një rrëfimi,
24 dënimi, frikësimi, shtrëngimi ose arsye të tjera të
25 mbështetura mbi diskriminimet e çfarëdolloj natyre.

1 Qëllimi i posaçëm. Të nderuar Gjykatës, kur shikojmë
2 dosjen përfundimtare të gjykimit të ZPS-së, ne besojmë se ZPS-
3 ja parashikon dhe përdor të njëjtin përkufizim atë të torturës
4 të krimit të torturës siç ai kuptohet dhe përkufizohet në
5 Konventën e Gjenevës. Menjëherë pas paragrafit 307, në dosjen
6 e vet përfundimtare, ZPS-ja rendit qëllimet për të cilat
7 shkaktimi i dhimbjes ose vuajtjes së rëndë ndodh dhe këtu
8 rendit qëllimet e marrjes së informacionit, ndëshkimin dhe
9 shtrëngimit ose frikësimit.

10 Të nderuar Gjykatës, Mbrojtja parashtron se nuk ka prova
11 për qëllim specifik, për qëllim të posaçëm, siç parashikohet
12 në përkufizimin e torturës, qoftë në përkufizimin e konventës,
13 por, gjithashtu edhe në elementet e Gjykatës Penale
14 Ndërkombëtare për Krimin apo edhe standardet të cilat janë
15 zbatuar më parë nga TPNJ-ja. Në këtë rast ky element nuk është
16 i pranishëm, thjeshtë nuk ekziston.

17 Nuk ka prova për këto qëllime. Dëshmitari 1679, siç na ka
18 thënë vetë, është akuzuar për diçka që: ka qenë spiun.
19 Megjithatë, nuk del asnjë qëllim i veçantë i tij sa i takon
20 qëllimit që ka të bëjë me çështjen që po trajtojmë ne. Në
21 fakt, shumë pak pyetje u bënë. Pyetjet që ai mori ose që ju
22 bënë atij ishin të përgjithshme në natyrë. Për shembull, Kush
23 jeni ju?, ishte një pyetje. Cili jeni? Pse jeni këtu? Një
24 pyetje tjetër. Ose pse po gënjeni? Ose më thoni se pse jeni
25 këtu? Është deklarata datë 4 tetor faqet 867 dhe 868 e

1 transkriptit.

2 Pyetjet tregojnë qartë që nuk ka pasur asnjë qëllim të
3 veçantë. Për rrjedhojë, ne mund të themi që nuk ka pasur, nuk
4 ka ekzistuar, qëllimi i posaçëm që është synuar nga çdokush që
5 mund t'i ketë bërë këto pyetje.

6 Dëshmitari 03593, me ç'na tha vetë, ishte i akuzuar për
7 diçka; akuzohej se kishte qenë bashkëpunëtor. Ai u pyet dhe e
8 kam fjalën për 03593, në qoftë se i njihte se kush ishin
9 hajnat. Kjo është deklarata e datës 20 shtator 2021, faqja
10 409, 410 si edhe faqja 438.

11 Tani, të nderuar Gjykatës, një akuzë nuk do të thotë se
12 ekzistojnë qëllime të posaçme të një kryesi. Është thjesht një
13 dyshim ose një akuzë ajo që mund të bëhet. Nuk mund të arrihet
14 në konkluzion nga një koment i tillë që një deklaratë e tillë
15 ka pasur një synim të caktuar ose është bërë për një qëllim të
16 posaçëm.

17 Sa i takon pyetjes nëse ai i njihte hajnat, njihte ndonjë
18 hajn, kjo pyetje në vetvete nuk çon në qëllim të posaçëm që
19 renditet në titullin e paragrafit të dosjes përfundimtare të
20 ZPS-së. Nuk mund të mbërrihet në përfundimin se kjo lloj
21 pyetjeje e ka për qëllim të marrë informacione relevante ose
22 që ka për synim që të ndëshkojë, të frikësojë apo të
23 shtrëngojë dikë.

24 Dëshmitari 3594 është dëshmitari tjetër dhe ky dëshmitar,
25 3594, në dëshminë e vet, nuk ishte akuzuar për asgjë. Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 11

1 deklaratën e dhënë, ai vetë spekuloi rreth arsyeve të
2 arrestimit dhe ndalimit të tij. Ai spekulon lidhur me këtë
3 vetëm thjesht për faktin se asnjëherë nuk është thënë sepse
4 është ndaluar. Në qoftë se do ta lexojmë me kujdes
5 transkriptin do të kuptojmë që, në fakt, ai nuk ka thënë asgjë
6 për ndonjë lloj pyetjeje që i është bërë atij gjatë bisedës -
7 ZPS-ja e quan këtë marrje në pyetje - gjatë diskutimeve në
8 dhomë që ai i përshkroi në mënyrë të drejtpërdrejtë në katin e
9 epërm të stallës nga ku është mbajtur.

10 Transkripti lexon si më poshtë. Pyetje:

11 "A mendoni se [REDAKTUAR] dhe ti
12 na the që ke qenë pjesë e [REDAKTUAR]
13 [REDAKTUAR] ka pasur ndonjë
14 lidhje me arrestimin tuaj?

15 Dhe përgjigja është:

16 "Unë mendoj, kam ca dyshime që mbase kjo është një prej
17 arsyeve sepse më kanë burgosur".

18 Pyetja tjetër është kjo:

19 "Pse [REDAKTUAR] mund të ishte një arsye e
20 mundshme për arrestimin tënd? Nuk e di në qoftë se mund të na
21 e shpjegoni neve dhe Trupit Gjykes se çfarë ju bën juve ta
22 besoni këtë"

23 Dhe përgjigja e dëshmitarit është kjo:

24 "Po. Arsyeja për këtë është se [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]. Pra, kjo nuk ishte një prej arsyeve që mua
4 mu dha ndërkohë që isha i ndaluar në Zllash, megjithatë mund
5 të ketë qenë një prej arsyeve sepse me dërguan mua atje”.

6 Kjo është deklarata e datës 13 tetor, në faqen 1169 të
7 transkriptit.

8 Gjatë bisedës që Dëshmitari 03594 ka pasur me njerëzit në
9 dhomë, ai nuk dha specifikisht, nuk përmendi specifikisht
10 ndonjë pyetje që i ishte bërë atje. Për rrjedhojë, mbështetur
11 në dëshminë e këtij dëshmitari, nuk mund të vërtetohet se ai,
12 në fakt, është marrë në pyetje fare, as nuk mund të vërtetohet
13 se ndonjë pyetje do të ishte bërë atij për ndonjë qëllim të
14 posaçëm siç listohet në titullin e paragrafit të dosjes
15 përfundimtare të ZPS-së.

16 Për rrjedhojë, nuk mund të mbërrihet në përfundimin që
17 kjo lloj pyetjeje ka si synim që të marrë një informacion ose
18 që synohet që të ndëshkojë, që të shtrëngojë ose të frikësojë
19 dikë.

20 Kalojmë tek dëshmitari tjetër, të nderuar Gjykatës. Ky
21 dëshmitar është 04669.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Avokat, dëshirojmë që të kalojmë në seancë private për një
24 moment.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë private)

Faqe 13

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, ju lutem a mund të na kaloni në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 jemi kthyer sërish në seancë publike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 14

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Avokat, keni fjalën tani.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Jemi ende në seancë private?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
5 nuk jemi në seancë private.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë atëherë. Në këtë rast do të
7 kërkoja që të kalonim në seancë private.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike tani.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi
23 në seancë publike tani. Avokat, e keni fjalën ju.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit.

25 Personi i paidentifikuar 1 nuk është identifikuar apo nuk

1 është dëgjuar përpara Gjykatës, kështu që nuk kemi prova
2 lidhur me faktin në qoftë se atij i është bërë ndonjë pyetje
3 për ndonjë qëllim të posaçëm. Viktima e pretenduar e vrasjes
4 në këtë çështje nuk është dëgjuar përpara Gjykatës, nuk ka
5 dhënë dëshmi përpara Gjykatës, kështu që nuk kemi asnjë provë
6 sa i takon faktit në qoftë se atij i është bërë ndonjë pyetje
7 për ndonjë qëllim të posaçëm. Dëshmia e dhënë nga 01679 ka të
8 bëjë vetëm me atë se çfarë ishte akuzuar viktima i pretenduar
9 i vrasjes, por jo në qoftë se atij i është bërë ndonjë pyetje
10 që i ka shërbyer për ndonjë qëllim të posaçëm.

11 Dëshmitari 1679 tha vetëm diçka lidhur me atë për të
12 cilën viktima akuzohej, por asgjë lidhur me pyetjet që mund
13 t'i ishin bërë atij.

14 Dhe 3594, lidhur me të njëjtin person, tha që atë e
15 quanin hajn.

16 Tani kalojmë tek personi i paidentifikuar 2. Personi i
17 paidentifikuar 2 nuk ka dhënë asnjëherë dëshmi në Gjykatë, nuk
18 është dëgjuar në Gjykatë, kështu që nuk kemi fare prova lidhur
19 me faktin në qoftë se atij i është bërë ndonjë pyetje apo jo
20 për qëllime të posaçme. Në bazë të dëshmisë të asaj çfarë
21 kishte dëgjuar 06179 [sipas përkthimit] ai ishte akuzuar për
22 diçka, domethënë, që ishte hajn, që ishte spiun. Edhe njëherë,
23 e vetmja gjë që mund të thuhet për këtë pëson është kjo,
24 domethënë, do të dua që të përsëris atë çfarë thashë më
25 përpara, që akuza e asnjë natyre nuk mund të çojë në qëllim të

1 posaçëm që dikush do të shkaktonte dhimbje këtij personi.

2 Për rrjedhojë, nuk mund të mbërrihet në përfundimin që
3 për çdo person që mund të ketë qenë i ndaluar, janë bërë
4 pyetje për qëllime të posaçme. Për rrjedhojë nuk ka prova
5 lidhur me këtë pikë.

6 Sa i takon akuzave që pretendohet të jenë bërë, për shkak
7 të natyrës së tyre të përgjithshme, nuk mund të lidhet një
8 qëllim i veçantë me to. Nuk mund të thuhet ose nuk mund të
9 nënkuptohet që natyra e përgjithshme e pyetjeve ose e akuzave
10 shërben si qëllim për të marrë një lloj informacioni konkret
11 ose një informacion tjetër. Në qoftë se dikush bën pyetjen,
12 "Pse je këtu?" çfarë informacioni konkret kërkohet nga ai që
13 bën pyetjen në këtë rast? Apo pyetja, "A je hajdut?" kjo
14 pyetje në vetvete çfarë ka të bëjë, çfarë lidhje ka me
15 konfliktin e armatosur? Një lidhje e tillë thjesht prezumohet
16 nga ZPS-ja, por nuk ekzistojnë prova për të vërtetuar këtë
17 gjë, nuk janë shfaqur apo nuk janë ofruar prova të tilla.

18 Nuk mund të nxirret si përfundim nga asnjë nga pyetjet
19 personat të cilët flasin me dëshminë e tyre që qëllimet e
20 posaçme do të ishin, domethënë, kryesi kishte qëllime të
21 posaçme kur i ka bërë këtë pyetje atyre.

22 Tani më lejoni që t'i kthehem një teme tjetër, dhe e kam
23 fjalën këtu, mbivendosjes së veprave.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Avokat, në një moment dua të them për procesverbal që personi

1 që keni identifikuar si personi i paidentifikuar 1, ne dje
2 kemi përdorur emrin e tij në Gjykatë, që ishte Burmak, pra,
3 thjesht për të mos e komplikuar gjërat. Ndërkohë, sa i takon
4 personit të dytë, nuk duhet që t'i përmendet emri këtij
5 personi, por sa i takon personit të parë të paidentifikuar
6 mund të përdornin emrin e tij në parashtrimet e mëtejshme
7 gjatë ditës së sotme.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit. Do të vazhdojmë me
9 njëkohshmërinë e veprave penale.

10 Më lejoni që të filloj duke thënë se parimi i
11 përgjithshëm i të drejtës penale është se përkufizimi i një
12 krimi do të interpretohet rreptësishtë dhe nuk do të zgjerohet
13 për analogji. Në rast të dykuptimshmërisë përkufizimi do të
14 interpretohet në favor të personit që hetohet, procedohet apo
15 dënohet.

16 Mbrojtja shqyrton fillimisht njëkohshmërinë ashtu si ajo
17 lidhet me ombrellën e krimeve të luftës sipas të drejtës
18 ndërkombëtare, sikundër titulli i nenit 14 të Ligjit për
19 Dhomat e Specializuara të Kosovës lexon duke adresuar
20 elementët që mund të nxirren kur ligjet e 14(c)(i) mbi
21 trajtimin mizor dhe torturën zbatohet në skenarë të ndryshëm
22 faktik.

23 Midis dy krimeve, ka dy elementë që, nëse do të
24 zbatoheshin në një çështje të caktuar, mund të mbështeteshin
25 për të provuar një krim, por jo tjetrin. Në një rast të tillë

1 nuk duhet të ketë mbivendosje elementësh.

2 Së pari, dhe ajo që ka më rëndësi, dy krimet e trajtimit
3 mizor apo torturës për shkak të vetë natyrës së tyre do të
4 kryheshin përmes shkaktimit të dhimbjeve apo vuajtjeve fizike
5 apo mendore. Kështu, elementi mund të jetë i njëjtë duke pasur
6 parasysh rrethanat faktike të drejta.

7 Së dyti, sipas Konventës së Gjenevës neni i përbashkët 3,
8 krimet e renditura duhet të kryhen konkretisht kundër një
9 popullsie civile.

10 Së treti, kur çështja e Prokurorisë bazohet në të njëjtat
11 shkaqe, arsye, i njëjti element do të ishte i njëjtë. Në këtë
12 rast, arsyeja apo shkak për të shkaktuar dhimbje do të ishte
13 pra, ndaj njerëzve të ndaluar.

14 Së katërti, tortura kërkon paraqitjen e provave që paktën
15 një nga qëllimet e renditura të ketë qenë arsyeja për
16 shkaktimin e dhimbjes ndaj personave të ndaluar.

17 Shkurt, Mbrojtja konstaton se dikush mund të ketë një
18 synim konkret që kërkohet për kryerjen e trajtimit mizor që
19 mund të përmbushë në të njëjtën kohë të njëjtën kërkesë për
20 torturë duke kryer akte që përmbushin elementet material të dy
21 krimeve.

22 Interesat e mbrojtura.

23 E trajtoj këtë temë në lidhje me atë, që do ta quaja,
24 elementin e interesave social. Në lidhje me mbrojtjen e
25 interesave të ndryshme sociale, elementet e dy krimeve mund të

1 mbivendosen kur zbatohen në disa skenarë faktikë por jo në
2 disa të tjerë.

3 Sipas krimeve të trajtimit mizor dhe torturës, interesi
4 social i mbrojtur është ndalimi i shkaktimit të dhimbjeve të
5 rënda të klasës së mbrojtur të personave. Klasa e persona në
6 të dy rastet është sipas ligjit e kufizuar me popullsinë
7 civile. Prandaj, kur statusi i viktimave dhe i elementeve të
8 krimeve janë të njëjtë, megjithatë, veprat penale të
9 parashikuar në ligj dhe bëhet fjalë dhe për 14(c)(i) mund të
10 thuhet se mbrojnë të njëjta interesa sociale.

11 Salih Mustafa akuzohet bashkërisht me trajtim mizor sipas
12 pikës 2 dhe torturë pika 3. Në rastin konkret, personi i
13 akuzuar pretendohet se ka marrë pjesë apo ka urdhëruar
14 shkaktimin e dhimbjes së rëndë përmes kryerjes së krimeve në
15 Zllash. Prokuroria pretendon se Mustafa synonte të shkaktonte
16 dhimbje apo vuajtje të rënda njerëzve të cilët ishin të
17 ndaluar në Zllash.

18 Provat paraqiten nga ZPS-ja se shkaktimi i dhimbjeve për
19 të cilën i akuzuari ishte përgjegjës dhe është kryer kundër
20 popullsisë civile. Por sjellja me të cilën është mbështetur
21 ajo për të provuar të dy krimet ishte e njëjtë: Elementët
22 fizikë dhe mendorë.

23 Çështja e Prokurorisë bazohet në objektivin e të
24 akuzuarit për të shkaktuar dhimbje apo vuajtje personave të
25 ndaluar në Zllash. Të njëjtat veprime apo mosveprime shërbejnë

1 si bazë për çështjen e Prokurorisë në të dy llojet e krimeve
2 në fjalë.

3 Për shembull, shkaktimi i dhimbjeve të rënda, që kërkohet
4 për të përmbushur kriteret e trajtimit mizor, ka shërbyer
5 gjithashtu për të provuar se aktet e kryera nga i akuzuari
6 ishin akte torture: konkretisht, shkaktimi i dhimbjes apo
7 vuajtjeve me synimin për të marrë informacion, për të
8 ndëshkuar, shtrënguar apo frikësuar njerëzit të cilët
9 pretendohet se janë ndaluar në kompleksin e ndalimit në
10 Zllash.

11 Në lidhje me *mens rea*. Bëhet fjalë për të njëjtën synim
12 që ka shërbyer si bazë për të dy llojet e krimeve në fjalë.
13 Rrjedhimisht, elementët edhe provat e përdorura për të provuar
14 këto elementë kanë qenë të njëjtë për krimin e trajtimit mizor
15 sikundër dhe për krimin e torturës në rastin konkret.

16 Viktimat kanë pasur të njëjtin status qoftë nëse ishin
17 viktima të akteve të trajtimit mizor apo të krimeve të
18 torturës. Kështu, në këtë rast të njëjtat prova kanë provuar
19 se aktet e të akuzuarit synonin për të shkaktuar dhimbje të
20 rëndë civilëve sipas trajtimit mizor dhe kanë shërbyer njëlloj
21 si prova lidhur me aktet e torturës kundër të njëjtëve civilë.

22 Prandaj, në rastin konkret, të nderuar Gjykatës, interesi
23 social i mbrojtur, që do të thotë, ndalimi i shkakimit të
24 dhimbjeve dhe vuajtjeve të rënda popullsisë civili, ishte i
25 njëjtë për trajtimin mizor dhe krimet e torturës dhe vrasjes

1 sipas nenit 14(c)(i) të Ligjit për Dhomat e Specializuara.

2 Mbrojtja konstaton se elementet e krimeve -- më falni, të
3 nderuar Gjykatës, po e them edhe njëherë fjalinë e fundit
4 sepse bëra një gabim.

5 Prandaj, në rastin konkret, interesi social i mbrojtur,
6 që do të thotë, ndalimi i shkaktimit të dhimbjes apo vuajtjeve
7 të rënda popullsisë civile ishte i njëjtë si për trajtimin
8 mizor ashtu edhe për krimin e torturës sipas nenit 14(c)(i) të
9 Ligjit për Dhomat e Specializuara.

10 Mbrojtja konstaton se elementet e krimeve janë të njëjtë
11 për të dy llojet e krimeve dhe se provat e përdorura për të
12 provuar njërin krim janë përdorur gjithashtu për të provuar
13 edhe tjetrin. Provat e paraqitura për të provuar një akuzë
14 domosdoshmërisht kanë kërkuar prova për të tjerat.

15 Sjellja e fajshme, që do të thotë, shkaktimi i dhimbjes
16 apo vuajtjeve të rënda, mbi të cilat është mbështetur
17 Prokuroria për të provuar trajtimin mizor, gjithashtu
18 përmbushin dhe *actus reus* për torturën.

19 Elementi i pretenduar i *mens reas* në lidhje me të dy
20 krimet ishte gjithashtu i njëjtë, që do të thotë, për të
21 shkaktuar dhimbje dhe vuajtje të rënda popullsisë civile.

22 Së fundi, interesi i mbrojtur social në rastin konkret me
23 siguri është i njëjtë. Klasa e personave të mbrojtur, që do të
24 thotë, viktimat e këtyre akteve, për të cilët Mustafa
25 pretendohet se ka qenë përgjegjës ishin civilë. Në skenarin

1 faktin në çështjen konkrete, krimet e trajtimit mizor dhe të
2 torturës mbivendosen. Rrjedhimisht, ekziston bashkëkohësia e
3 shkeljeve, njëkohshmëria e shkeljeve në lidhje me dy krimet
4 brenda të njëjtit vend krimesh. Që do të thotë, këto vepra
5 ishin të njëjta në rastin konkret.

6 Një grup i vetëm veprimesh apo sjelljesh përmbush kushtet
7 e kërkuara për të përbërë vepra të ndryshme. Prokuroria, ka
8 përdorur të njëjtët element për të provuar të dy llojet e
9 krimeve duke qenë se ato vlenin për të njëjtin vend të
10 kryerjes së krimit. Në kontekstin e rastit konkret, të dy
11 krimet në fjalë kanë mbrojtur të njëjtët interesa socialë.
12 Rrjedhimisht, pika e trajtimit mizor përmbushet plotësisht nga
13 pika e torturës edhe mbase dhe e kundërta. Që do të thotë,
14 janë të ndërkëmbyeshme sepse mbështeten në të njëjtën sjellje
15 të ndaluar.

16 Mbrojtja, rrjedhimisht, është e mendimit se rrethanat në
17 këtë rast, si kundër janë diskutuar më lart, nuk bëhen shkak
18 për kryerjen e më shumë se një veprë të vetme. Skenari lejon
19 vetëm konstatimin e ose të trajtimit mizor apo të torturës.
20 Rrjedhimisht, në qoftë se njëri prej krimeve vërtetohet kundër
21 personit të akuzuar, atëherë ai në të njëjtën kohë ai nuk mund
22 të shpallet fajtor për krimin tjetër. Kjo do të ishte e
23 papërshtatshme sepse do të ishte baras me dënimin e të njëjtit
24 person dy herë për të njëjtën krim.

25 Në qoftë se Prokuroria synonte të mbështetej në të

1 njëjtët elementë dhe prova për të provuar të dy llojet e
2 krimeve, ajo duhej të kishte bërë akuza për të kundërtën ose
3 Prokuroria duhet të kishte dalluar midis individëve, të kishte
4 bërë dallime midis individëve, kujt individë, tek cilët
5 individë sjellja e caktuar ishte e barabartë me trajtimin
6 mizor dhe tek të cilët individë ishte torturë. Si e tillë,
7 këto akuza janë të papërshtatshme dhe të pazbatueshme.

8 Lidhur me njëkohshmërinë e veprave, Mbrojtja është e
9 mendimit se në këtë Aktakuzë, bazuar në faktet e veprave, kemi
10 një njëkohshmëri veprash, "concoure d'infractious". Dhe
11 qëndrimi i Mbrojtjes është se dikush nuk mund të akuzohet për
12 të njëjtat fakte, apo më mirë të themi, për të njëjtat akte
13 për të dy krime të ndryshme. Shkaktimi i pretenduar i dhimbjes
14 së dëshmitarëve që është dëgjuar në Gjykatë nuk mund të
15 përcaktohet dy herë, sidomos sepse veprat apo aktet që
16 pretendohen që janë kryer ndaj katër dëshmitarëve kanë qenë në
17 fakt të njëjtë. Aktet e kryera mundet të jenë ose një nga të
18 dy krimet. Nuk mund të jenë të njëjtë. Veçanërisht në rastin
19 kur shohim torturën, shohim se janë kryer ekzaktësisht të
20 njëjtat akte si ato që futen në kuadër të trajtimit mizor.

21 Këto akte janë kryer në të njëjtin veprim. Në qoftë se
22 një veprim i tillë do të ishte baras me krime të shumta
23 atëherë nuk do të kishte dallim midis dy krimeve. Për një çast
24 vendos mënjanë qëllimin që është i domosdoshëm për t'u quajtur
25 torturë, në këtë rast ajo që mbetet janë të rrahurat që kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 25

1 shkaktuar dhimbje, por rrahje të tilla apo shkaktimin e
2 dhimbjeve të tilla nuk mund të kualifikohet si krim i veçantë.

3 Pra, qëndrimi i Mbrojtjes është se duhet bërë një dallim
4 në përcaktimin e këtyre akteve në qoftë se do të provoheshin.

5 Këtu përfundoj ku e fillova. Është një parim i
6 përgjithshëm i të drejtës penale se përkufizimi i një krimi
7 duhet të interpretohet rreptësishtë dhe nuk duhet të zgjerohet
8 për analogji. Në rast të paqartësisë, përkufizimi duhet
9 interpretuar në favor të personit që hetohet, procedohet apo
10 shpallet fajtor.

11 Qëndrimi i Mbrojtjes është se Salih Mustafa nuk mund të
12 shpallet fajtor për të dy krimet atë të trajtimit mizor dhe të
13 torturës.

14 Dhe tani dua të flas për vrasjen.

15 Prokuroria pretendon se për provat e paraqitura viktimja
16 është vrarë nga anëtarë të njësisë BIA. Megjithatë, Prokuroria
17 nuk na ka dhënë ndonjë provë materiale për të provuar se
18 viktimja është vrarë apo se shkak i vdekjes së viktimës ka
19 qenë ai. Pra, Prokuroria nuk ka dhënë asnjë provë për të
20 vërtetuar kohën e vdekjes dhe vendin e vdekjes.

21 E vetmja provë që ka ofruar Prokuroria për deponimin e
22 vdekjes së viktimës janë fotot ERN me numër SPOE00209313 deri
23 në 00209320, që viktimja 4676 i ka marrë në vendin e krimit në
24 kohën kur viktimja është zhvarrosur.

25 Në kohën kur viktimja është zhvarrosur, [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]. Dëshmitari tha në faqen 1604 të seancës gjyqësore
3 në 17 nëntor 2021:

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 Dëshmia e këtij dëshmitari konfirmon faktin se kur
9 viktima ishte zhvarrosur ju vu re një vrimë në trup por askush
10 nga personat e pranishëm nuk kishte mundësi të përcaktonte
11 shkakun e krimit të kësaj vrime si edhe faktin që ekzaminimi
12 post-mortem nuk u bë ndonjëherë.

13 Dëshmitari në faqen 1619 në seancën gjyqësore të 17
14 nëntor 2021 deklaroi, citoj:

15 "Mund të shikosh një vrimë, por askush nuk mund të thotë
16 se kush e ka shkaktuar, çfarë e ka shkaktuar. Por gjendja e
17 trupit të viktimës është ajo që shikon këtu.

18 Jo, nuk është bërë asnjëherë ndonjë ekzaminim post-mortem
19 i kësaj kufome."

20 Në faqen 1620, ajo deklaroi:

21 "Është një vrimë. Është një vrimë që është konstatuar dhe
22 shënuar si e dyshimtë, si diçka e pazakontë në kufomë. Kufoma
23 kishte filluar procesin e dekompozimit, kështu që është shumë
24 vështirë të vish në përfundimin se ç'është kjo vrimë në fakt."

25 Në përgjigje të pyetjes së Prokurorisë në faqen 1620 që

1 ishte:

2 "A kontrollloi njeri nëse ka pasur dhe vrima të tjera në
3 pjesë të tjera të trupit? Në pjesë të përparme, të pasme,
4 anash?"

5 Dëshmitarja tha:

6 "Jo, ne nuk vazhduam të kontrollojmë kufomën më tej, pra,
7 ky ka qenë procesi i identifikimit të teshave që ka veshur
8 personi dhe përshkrimi për ne ishte i mjaftueshëm për të
9 vërtetuar se ky është trupi i viktimës.

10 Nuk kam mundur të identifikoj asnjë shenjë tjetër sepse,
11 siç thashë, kufoma ishte në proces dekompozimi dhe është
12 shumë, shumë vështirë të identifikohen shenja të tjera në
13 kufomë në këtë pikë."

14 Ndërsa në faqen 1627, dëshmitarja deklaroi:

15 "Megjithatë në këto rrethana ishte e vështirë të
16 identifikohesh nëse ishte një plumb i qëlluar në trup sepse ne
17 nuk ishim ekspertë mjeko-ligjorë. Aty s'kishte ndonjë patolog
18 dhe asnjë lloj eksperti për të identifikuar se cila ishte
19 origjina e kësaj vrime."

20 Dëshmia e dëshmitares provon faktin se varri ku ishte
21 varrosur viktimë nuk ishte i fshehur dhe ishte e lehtë të
22 identifikohesh si varr. Kështu, dëshmitarja në fjalë në pyetjen
23 e bërë nga Mbrojtja ajo deklaroi në faqen 1631:

24 "Përshtypja fillestare e këtyre dy degëve të vendosura
25 njëra mbi tjetrën ishte si një mjet identifikimi. Ato nuk janë

1 aty për të fshehur diçka apo të fshehur një varr në çfarëdo
2 forme të ishte. Ka mënyra të tjera dhe mjete të tjera për të
3 fshehur gjurmë. Të fshish të gjitha gjurmët e një vendi
4 varrimi. Pra, ky është kuptimi i atyre dy degëve sipër vendit
5 të varrimit.”

6 Tani kaloj tek një temë tjetër, që është kalimi, është
7 çështja e ndryshimit nga ZPS-ja në vendin ku janë mbajtur
8 njerëzit.

9 Çështja e ndryshimit të vendit ku mbaheshin njerëzit.

10 Në vendimin e Panelit të 8 shtator 2022, parashtrimi 471,
11 Paneli i kërkoi ZPS-së të sqaronte se cila nga ndërtesat
12 konkrete të ndodhura në atë që ZPS-ja e quan kompleksi i
13 ndalimit në Zllash, është përdorur për të ndaluar, marrë në
14 pyetje, keqtrajtuar individët në kohën e akuzave.

15 Indikacioni që dha ZPS-ja ishte ndërtesa 4A, ku shumica e
16 individëve ishin mbajtur të ndaluar. ZPS-ja thotë se kishte
17 gjashtë persona në këtë ndërtesë. Ngjitur me ndërtesën 4A, atë
18 që e quajmë oda, që është në të djathtë e ndërtesës 4A, të
19 njëjtët gjashtë persona janë mbajtur në podrumin e odës.

20 Sipas ZPS-ja, gjashtë individë janë keqtrajtuar në
21 ndërtesën 4A si dhe në ahurin e odës.

22 Për sa i takon marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit, kjo
23 është bërë në pjesën e sipërme të odës.

24 Dhe ZPS-ja e ka ndryshuar qëndrimin e saj nga një
25 ndërtesë në tre ndërtesa ku njerëzit janë mbajtur. Të gjithë

1 dëshmitarët e ZPS-së janë intervistuar nga ZPS-ja lidhur me
2 një ndërtesë të vetme dhe jo tre ndërtesa. ZPS-ja ka mashtruar
3 Mbrojtjen ose e ka keqdrejtuar Mbrojtjen duke e ndryshuar
4 befasisht vendndodhjen nga një në dy të tjera. Ne do ta trajtojmë
5 këtë çështje në mënyrë kronologjike, siç kanë rrjedhur
6 ngjarje.

7 Po fillojmë me konfirmimin e Aktakuzës.

8 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, konfirmimi prej këtij
9 Gjykatësi i Aktakuzës. Kur ZPS-ja parashtroi materialin e vet
10 përpara Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e
11 Aktakuzës edhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake supozoi se
12 bëhej fjalë për një ndërtesë ku mbaheshin njerëzit. Në
13 vendimin për të konfirmuar Aktakuzën, Gjykatësi i Procedurës
14 Paraprake mori parasysh lidhur me parandalimin arbitrar dhe
15 citoj paragrafin 95 të vendimit:

16 "Në lidhje me elementet materialë të krimit, Gjykatësi i
17 Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon
18 se, në apo rreth 1 prillit ... të paktën gjashtë të ndaluar,
19 nga vende të ndryshme të Kosovës, janë marrë në ruajtjen
20 anëtarëve të UÇK-së dhe më pas janë ndaluar në kompleksin e
21 ndalimit në Zllash. Të ndaluarit në fjalë janë mbajtur në një
22 dhomë të mbyllur me zinxhirë dhe të ruajtur me roje. Gjashtë
23 të ndaluar janë mbajtur të ndaluar për 18 ditë, deri rreth 19
24 prillit ... një i shtati është mbajtur i ndaluar për tre
25 ditë."

1 Lidhur me trajtimin mizor të njerëzve, Gjykatësi i
2 Procedurës Paraprake tha dhe po citoj pjesët përkatëse të
3 paragrafit të Aktakuzës së konfirmuar që është një 104:
4 "Lidhur me elementët materialë të krimit, Gjykatësi i
5 Procedurës Paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon
6 se, nga afërsisht 1 prilli 1999 deri në 19 prill 1999, anëtarë
7 të UÇK-së kanë shkaktuar lëndime të rënda fizike dhe
8 psikologjike dhe vuajtjet ndaj të paktën gjashtë të ndaluarve
9 në qendrën e ndalimit në Zllash. Kushtet e ndalimit ishin
10 jashtëzakonisht të papërshtatshme. Të ndaluarit ishin të
11 privuar nga liria pa procesin e rregullt të ligjit. Janë
12 mbajtur në një ahur për kafshë, ku në tokë kishte kashtë, nuk
13 kishte dritare apo dritë natyrale. Ushqimi dhe uji ishin të
14 pamjaftueshëm dhe nuk jepeshin rregullisht aq sa të ndaluarit
15 kur u liruan nuk pushonin së ngrëni. Të ndaluarit flinin në
16 tokë, në pellgje uji dhe në kushte të ftohta. Nuk kishin qasje
17 në banjë apo ujë të freskët dhe duhej të kryenin nevojat
18 personale në një kovë në ahur. Jo vetëm nuk kishte kujdes
19 mjekësor për ta, por ata rriheshin në qoftë se kërkonin një
20 mjek."

21 Paragrafi 105 thotë:

22 "Të ndaluarit në fjalë rriheshin pothuaj çdo ditë,
23 ndonjëherë dy herë në ditë, si në dhomën ku mbaheshin ashtu
24 dhe në një dhomë tjetër që ndodhej lart.

25 Nga ahuri ku ata mbaheshin, ata dëgjonin shokët e tjerë

1 që bërtisnin kur i rrihnin lart përpara se ti kthenin përsëri
2 në ahur.”

3 Së fundi, dua të them se Mbrojtja nuk mban ndonjë qëndrim
4 kur vjen puna tek konfirmimi i Aktakuzës.

5 Dosja paragjyqësore e ZPS-së, që është parashtrimi F0088-
6 1A01 dhënë Mbrojtjes në 11 tetor. Në këtë dosje të ZPS-së, ajo
7 sistematikisht ka vënë në dukje se dëshmitarët mbaheshin në
8 një vend dhe merreshin në pyetje lart në të njëjtin vend.

9 Paragrafi 30, ZPS-ja ka deklaruar në dosjen e saj paraprake:

10 “Provat do të tregojnë se të burgosurit janë mbajtur në
11 katin e parë të ndërtesës” në njëjës, “të përdorur nga njësia
12 BIA”.

13 Pra:

14 “... janë mbajtur në katin e parë të ndërtesës” dhe, po e
15 theksoj, njëjës, sepse në njëjës është jo në shumës “të
16 përdorur nga njësia e BIA-s si bazë. Kjo ndërtesë” përsëri
17 njëjës, “bënte pjesë e kompleksit të ndalimit në Zllash ku
18 krimet e pretenduar ë Aktakuzë janë kryer”.

19 Sa e qartë mund të jetë kjo se ZPS-ja ka parashikuar
20 vetëm një ndërtesë? Këtë e kanë thënë në dosjen e tyre
21 paraprake.

22 Por dhe një shembull tjetër e gjejmë në paragrafi 35.

23 ZPS-ja shkruante:

24 “Sikurse është vënë në dukje, ai ka pranuar se ka ndenjur
25 në shtëpi në Zllash ku ushtarët e BIA-s kanë fjetur shumë herë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 32

1 gjatë periudhës së Aktakuzës dhe ku krimet e pretenduara në
2 aktakuzë kanë ndodhur.”

3 Një shembull tjetër në paragrafi 64. Ku thuhet:

4 “Të ndaluarit janë mbajtur në një ahur, në shtëpi të
5 vjetër, një lloj stalle për kafshët që ishte mbyllur me
6 zinxhirë. Ruhej me roje. Vendi ishte në kushte të këqija në
7 tokë kishte kashtë, nuk kishte dritare dhe nuk kishte ajër apo
8 dritë që të vinte nga jashtë.”

9 Por edhe provat që ata kanë paraqitur në dosjen paraprake
10 ku kanë cituar pikërisht dëshmitarët për të cilët po
11 diskutojmë dhe për këtë do të japim disa shembuj. Paragrafi
12 69:

13 “Dëshmitari 3593 dëgjoi të ndaluar të tjerë që i rrihnin
14 lart, mbi ahurin ku ai ishte mbajtur i ndaluar.”

15 Paragrafi 71, për shembull tregon:

16 “Dëshmitari 4669 rrihej si në ahur edhe lart. Kur ishte
17 lart njëherë i thanë të zhvishte teshat në pjesën e sipërme të
18 trupit dhe u rrah në shpinë dhe në supe me një shkop gome të
19 policisë nga dy anëtarë të UÇK-së të veshur me uniforma të
20 zeza.”

21 Tre, tani kemi dëshmitarët.

22 1679 iu tregua një foto e odës që është prova e
23 SPOE00128388, që në [REDAKTUAR]. Intervista e 1679 me numër
24 ERN 100807-TR-ET, Pjesa 1, faqet 6, 7, 9, 10. Ai e rrethoi në
25 atë kohë shtëpinë me dy kate, aty rrethoi odën. Kjo

1 dokumentohet plotësisht në njoftimin zyrtar të ZPS-së që
2 fillon nga me numër ERN 100800 deri në 100806.

3 Nuk ju është bërë pyetje për ndërtesën 4A apo ndërtesën 5
4 apo nëse është mbajtur në ndonjë ndërtesë tjetër përveç asaj
5 me odën. Në të njëjtën intervistë ZPS-ja, në faqen 10, me këtë
6 dëshmitar, e ka treguar një foto tjetër. SPOE00128395 e cila
7 është foto tjetër që është treguar. Është fotoja e derës së
8 odës.

9 Në faqen 11 të së njëjtës intervistë të ZPS-së, atij i
10 kanë treguar dokumentin SPOE00128392. Ai deklaroi lidhur me
11 këtë fotografi që e kishin mbajtur në pjesën nëntokësore të
12 saja. Asnjë pyetje për në podrum. Asnjë pyetje nuk është bërë
13 lidhur me ndërtesën 4A apo 5 apo nëse është mbajtur në ndonjë
14 ndërtesë tjetër përveç ndërtesës që njihet si oda. Atij i kanë
15 treguar edhe një fotografi të Palës Mbrojtëse, DSM00031. Edhe
16 kjo është pjesë e të njëjtës intervistë të [REDAKTUAR]. Dhe
17 kjo është intervista e 1679 me numër ERN 100807-TR-ET, Pjesa
18 1, faqe 16. Është bërë një pyetje lidhur me këtë fotografi.
19 Është fotografia e një mashkulli të vjetër që është në këmbë
20 përpara odës.

21 Kur i kanë treguar këtë fotografi, ai komentoi:

22 "Duket e ngjashme me të mëparshmen. Është më e ngjashme
23 me atë që më kujtohet. Ishte kjo ndërtesë që ishte në katin e
24 poshtëm dhe dy ndërtesat e tjera që ishin pak më lart. Dhe kjo
25 më duket më familjare. Dhe njoh më mirë dhe këtu shoh edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 34

1 shkallët dhe kjo e përshkruan më mirë ndërtesën në fjalë.”

2 Pra, që nga fillimi, ka qenë e qartë për Palën Mbrojtëse
3 që bëhej fjalë për odën, pra, odën kishte parasysh ZPS-ja dhe
4 dëshmitarët e ZPS-së. Të gjithë dëshmitarët kanë treguar në
5 fotografi se ku ishin mbajtur dhe që të gjithë treguan të
6 njëjtën ndërtesë.

7 W3593, më [REDAKTUAR], numri 0615-TR-ET [sipas
8 përkthimit], Pjesa 2, e redaktuar, faqe 9, e pyetën për një
9 fotografi që ishte ERN SITF00072231. Ai e dalloi firmën e tij
10 në këtë fotografi. Dhe i kërkuan që me gisht të tregonte se
11 ishte stalla. Dhe ai tha:

12 “Kjo është stalla, këtu. Dhe mbi të qëndronte ushtria dhe
13 ata që na kanë rrahur.”

14 “A je i sigurt për këtë?”

15 “Po, 100 për qind.”

16 Në [REDAKTUAR] i treguan një fotografi tjetër, ERN
17 SPOE00128388, që është e ngjashme me fotografinë e parë. Vetëm
18 se është e ngushtuar nga anët. Dëshmitari komentoi lidhur me
19 fotografinë:

20 “Bëhet fjalë për këtë derën, këtu.”

21 Pyetje:

22 “Pra, dera që ju e keni shënuar në faqen 3; saktë?”

23 Po, kjo është e saktë. Këtu më kanë mbajtur dhe nga këtu
24 kam dalë nga kjo derë.”

25 Më [REDAKTUAR], i njëjti dëshmitar, 3593. Më [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR] numri ERN 100957-TR-ET, Pjesa 1, një fotografi
tjetër i

2 ishte treguar. Dhe është kjo fotografi me ERN SPOE00128392.

3 Dhe është edhe kjo fotografi e odës:

4 "Këtu më kanë mbajtur të ndaluar në këtë shtëpi."

5 "A mund të na shënoni këtu me numrin 2?"

6 "Unë qëndrova këtu. Më kanë mbajtur të ndaluar këtu për
7 18 ditë."

8 "Z. Dëshmitar," ishte pyetja, "a je i sigurtë për këtë?
9 Kjo ndërtesë që po dalloni, a është ndërtesa ku ju kanë
10 mbajtur të ndaluar?"

11 "Të tregoj të vërtetën, kur më kanë dërguar atje i kisha
12 sytë e mbyllur. Më dërguan. Më dërguan atje dhe e kisha të
13 mbuluar fytyrën, sytë. Nuk e dija se ku do të më dërgonin."

14 "Atëherë si e dini se është kjo ndërtesë?"

15 "Për shkak se dalloj derën. Kur më futën atje, unë i
16 holla një sy derës dhe ishte si e një vendi ku mbahen
17 kafshët."

18 Edhe këtë herë nuk është bërë ndonjë pyetje lidhur me
19 ndërtesën 4A apo ndërtesën 5 apo nëse është mbajtur në ndonjë
20 ndërtesë tjetër të ndryshme nga oda. Identifikimi i tërë
21 ndërtesës vetëm përmes derës nuk ka vlerë provuese. Dera, nuk
22 është aq e veçantë, sa të dallohet ndërtesa. Është si një derë
23 e zakonshme e asaj zone.

24 Pavarësisht se ZPS-ja i ka bërë pyetje dëshmitarit më
25 [REDAKTUAR], ndodhi kështu:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 36

1 "Nga deklarata juaj, e dimë që fillimisht ju kanë mbajtur
2 të ndaluar në një vend pastaj në një vend tjetër. A mund të na
3 tregoni, nëse ju kujtohet, se në cilin vend ju kanë ndaluar
4 herën e parë dhe në cilin vend keni kaluar pjesën tjetër të
5 mbetur të kohës në Zllash?"

6 Përgjigje:

7 "Ishin shumë afër, e para."

8 Dhe pyetja me shënimin numër 2:

9 "Më ndaluan aty për një periudhë tre apo katër ditësh.
10 Nuk më kujtohet. Dhe ndërtesa ishte afër dhe aty më kanë
11 rrahur. Nuk mund ta harroj asnjëherë një gjë të tillë."

12 "Pra, juve ju rrahën në këtë fotografi?"

13 Përgjigje:

14 "Po."

15 3594 --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Avokat, ju lutem të mos e përmendni datat e deklaratave të
18 mëparshme por vetëm numrat identifikues rendor.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Dakord.

20 3594, nuk ka parë asnjë fotografi.

21 Atëhere kaloj tek 4669. Në parashtrimet e saj pas
22 pyetjeve të Trupit Gjykses, ZPS-ja dorëzoi dokumentin F000471.
23 Në këtë dokument, në faqen 3, tregohet fotografia SPOE123388,
24 e rrethuar me një rreth blu në krye të kësaj faqe.

25 Megjithëkëtë, dëshmitari, gjatë dëshmisë së tij tha dhe citoj:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 37

1 "Z. Dëshmitar, është një rreth blu i errët rreth dy
2 ndërtesave. Është ky vendi juaj? A e keni rrethuar ju këtë?"

3 Përgjigje:

4 "Vizatimin, nuk më kujtohet ta kem bërë një gjë të tillë.
5 Ndoshta dikush tjetër e ka bërë."

6 Ai pyeti fillimisht nëse ky ishte vendi dhe më pas mund
7 ta kenë rrethuar. Transkripti i 10 nëntorit, faqja 1471.

8 Në intervistën me ZPS-në dëshmitarit në atë kohë, pra,
9 [REDAKTUAR], SPOE082023-TR-ET, Pjesa 2, faqe 29 e 30,
10 dëshmitarit i është treguar i tërë albumi fotografik.

11 Dokumenti ka numrin rendor ERN SPOE00128386 deri 128420.

12 Në kohën kur është treguar albumi gjatë kësaj interviste,
13 ai tregoi fotografinë 00128407 që në fakt është një fotografi
14 e ndryshme --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju
16 ndërpres edhe njëherë, po ju përmendët dhe një herë datën e
17 një deklaratë të mëparshme.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
20 përballojmë dot punën. Kolegët janë duke e redaktuar, janë
21 duke e fshirë këtë. Nuk di sesi mund ta bëj veten më të qartë.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëhere duhet të kalojmë në
23 seancë private.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
25 nuk është e mundur ta bëni këtë pa përmendur datën?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 38

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Po. Nuk jam i sigurt që vetëm
2 me anë të rendit rendor mund të kuptohet që bëhet fjalë për
3 një deklaratë të mëparshme dhe do të dalë diçka këtu.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po në
5 qoftë se kërkesa ime që dje ka qenë që të mos përmendni datën
6 por vetëm të jepni numër, atëherë zbatoni vendimin që kam
7 nxjerrë, pasi ne e kemi menduar mirë këtë çështje.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e nderuar
9 Gjykatëse.

10 Në kohën kur është treguar ky album, ai tregoi
11 fotografinë 000128407. Që, në fakt, është një fotografi
12 tjetër. Pra, ai po komentonte mbi një fotografi tjetër,
13 SPOE128407, pasi në këtë intervistë nuk ka asnjë tregues se
14 cilën fotografi të ketë rrethuar ai.

15 Në kohën kur është pyetur:

16 "A ka mundësi që dëshmitari të rrethojë dy ndërtesa që
17 beson që i njeh dhe me qëllim që ta pranojmë si provë
18 materiale këtë fotografi?"

19 Ajo nuk është shënuar se cilën ka rrethuar dhe, ai beson,
20 se ai nuk e ka bërë rrethimin vetë, siç tregohet këtu në
21 seancën.

22 Pra, nuk është dëshmitari i cili e ka rrethuar këtë dhe
23 nuk ka treguar, në fakt, nëse kjo ishte ndërtesa ku e kanë
24 mbajtur. Ai tha:

25 "Më duket se bëhet -- më duket se për mua njëra prej tyre

1 është vendi në fjalë. Më kuptoni, pasi kjo ka ndodhur para 20
2 viteve dhe është e vështirë që ta them këtë me siguri të plotë
3 dhe po kështu ne na kanë mbajtur të mbyllur brenda. Ne kemi
4 parë vendin vetëm kur na kanë sjellë brenda dhe kur kemi dalë
5 jashtë.”

6 SPOE082023-TR-ET, pjesa 2, faqja 29, 30.

7 Duhet ta bëjmë tejet të qartë që nga çështja e mësipërme
8 që kemi paraqitur që bëhet fjalë për një ndërtesë të vetme që
9 ka parashikuar ZPS-ja. Ndryshimi i vendndodhjes një javë
10 përpara fillimit të argumenteve gojore në përgjigjet ndaj
11 Trupit Gjykues nga ana e ZPS-së, është e padrejtë.

12 I akuzuari ka të drejtën e gjyqit të barabartë dhe në
13 qoftë se Pala Mbrojtëse mashtrohet apo keqdrejtohet, atëherë
14 ne duhet të kemi të drejtën të dëgjojmë dëshmitarët për të na
15 treguar se ku ekzaktësisht i kanë mbajtur dhe me kë janë
16 mbajtur të ndaluar.

17 Të mos harrojmë që ZPS-ja papritur na paraqet faktin që
18 4669 është mbajtur së bashku me dy individë të panjohur. Dhe
19 sipas rrëfimit të tij, ai e ka parë personin e supozuar të
20 vrarë të kësaj Aktakuze.

21 1679, 3594 dhe 3593 asnjëherë nuk e kanë përmendur të
22 ashtuquajturën viktimë të vrasjes së kësaj çështjeje që të
23 ketë qenë aty për dy net të paktën.

24 1679 tha që 4669 ka qenë me të gjatë gjithë kohës dhe
25 gjatë gjithë kohës që 4669 është mbajtur i parandaluar. Sipas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 40

1 rrëfimit të tij, 4669 ka qenë së bashku me viktimën e supozuar
2 të vrasjes dhe dy personat të cilët ishin më të vjetër se vetë
3 4669. Pra, si mund të jetë kjo e mundur?

4 W1679 nuk po tregon të vërtetën apo 4669 nuk po e tregon
5 të vërtetën. Pasi rrëfimet e tyre nuk pajtohen lidhur me të
6 njëjtën çështje.

7 ZPS-ja thotë që 04669 ishte në ndërtesën 5, por 01679
8 thotë që ishte në ndërtesën oda. Pra, me kë ishte 1679 tani?
9 Dhe mund të jetë e mundur, siç thotë ZPS-ja, që 4669 të
10 ndodhet në një ndërtesë tjetër? 4669 ka thënë vetë që ai ka
11 qenë së bashku me viktimën e supozuar të vrasjes. 03495 nuk ka
12 thënë që të ketë qenë së bashku me 04669. A nënkupton kjo
13 thjesht që 01679 nuk tregon të vërtetën që ka qenë së bashku
14 me 04669?

15 Po të marrim rrëfimin e 1679, të 3594 apo të 3593, apo të
16 4669, nuk mund të kuptojmë se kush ka qëndruar me kë. Të
17 nderuar Gjykatës, si mund të arrijmë në një përfundim bazuar
18 mbi fakte dhe dëshminë se kush ka qëndruar me kë dhe në cilën
19 ndërtesë. ZPS-ja është përpjekur që ta bëjë këtë që të
20 përshtatet me argumentet e tyre. Por të gjitha këto rrëfime
21 nuk mund të jenë të vërteta në të gjitha pikat.

22 ZPS-ja përpiqet që në momentin e fundit të ndryshojë
23 numrin e ndërtesave në të cilat janë mbajtur njerëzit. Ata po
24 përpiqen që t'i ndryshojnë dëshmitë në një mënyrë që të
25 përshtaten me argumentin e tyre. Por është kjo një nga këpucët

1 që nuk të bien në numrin e këmbës. Si mund ta shpjegojë ZPS-ja
2 sesi është e mundur që 1679 është në ahur dhe shikon atje
3 viktimën e supozuar të vrasjes? Viktima e supozuar e vrasjes
4 ka arritur shumë më vonë se 1679.

5 Në qoftë se ZPS-ja ka pasur parasysh një numër më të madh
6 ndërtesash, atëherë Pala Mbrojtëse do të kishte pasur
7 mundësinë për të marrë në pyetje njerëz të tjerë, njerëz të
8 cilët mund t'i kenë shfrytëzuar këto ndërtesa. Të paktën do ta
9 kishim hetuar një gjë të tillë. Për sa i përket Palës
10 Mbrojtëse, dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi duhet të japin
11 dëshmi sërish me qëllim që ne të arrijmë në përfundimin se
12 cilat ndërtesa janë shfrytëzuar ndoshta nga njerëz të tjerë.

13 Pala Mbrojtëse do të kishte pasur kështu mundësinë që të
14 kërkonte, të gjente njerëzit e tjerë të cilët mund të kenë
15 qenë në këto ndërtesa, në qoftë se vërtet këto ndërtesa kanë
16 pasur njerëz aty. Këtë nuk e kemi bërë, por jemi përqendruar
17 në ndërtesën e vetme ku janë mbështetur edhe të gjithë
18 dëshmitarët. Dhe hetimi ynë do të kishte qenë i ndryshëm.

19 Pala Mbrojtëse ka gjetur njerëz të cilët ishin në atë
20 skenë por jo domosdoshmërisht në ndërtesat 4A apo 5, për shkak
21 se ne, njësoj si Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe
22 dëshmitarët, jemi përqendruar në atë që na kanë treguar
23 dëshmitarët. Dhe e gjithë kjo bën që gjyqi të jetë i padrejtë
24 dhe i akuzuari ka të drejtën e gjyqit të barabartë siç
25 parashikohet nga shumë ligje dhe traktate.

1 Për ta bërë në -- për ta ndryshuar konfiguracionin e
2 ndërtesave ku janë mbajtur njerëzit vetëm një javë përpara
3 fundit të gjyqit është e padrejtë për të akuzuarin për Palën
4 Mbrojtëse dhe hetimin. Ne kemi gjetur njerëz si Teuta Hadri,
5 Ibadete Canolli, Selatin Krasniqi, Muhamet Ajeti, këto ishin
6 njerëz të cilët ishin në terren në kompleksin e Zllashit.
7 Ishin këto që po punonin në odë. Ato kanë sjellë dhe pacientë
8 në odë për shkak se ajo u transferua në vendin ku mund të
9 operoheshin njerëzit.

10 Ne mund të kishim pyetur njerëz të tjerë, për shembull,
11 znj. Humolli, e cila ndodhej aty apo të tjerët që do të na
12 kishin treguar për ndërtesat e tjera që ndodheshin në atë
13 vend. Sigurisht, që qëndrimi ynë është që dëshmitarët e ZPS-së
14 nuk janë ndaluar në këtë kompleks. Nuk ishte e mundur fare.
15 Nuk ishte e mundur pasi kishte një numër shumë të madh
16 njerëzish, njerëz të zhvendosur brenda vendit.

17 Po le ta bëjmë të qartë, në qoftë se Trupi Gjykses është
18 në gjendje ta shqyrtojë që ZPS-ja ka ndryshuar qëndrimin e
19 saj, atëherë Pala Mbrojtëse dëshiron të dëgjojë nga
20 dëshmitarët e ZPS-së edhe një herë dhe duam të na jepet koha
21 për të hetuar dhe për të gjetur personat e tjerë që mund të
22 gjejmë që kanë qenë në atë vend në atë kohë dhe që mund të na
23 tregojnë lidhur me përdorimin e ndërtesave 4A dhe 5.

24 Qëndrimi ynë është që ne nuk mund t'i ndryshojmë
25 rregullat e lojës kur loja është mes të saj. Dhe ZPS-ja, nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 43

1 mund të ndryshojë qëndrimin e saj apo faktet bazë mbi të cilat
2 e kemi bazuar punën tonë që në fillim. Dhe më lejoni të shtoj
3 që edhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake është mashtruar, ose
4 kështu duket, nga ZPS-ja po t'i hedhim një sy vendimit të tij
5 për konfirmimin e Aktakuzës.

6 Ideja e tij dhe këtë mund ta shohim në citimet e vendimit
7 të tij, është që bëhet fjalë për vetëm një ndërtesë dhe jo për
8 shumë ndërtesa. ZPS-ja duhet të veprojë në një mënyrë që të
9 bëjë të mundur që gjyqi të jetë i barabartë dhe në bazë të
10 standardeve e të drejtave të njeriut. Ata nuk duhet të bëjnë
11 deklarata të pasakta përpara Trupit Gjykues dhe Dhomave të
12 Specializuara. Ata e kanë ditur shumë mirë se i kanë paraqitur
13 argumentet e tyre se faktet e tyre të paraqitura në fazën
14 fillestare ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga ato që na
15 paraqiten tani. Dhe bazuar mbi argumentet e paraqitura në këtë
16 pjesë të argumenteve tona gojore, ne besojmë që Aktakuza e
17 konfirmuar është e bazuar mbi faktin që ka qenë vetëm një
18 ndërtesë e vetme në të cilën të jenë mbajtur të ndaluar
19 njerëzit.

20 Identifikimi i Salih Mustafës nga viktimat.

21 W359 [sipas përkthimit] dhe 4669 nuk e kanë parë Salih
22 Mustafën kur ishin në Zllash apo që Salih Mustafa të ketë qenë
23 i pranishëm kur ata janë marrë në pyetje apo kur 4669 të jetë
24 rrahur. Nga dëshmia e 1679, nuk mund të provohet që në ditën e
25 arrestimit të dëshmitarit, komandanti i cili ka marrë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 44

1 pyetje dëshmitarin të ketë paraqitur veten si komandanti Cali
2 apo që dëshmitarja e ka parë Salih Mustafën kur -- ju kërkoj
3 ndjesë. Po filloj edhe njëherë, e nderuar Gjykatëse.

4 Nga dëshmia e 1679, nuk mund të provohet që në ditën e
5 arrestimit - më falni - nga dëshmia e 1679 nuk mund të
6 provohet që ditën e arrestimit të dëshmitarit komandanti i
7 cili e ka marrë në pyetje dëshmitarin ta ketë paraqitur veten
8 si komandant Cali pasi dëshmitari e ka parë Salih kur
9 dëshmitari ishte në Zllash.

10 Dhe po citoj nga dokumenti F00417-A02 dhe është në faqen
11 8, është dokumenti IMMO:

12 "Kur është pyetur, ka thënë që nuk e dinte se kush ishte
13 personi i njësisë së -- kush ishte komandanti i njësisë
14 speciale. Nuk [sipas përkthimit] e kishte njohur më vonë. E ka
15 mësuar nofkën e tij nga të bashkëburgosurit. Ai ka qenë aty me
16 shumë njerëz të tjerë të njësisë speciale në këtë ndërtesë.
17 Ata kishin uniforma të zeza. Ai personi në fjalë thotë që
18 shtatë apo tetë persona, përfshirë komandantin, kanë marrë
19 pjesë në tortura në momente të ndryshme".

20 Pyetjes së Prokurorit në faqen 868 të dëshmisë së këtij
21 dëshmitari, që është më datën 4 tetor:

22 "A keni dëgjuar ushtarë të tjerë që janë drejtuar
23 komandantit në mënyra të ndryshme?"

24 Komandanti [sipas përkthimit] tha:

25 "Jo, vetëm 'komandant'. Kam dëgjuar ushtarët e tjerë që

1 thoshin 'Komandant, e sollëm këtë të ri këtu' dhe aty e
2 kuptova që ai ishte komandant."

3 Prokurori ka pyetur dëshmitarin:

4 "Çfarë nënkuptoni?"

5 Përgjigje:

6 "Kuptova më vonë që ishte komandant."

7 Dëshmitari tha:

8 "E dija që më kanë dërguar përpara komandantit, por nuk e
9 dija emrin e tij. Ai nuk e ka paraqitur veten. Mua më çuan
10 para tij."

11 Pavarësisht faktit që Dëshmitari 1679 është më se i qartë
12 se kur është arrestuar, është dërguar përpara komandantit,
13 komandanti nuk e ka paraqitur veten me emër, Prokuroria
14 megjithatë vazhdon të bëjë pyetje lidhur me këtë situatë dhe
15 në faqen 873 të transkriptit zyrtar të datës 4 tetor. Pyetja
16 është:

17 "Pra, a ju kujtohet tani që kur ju kanë dërguar në
18 ndërtesë komandanti e ka paraqitur veten si komandanti Cali?"

19 Dëshmitari thotë:

20 "Atje e kuptova që ky person ishte komandanti Cali dhe
21 dëgjova kolegët e tij që e thërrisnin me emrin Cali dhe e dija
22 që ky person ishte komandanti Cali."

23 Pra, dëshmitari me përgjigjet e tij ka provuar faktin që
24 në asnjë kohë komandant Cali nuk e ka paraqitur veten si
25 komandant Cali apo me emrin Cali.

1 3593, nuk e ka provuar që dëshmitari ta ketë identifikuar
2 Salih Mustafën apo Calin në kohën kur ishte në Zllash. Në
3 dëshminë e tij gjatë seancës së gjyqit, ai ka thënë që nuk e
4 ka identifikuar po e ka pasur mundësinë të identifikojë asnjë
5 nga ato persona që e kanë rrahur për shkak se kishte një qese
6 në kokë, faqja 410 e transkriptit. Dëshmitari po kështu ka
7 deklaruar se nuk ka parë rrobat e njerëzve të cilët e kanë
8 rrahur pasi ishte shumë errësirë e plotë dhe ato kanë përdorur
9 bateri.

10 Dëshmitari dha dëshmi që asnjë prej tyre nuk kishte
11 kapele; faqe 310 e transkriptit. Dëshmitari mendon se i
12 akuzuari është personi që ia ka vendosur revolverin në kokën e
13 tij, faqe 411, 412 e transkriptit, pasi më vonë ai ka kuptuar
14 që i akuzuari është i vetmi person me kapelën e kuqe, faqe
15 412, pavarësisht se në atë moment nuk ka parë asgjë. Nuk ka
16 parë nëse ky person kishte një kapele të kuqe apo jo, faqe
17 413. Dhe në atë moment nuk ka dëgjuar personat e pranishëm që
18 t'i thërrisnin të tjerët me emër. Dëshmitari asnjëherë nuk ka
19 dëgjuar ndokënd që të japë urdhra apo udhëzime se ç'duhej bërë
20 apo që ndokush të fliste me personin i cili i ka vendosur
21 revolverin në kokën e tij. Faqe 414 e transkriptit. Dëshmitari
22 tha:

23 "Ai kishte veshur një uniformë dhe kishte një kapele të
24 kuqe. Kështu që po ta shihja sot nuk do ta dalloja dot. Nuk do
25 dalloja dot për shkak se ai nuk është interesuar përpara mua

1 dhe shpresoj që të mos e shoh kurrë në jetën time këtë
2 person".

3 Dëshmitari i çështjes, në rastin e dytë kur është rrahur,
4 nuk ka dëgjuar që dikush tjetër të përdorte emra ose nofka,
5 faqe 426. Dëshmitari tha që në kohën kur e kanë rrahur edhe
6 herën e parë edhe herën e dytë, në Zllash, nuk ka dëgjuar
7 ndokënd që të thërritej "komandant". Sipas dëshmitarit, më
8 vonë të tjerët i kanë treguar se i akuzuari ka qenë në vendin
9 ku është mbajtur ai i ndaluar dhe ishte personi kryesor, faqja
10 427 e transkriptit.

11 Dëshmitari gjatë rrahjes së parë nuk ka dëgjuar askënd që
12 të japë urdhër dhe gjatë rrahjes së dytë dëshmitari nuk ka
13 dëgjuar që personi me kapelën dhe me shkopin e bejsbollit t'i
14 ketë dhënë urdhër ndokujt, faqe 430 e transkriptit.

15 Dhe pyetjes së Kryegjykatëses:

16 "A kanë pasur maska ushtarët në vendin në Zllash ku jeni
17 mbajtur ju të parandaluar?"

18 Dëshmitari tha:

19 "Jo."

20 Më pas është konfrontuar, ballafaquar me deklaratën e tij
21 të mëparshme SPOE00127751 deri në SPOE00127752 dhe deklaroi:

22 "Nuk e mohoj. Ndoshta edhe mund ta kem thënë. Por, edhe
23 njëherë, po them se nuk mendoj që kishte maskë. Nuk isha në
24 gjendja të shikoja, po nuk besoj se kishte maskë."

25 Kryegjykatësja e Trupit Gjykses në faqen 678 të

1 transkriptit e pyet më tej dëshmitarin:

2 "Po dhe këtu bëhet fjalë për vitin në të cilin përmenda
3 numrat rendor, "ai tha 'Nuk e dija. Nuk e dija kush ishte
4 përgjegjës'. Pyetja ime është se përse nuk e përmendët ju
5 atëherë emrin që kishit dëgjuar, pra, një muaj pas lirimit?"

6 Dëshmitari në faqen 679 të transkriptit deklaroi:

7 "Po, për Zotin, nuk e di se përse nuk e kam thënë. A kam
8 harruar. Sepse po të më pyesnit dhe çfarë the dje ndoshta e
9 harroj sërish. Më kanë pyetur rreth 200 herë për të njëjtat
10 gjëra. Por, siç e thashë, e kam mësuar se kush ishte ky person
11 një muaj pasi isha liruar."

12 Kryegjykatësja në faqen 680 të transkriptit pyet sërish:

13 "Ndoshta harruat që t'u tregoni të vërtetën. Këtë deshët
14 të thoshit? Dhe që nuk e keni treguar të vërtetën në atë kohë
15 në atë deklaratë."

16 Dhe dëshmitari tha:

17 "Po, po."

18 Dhe dëshmitar më pas tha:

19 "Nuk kishte nevojë që të mos tregoja të vërtetën, por po
20 e them edhe një herë, ndoshta kam harruar dhe më pas më është
21 kujtuar. E verifikova identitetin një muaj më vonë."

22 Kryegjykatësja në faqen 680 të transkriptit pyet
23 dëshmitarin:

24 "Po juve ju kanë pyetur në mënyrë të posaçme. Ju pyetën
25 në mënyrë të hapur. Dhe thatë, 'Jo, nuk më kujtohet. Nuk e di.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 49

1 Nuk thatë, 'Nuk më kujtohet'. Ju kërkoj ndjesë. Po ju thatë,
2 'Nuk e di'. Dakord. A mund të jetë e mundur që ju kishit frikë
3 të tregonit të vërtetën?"

4 Dëshmitari tha:

5 "Jo, nuk kishte pse të kisha frikë. Nuk kishte arsye. Unë
6 kam ardhur për t'ju treguar të vërtetën. Jo për të gënjyer."

7 Dhe në fund, në faqen 681 të transkriptit, Kryegjykatësja
8 pyet:

9 "Po a nuk e kuptoni, që nga pikëpamja e Trupit Gjykses,
10 ne po përpiqemi të kuptojmë se përse në një moment të caktuar
11 kohor ju thoni një gjë dhe më pas ju thoni një gjë tjetër?"

12 Dhe dëshmitari deklaroi:

13 "Kjo ndodh kur njeriu harron ose kur nuk di ose kur ai
14 apo ajo gabon."

15 Çështja e fundit, e nderuar Gjykatëse, është --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.
17 Është ora 11.00 është koha për të marrë pushimin.

18 Cilët janë temat që ju kanë mbetur?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Përgjigjet ndaj katër pyetjeve të
20 Panelit. Kaq më ka mbetur.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Dakord.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe rreth 10 minuta.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
25 duhet të respektojmë oraret e pushimeve. Vetëm në raste

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 50

1 domosdoshmërie e bëjmë një gjë të tillë. Por kemi gjithë ditën
2 përpara.

3 Pra, tani ne do të ndalojmë me seancën për gjysëm ore dhe
4 do të rifillojmë punimet në orën 11.30.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
6 Gjykatës.

7 --- Pauza fillon në orën 11.02

8 --- Seanca rifillon në orën 11.31

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
10 se u kthyet.

11 Avokat, përpara se t'jua fjalën, më lejoni që të shikojmë
12 se kush janë të pranishëm në sallë, të shohim se çfarë
13 përbërje ka secili prej ekipeve.

14 Zyra e Prokurorit të Specializuar.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Përbërja është e njëjtë. Z.
16 Jack Smith për momentin nuk është me ne, por mendoj se do vijë
17 këtu për pak çaste.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Avokate e Viktimave, më duket se ju jeni në të njëjtën
21 përbërje siç ishit paradite apo jo.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Avokati i Mbrojtjes.

25 Shoh që Prokurori i Specializuar ka mbërritur për

1 procesverbal.

2 Dhe z. Mustafa është me videolidhje.

3 Avokat, fjala për juve për të vazhduar.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
5 Gjykatëse, anëtarë të Trupit Gjykses.

6 Tani do të kalojmë tek përgjigjet ndaj pyetjeve që na
7 janë bërë për parashtrimin.

8 Pyetja e parë është: Në qoftë se Trupi Gjykses është
9 detyruar që të zbatojë kufij konkretë pasues më të favorshëm
10 për krimet e parashikuar në të drejtën kosovare, pra, në
11 ligjin kosovar apo duhet që dënime të tilla të jenë vetëm
12 thjesht udhëzuese për Trupin Gjykses, pra, duhet marrë
13 parasysh, sugjeron që Trupi Gjykses thjesht duhet që të
14 udhëzohet për një dënim më të favorshëm.

15 Mbrojtja parashtron që Trupi Gjykses është i detyruar që
16 të zbatojë dënim më të favorshëm për krimet e kryera në të
17 drejtën e Kosovës, pra, në ligjin kosovar. Vetë formulimi në
18 këtë kontekst "duhet marrë parasysh" e nënkupton këtë gjë dhe
19 është detyruese në natyrë. "Të marrësh diçka parasysh" mund të
20 tejkalohe duke thënë që "ne mund të marrim" ose "mund të mos
21 marrim". Ndërkohë që "duhet" do të thotë që ekziston detyrimi
22 për ta bërë këtë gjë.

23 Dhomat e Specializuara të Kosovës janë një gjykatë
24 kombëtare. Kjo nuk është gjykatë ndërkombëtare, nuk është një
25 gjykatë e krijuar nga një organizatë ndërkombëtare. Kjo është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 52

1 një gjykatë që është e krijuar mbështetur në ligjet e Kosovës.
2 Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetur në nenin 65(1) të
3 Kushtetutës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Dhomat e
4 Specializuara të Kosovës.

5 Dhomat e Specializuara funksionojnë brenda sistemit të
6 drejtësisë së Kosovës. Për rrjedhojë, është veçse logjike që
7 kur një gjykatë e Kosovës të gjykojë çështjet, ata nuk mund ta
8 anashkalojnë, nuk mund të lënë mënjanë, ligjet sikurse ato
9 zbatohen në Kosovë.

10 Tani le të kalojmë tek përgjigja për pyetjen 2, të
11 nderuar Gjykatës.

12 Neni 44(2) (b) thotë, ndonjë dënim më të favorshëm për
13 krimet të cilat parashikohen në ligjin e Kosovës. Pyetja
14 është: Në çështjen në fjalë krimi për të cilën i akuzuar
15 gjykohet fajësia e të akuzuarit nuk parashikohet në ligjin e
16 Kosovës, por në të drejtën ndërkombëtare zakonore, kështu që
17 çfarë ligjesh të tjera janë të zbatueshme, në qoftë se Trupi
18 Gjykues vendos që të marrë parasysh vendime të cilat janë më
19 të favorshme për të akuzuarin për krime të tilla?

20 Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykues duhet të zbatojë
21 ligjin në vend që ekzistonte në kohën e Aktakuzës. Dhe
22 përderisa ligji nuk është zëvendësuar nga asnjë ligj i
23 Kosovës, do të thotë që ligji në atë kohë, pra, ligji në atë
24 kohë në atë vend ishte Kodi Penal i Republikës Socialiste
25 Federale të Jugosllavisë.

1 Përveç Kodit Penal të ish-Jugosllavisë të Kosovës 1977,
2 është në fuqi edhe Ligji Penal i Provincës Autonome Socialiste
3 të Kosovës të vitit 1977 gjatë periudhës së Aktakuzës. Në
4 qoftë se ky ligj është ende sot e kësaj dite në efekt nuk ka
5 rëndësi, pasi ky ligj zbatonte kodin e ish-Republikës Federale
6 të Jugosllavisë për zbatimin e dënimit.

7 Në vendosjen e dënimit, neni 6 i ligjit diskuton
8 qëllimet e dënimit. Paragrafi i parë i këtij neni parashikon
9 si më poshtë:

10 "Objektivi i dënimit duhet të arrihet përmes ekzekutimit
11 të vendimeve dhe dënimeve siç parashikohet në ligjin penal të
12 SFRJ."

13 Mbrojtja parashtron se udhëzimet lidhur me dënimin
14 gjenden në Kodin Penal të Jugosllavisë në paragrafin 1. Duke
15 marrë parasysh këtë, Mbrojtja parashtron se në kohën e
16 Aktakuzës krimi i ndalimit arbitrar nuk ekzistonte në ligjin e
17 Kosovës dhe Kosovën e kanë venë në thonjëza këtu, që në atë
18 kohë ishte ligji i SFRJ-së.

19 Në qoftë se një ligj nuk është i parashikuar me ligj,
20 atëherë nuk mund të dënosh dikë.

21 Koncepti i *nulla poena sine lege*, domethënë, nuk ka dënim
22 pa parashikim ligjor, është një element shumë i rëndësishëm në
23 këtë kontekst. Ky është një parim i përgjithshëm i së drejtës
24 penale.

25 Ligji i vendit në kohën që pretendohet të jenë kryer

1 krimet ishte Kodi Penal i Republikës Socialiste Federale të
2 Jugosllavisë në Kosovë në vitit 1977. Neni 142 parashikon
3 aktet penale kundër njerëzimit dhe të drejtën ndërkombëtare.
4 Ky nen flet për arrestimin e paligjshëm dhe ndalimin e
5 paligjshëm dhe parashikon gjithashtu edhe dënimet prej jo më
6 pak se pesë vite heqje lirie ose dënim me vdekje.

7 Sa i takon popullsisë civile, siç parashikohet nga neni
8 141 [sipas përkthimit], çfarë mund të ngrihet si pyetje është
9 që, në qoftë se "popullsia civile e armikut", është i
10 parashikuar dhe mbulohet nga neni 4 i Konventës së Gjenevës,
11 ashtu siç e diskutuam dhe më herët sot. Askush nga civilët të
12 cilët janë të përfshirë në këtë çështje dhe që janë të ndaluar
13 nuk ishin serb.

14 Njerëzit e ndaluar në këtë çështje ishin nga Kosova. Në
15 fakt, ata ishin pjesë e popullsisë së SFRJ-së. Krimet e
16 pretenduara kanë ndodhur në territorin kosovar të ditëve të
17 sotme ose në territorin jugosllav të asaj kohe, kështu që
18 civilët në diskutim thjesht ishin në vendin e tyre, në
19 shtëpitë e tyre. Por neni, padyshim, mundohet që të mbrojë
20 popullsinë civile nga armiku. Konventat e Gjenevës, në
21 përgjithësi, kanë qenë dhe janë të hartuara sipër konfliktet e
22 armatosura të një karakteri ndërkombëtar dhe konfliktet e
23 armatosura të një karakteri jokombëtar. Këto konventa
24 nënkuptojnë që ka dy ose më shumë palë në një konflikt.

25 Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës ka të bëjë

1 ose i drejtohet një pale në atë konflikt dhe ndalon veprimet e
2 një lloji të caktuar ndaj popullsisë civile të armikut. Siç e
3 diskutuam dhe më herët, SFRJ-ja ishte në konflikt në atë kohë
4 me NATO-n, civilët në këtë çështje nuk ishin të mbrojtur pasi
5 ose nuk mbrohen për shkak të faktit se ata shtetas --

6 Dhe përveç kësaj, dëshiroj që të shtoj gjithashtu, se
7 mbase në dy raste, pra, në rastin e 4669 dhe 1679, ishin të
8 paktën njerëz të cilët kishin marrë pjesë në trajnime dhe
9 madje dhe njëri prej tyre kishte përfunduar dhe trajnimin. E
10 kam fjalën posaçërisht këtu për 4669. Sa i takon statusit të
11 këtyre dy personave, nuk e di në qoftë se këta mund të
12 konsiderohen si pjesë, domethënë, këta nuk mund të
13 konsiderohen si pjesë e mbrojtjes që ofrohet nga nenet e
14 përbashkëta 3 të Konventave të Gjenevës, pikërisht, për faktin
15 se e përmendur më sipër.

16 Tani më lejoni të kaloj tek përgjigja për pyetjen 3.

17 Pyetja që bëhet është kjo: Bazuar në nenin 44(2)(c) të
18 ligjit, në çfarë rrethanash dënimi i një veprimi ose
19 mosveprimi që ka qenë penal, kriminal në natyrë në parim me
20 parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të njohura
21 nga kombet e civilizuara do të cenonte zbatimin e paragrafit
22 2(a), (b) të nenit 44 të ligjit.

23 Mbrojtja i parashtron Trupit Gjykses që neni 44(2) nuk
24 ofron fare opsion për gjykatën për të zgjedhur një prej
25 opsioneve të parashikuara prej tij. Nuk mund të përzgjidhet në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 56

1 mënyrë rastësore nga paragrafi 2, nënparagrafi a, b, c, sipas
2 dëshirës së gjykatës. Një interpretim i tillë do të çonte në
3 një përzgjedhje rastësore dhe i akuzuari duhet të ketë siguri
4 juridike lidhur me mënyrën sesi dhe me çfarë baze një çështje
5 gjykohet dhe mbi ç'bazë jepet dënimi përkatës.

6 Dhomat e Specializuara të Kosovës janë gjykatë kombëtare.
7 Janë një gjykatë kombëtare e Kosovës. Dhomat e Specializuara
8 nuk janë, për shembull, TPNJ, nuk janë një gjykatë *ad hoc* që
9 ka juridiksion të mbivendosur. TPNJ-ja nuk mund të krahasohet
10 me Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ligji për Dhomat e
11 Specializuara të Kosovës është një ligj kombëtar, pavarësisht
12 se i natyrës *lex specialis*. Për rrjedhojë, ligji i Kosovës nuk
13 është vetëm thjesht një përzgjedhje opsionale për Dhomat e
14 Specializuara por është një instrument i detyrueshëm ligjor
15 për ta për t'u zbatuar.

16 Mund ta shohim këtë edhe në nenin 44 të ligjit. Neni 44 i
17 ligjit, paragrafi 2, parashikon së pari se nënpika (a) duhet
18 të zbatohet. Nënpikat (b) dhe (c) janë të ndërlidhura. Kjo
19 mund të lexohet në tekstin e thjeshtë të këtij neni. Fjala e
20 fundit në nënparagrafin (b) është fjala "dhe" që tregon sesi
21 pika (b) dhe pika (c) do të duhen që të zbatohen së bashku ose
22 në lidhje me njëra-tjetrën.

23 Edhe po të jetë kështu, pra, në qoftë se nënparagrafi (a)
24 dhe (b) do të zbatoheshin në lidhje me njëri-tjetrin, sërish
25 zbatohet parimi *lex mitior* siç ai parashikohet në nenin 15 të

1 Traktatit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike të
2 parashikuar në nenin 15 dhe këtu citoj.

3 "Askush nuk deklarohej fajtor për vepra penale për shkak
4 të veprimeve ose mosveprimeve të cilat nuk kanë përbërë një
5 vepër penale, sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare, në
6 kohën kur është kryer krimi përkatës. Nuk do të jepet një
7 dënim më i rëndë sesa dënimi që ka qenë i zbatueshëm në kohën
8 kur është kryer vepra penale. Nëse, pas kryerjes së veprës
9 penale, të bëhet parashikim me ligj për vendosjen e një dënimi
10 më të lehtë, kryesi do të përfitojë nga dënimi më i
11 favorshëm."

12 Dhe, pra, këtu kemi mishërimin e parimit të *lex mitior*.

13 Mbrojtja parashtron se neni 44, paragrafi 2, pika (a)
14 qëndron e mëvetësishme, në mënyrë të mëvetësishme, e pavarur
15 nga nënparagrafet e tjerë. Ndërkohë që pika (b) dhe (c) duhet
16 që të zbatohen në lidhje me njëra-tjetrën. Kjo jepet
17 shprehimisht e specifikuar në tekst. Për derisa Dhomat e
18 Specializuara të Kosovës janë gjykatë kombëtare, logjikisht
19 rezulton se pika (a) e këtij paragrafi qëndron më vete. Dhe,
20 për rrjedhojë, logjika të thotë që parimi që ligji kombëtar i
21 Kosovës ka epërsi për dënimin për akte të caktuara është fakt
22 dhe si rezultat, pra, e drejta kosovare ka epërsi ndaj
23 parimeve më të përgjithshme të ligjit.

24 Për rrjedhojë, Mbrojtja parashtron se neni 44(2)
25 paragrafi (c) nuk është një nen që qëndron i mëvetësishëm dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 58

1 nuk mund të jetë i izoluar por duhet të zbatohet në kombinim
2 me pikën (b) të të njëjtit nen.

3 Tani, të nderuar Gjykatës, do kaloj tek pyetja e katërt.

4 Mbrojtja ka mendimin që, bazuar në nenin 44(2)(b) të
5 ligjit, Trupi Gjykses është i detyruar nga ky nen dhe duhet ta
6 zbatojë atë në çështjen sa i takon vlerësimit të peshës së
7 dënimit, si dhe për të marrë parasysh vendimin më të
8 favorshëm, si dhe për të zbatuar nenin 38 të ligjit penal të
9 Jugosllavisë të vitit 1976 dhe të gjithë paragrafët e tij,
10 domethënë, nga paragrafi 1 deri paragrafin 6.

11 Pavarësisht kësaj përmbajtja e dispozitës 44(2)(b) të
12 ligjit, Trupi Gjykses po ashtu është i detyruar që të zbatojë
13 nenin 41, paragrafi nga 1 deri në 3 të Republikës Socialiste
14 Federale të Jugosllavisë, sa i takon peshimit të dënimit,
15 rregullave të përgjithshme për peshimin e dënimit; po ashtu
16 neni 42, paragrafi 1, nënparagrafi 1 deri në 2, ulja e dënimit
17 të ish-Republikës Jugosllave, RSFJ-së; dhe gjithashtu edhe
18 nenin 43, paragrafi 1, 3, mënyrat e uljes së dënimit të SFRJ-
19 së; dhe, së fundi, neni 48, paragrafi nga 1 deri në 6,
20 kombinimi i veprave penale të SFRJ-së, të kodit të SFRJ-së.

21 Të nderuar Gjykatës, konstatimi i fundit i Mbrojtjes sa i
22 takon argumenteve të dhëna me gojë lidhur me dënimin është si
23 më poshtë.

24 ZPS-ja kërkon 35 vite dënim me burgim për Salih Mustafën.

25 Mbrojtja kërkon shpalljen jofajtor të z. Mustafa për

1 asnjë nga akuzat për të cilat ai akuzohet. Ai nuk ka kryer
2 asnjë krim asnjëherë. Ai e ka vendosur veten e vet në rrezik
3 për shumë njerëz ndërkohë që i shërbente objektivit të
4 përgjithshëm të të gjithë popullit të Kosovës, që ishte fitimi
5 i pavarësisë për njerëzit që kishin luftuar për të qenë të
6 lirë për një periudhë të gjatë kohe.

7 Z. Mustafa ka duruar një periudhë të vështirë dhe të
8 gjatë të ndalimit të tij. Ai ka vuajtur paraburgimin, nuk ka
9 shkelur asnjë prej urdhrave që janë përcaktuar nga Trupi
10 Gjykues. Kontaktet me familjen e tij kanë qenë shumë të
11 vështira, megjithatë ai me shumë durim i ka duruar [REDAKTUAR]
12 [REDAKTUAR]
13 [REDAKTUAR]

14 Megjithatë, ai nuk ka shkelur asnjë prej urdhrat e dhëna.

15 Z. Mustafaj i vjen keq për viktimat, por ai nuk është
16 përgjegjës as për dhimbjen dhe as për vuajtjet e tyre.

17 Z. Mustafa, mohon se ka kryer asnjë nga akuzat për të
18 cilat ai akuzohet dhe kjo është e drejta e tij. Pasojat e një
19 pozite të tillë të çon natyrshëm në përfundimin se ai nuk ka
20 asnjë përgjegjësi penale lidhur me atë se çfarë kanë përjetuar
21 viktimat. Të mohosh pozicionin e të akuzuarit do të thotë që
22 t'i mohosh atij të drejtat themelore. Prezumimi i pafajësisë
23 nuk do të kishte pikë vlere në qoftë se nxirren deduktime nga
24 një pozicion i caktuar që mban i akuzuari.

25 Z. Mustafa është i paraburguar që prej shtatorit të vitit

1 2020. Z. Mustafa është baba dhe është bashkëshort. Ndërkohë që
2 Mbrojtja kërkon pafajësi për z. Mustafa për të gjitha akuzat e
3 ngritura ndaj tij, z. Mustafa duhet që të lirohet sa më shpejt
4 të jetë e mundur.

5 Dëshiroj të theksoj se Mbrojtja dhe, i drejtohem këtu
6 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ne asnjëherë nuk kemi
7 implikuar, nuk kemi deduktuar që viktimat të cilat kanë dhënë
8 dëshmi në këtë çështje kanë fabrikuar, kanë prodhuar apo
9 sajuar historitë e tyre siç ka deklaruar ZPS-ja në deklaratën
10 e vet. Ne nuk e kemi bërë këtë në të shkuarën, nuk e bëjmë sot
11 dhe nuk do ta bëjmë asnjëherë. Për rrjedhojë, është e gabuar
12 që të nxirret ky përfundim ose të thuhet një gjë e tillë.

13 Vetëm thjesht pozita, qëndrimi i Mbrojtjes është
14 tërësisht i ndryshëm dhe kemi mendime të ndryshme sa i takon
15 vendit të pretenduar të krimit apo për sa i takon gjërave që
16 kanë ndodhur apo jo dhe, në qoftë se z. Mustafa ka pasur
17 ndonjë lidhje apo lidhur me vendin ku mund të kenë qëndruar të
18 ndaluar personat ose nga ku mund të kenë kaluar lëndime.

19 Kjo do të thotë se në këtë rast, mendoj se Prokuroria
20 është e gabuar kur e thotë një gjë të tillë.

21 Gjykimi i çështjeve si kjo çështje sigurisht që nuk është
22 detyrë e thjeshtë. Sigurisht, që drejtësia nuk mund të
23 mbështetet në emocione apo në dhembshurinë ose ndjesinë dhe të
24 asnjë lloj natyre. Përvojat, sado të vështira të kenë qenë dhe
25 të përkthyer në zërin e dëshmimeve, mund të heqin qartësinë për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 61

1 të gjykuar një çështje. Megjithatë, në fund, Gjykata nuk duhet
2 të gjykojë mbi probabilitetin ose mbi dhembshurinë. Drejtësia,
3 pra, duhet të vendoset përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, akuzat
4 duhet të provohen. Dhe prandaj dëshmitë do të duhet të
5 testohen. Të testohen nga Prokuroria, nga Mbrojtja, nga Trupi
6 Gjykues dhe duhet të testohen po ashtu edhe të analizohen,
7 duke u shkëputur tërësisht nga sentimentet dhe nga emocionet.
8 Një testim dhe një analizë e tillë është detyrë e secilit prej
9 nesh në një çështje që gjykohet në Gjykatë. Për më tepër,
10 duhet që të zbatohet ligji dhe duhet që të ekzistojë një
11 "bindje e plotë" që i akuzuari i ka kryer këto akuza. Dhe ne
12 besojmë që duhet të vendoset drejtësi.

13 Faleminderit. E përfundojmë këtu me parashtrimet tona.
14 Duam që të falënderojmë të gjithë, Trupin Gjykues,
15 përkthyesit, transkriptuesin dhe ju faleminderit dhe njëherë
16 të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues për vëmendjen.
17 Faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit, Avokat.

20 Tani le të planifikojmë pak çfarë do të bëjmë.

21 Shikoj Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Atëherë tani
22 do të dëgjojmë përgjigje së pari nga ZPS-ja, pastaj nga
23 Avokatja e Viktimave, lidhur me pika që u ngritën në
24 deklaratën përmyllëse të Mbrojtjes.

25 Z. Prokuror, a jeni gati që të fillojmë menjëherë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 62

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, jemi
2 gati të fillojmë menjëherë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 mirë. Do t'jua jap juve fjalën tani dhe do vazhdojmë deri në
5 orën 13.00. Në parim në orën 13.00 do të bëjmë pushimin e
6 drekës.

7 Fjalën e keni ju.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 anëtarë të Trupit Gjygues, që na dhatë mundësinë që të
10 shprehem në këtë seancë kundërpërgjigjëse.

11 Si çështje fillestare, për vlerësimin e kredibilitetit të
12 dëshmitarëve, pavarësisht në qoftë se ata thërriten nga ZPS-ja
13 apo nga Mbrojtja, një aspekt shumë i rëndësishëm është
14 motivimi i dëshmitarëve. Cili ka qenë motivimi i dëshmitarëve
15 kur kanë dhënë dëshmi.

16 Lidhur me pjesën dërrmuese të dëshmitarëve të Mbrojtjes,
17 kjo është një çështje e cila mund të zgjidhet, mund të marrë
18 një përgjigje nga Gjykata duke bërë një pyetje shumë të
19 thjeshtë: Në qoftë se tregimi i të vërtetës përpara kësaj
20 Gjykate do të thoshte që të nxjerrësh diçka që është kundër
21 interesave të Salih Mustafës, a do ta bënin një gjë të tillë
22 ata?

23 Për Brahim Mehmetajn, Bimi, që ka qenë zëvendësi besnik i
24 të akuzuarit, pra, kjo do të thoshte që ai nuk kishte asnjë
25 detyrim për të treguar të vërtetën por për të qëndruar [sipas

1 përkthimit] besim dhe për të treguar dualitet ndaj të
2 akuzuarit.

3 Në qoftë se Salatin Krasniqi dhe Muhamet Ajeti, ushtarë
4 të tjerë që i kanë shërbyer të akuzuarit, në qoftë se e dinin
5 që në qoftë se do të tregonin të vërtetën do të dëmtonin
6 mbrojtjen e të akuzuarit, a do ta bënë këtë gjë përpara
7 Gjykatës?

8 Provat, dëshmitë në këtë çështje nuk lënë pikë dyshimi.
9 Ata thanë atë çfarë ishte e nevojshme për të ndihmuar shokun e
10 tyre dhe mikun e tyre të luftës, të akuzuarin. Motivet e
11 dëshmitarëve të akuzës janë në kontrast të plotë me motivimet
12 e dëshmitarëve të ZPS-së edhe të viktimave, interesi i të
13 cilëve ishte që personat që kanë qenë përgjegjës për
14 torturimin e tyre më në fund, mbas 23 vitesh, do të mund të
15 mbanin përgjegjësi.

16 Mbani mend, të nderuar Gjykatës, atë çfarë ju kërkua
17 viktimave që të jepnin dëshmi këtu, pra, dëshmi kundër një
18 komandanti të UÇK-së.

19 Ky dallim i jashtëzakonshëm në motivim dhe besueshmëri
20 ndërmjet viktimave dhe shokëve të luftës të ish të akuzuarit
21 është edhe më i dukshëm dhe më i pranishëm kur shikojmë në
22 qoftë se a ka pasur të burgosur të cilët janë mbajtur në
23 kompleksin e Zllashit. Viktimat na treguan historitë e tyre
24 personale, treguan histori të gjërave jashtëzakonisht të rënda
25 që ju kishin ndodhur atyre në këtë kompleks. Dhe dëshmitarët

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 64

1 të cilët ishin të frikësuar dhe shumë jobashkëpunues, të
2 tillë, si për shembull, Dëshmitari 3594, pranoi se ai ishte
3 mbajtur në një kompleks të tillë bashkë me të ndaluar të
4 tjerë.

5 Ndërkohë, dëshmitarët e Mbrojtjes mohuan se kishte pasur
6 të ndaluar në këtë kompleks.

7 Qartazi ose këto viktimat ose dëshmitarët e Mbrojtjes ose
8 njëra palë ose tjetra nuk e ka thënë të vërtetën, të nderuar
9 Gjykatës. Dikush ka gënjyer këtu. Dikush që nuk ka pikë
10 respekti për detyrimin për të treguar, për të thënë të
11 vërtetën përpara kësaj Gjykate.

12 Jo vetëm se cila prej viktimave në mënyrë shumë të
13 besueshme tregoi historinë e vet për ndalimin në këtë
14 kompleks, por historitë e tyre konfirmoheshin nga njeri-
15 tjetri, mbështeteshin, provoheshin nga njëri-tjetri dhe nga
16 provat e pavarura të viktimave do të ishte e pamundur që të
17 kishte një përkueshmëri të tillë, në qoftë se do të ishin
18 sajuar ose do të ishin krijuar vetë nga dëshmitarët.

19 Nga ana tjetër, nga pala tjetër, ne kemi miq, ish-miq të
20 të akuzuarit, si për shembull, z. Salatin Krasniqi, i cili u
21 largua nga stalla pasi u torturuan viktimat. Dhe i cili tha që
22 nuk e kishte parë asnjëherë Muhamet Ajetin atje, megjithëse z.
23 Ajeti vetë tha që kishte qenë atje. Të cilit i vinte për shtat
24 që të thoshte që i akuzuari ishte ndërmjet udhëheqësve të UÇK-
25 së, pavarësisht se nuk e dinte, s'e tha ose pretendoi që nuk e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 65

1 dinte që ai ishte komandant i BIA-s. Ai po ashtu tha që nuk e
2 dinte se në çfarë njësiti të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
3 ishte pjesë ai deri më 17 prill, drejt fundit të periudhës së
4 Aktakuzës.

5 Citoj Selatin Krasniqin këtu në dëshminë e dhënë më datë
6 21 prill 2022. Në faqen 3594.

7 Pra, të nderuar Gjykatës, është në dorën tuaj të merrni
8 vendim se kë të besoni.

9 Përpara se të vazhdoj, të nderuar, sot në mëngjes
10 Mbrojtja bëri akuza ndaj ZPS-së, duke pretenduar, pa bazë, se
11 ZPS-ja, për herë të parë, e ka ndryshuar qëndrimin e vet gjatë
12 ecurisë e kësaj çështjeje lidhur me të burgosurit dhe vendin
13 ku ta janë mbajtur në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe
14 kështu, e ka mashtruar jo vetëm Mbrojtjen por Trupin Gjykses
15 të nderuar dhe Gjykatësin e Procedurës paraprake.

16 Të nderuar Gjykatës, asgjë nuk mund të jetë më larg të
17 vërtetës. Për këtë çështje, dëshmitarët e ZPS-së dëshmuan në
18 mënyrë konsekuente lidhur me vendin e ndalimit si në
19 deklaratat paragjyqësore por edhe në Gjykatë kur erdhën
20 përpara të dëshmuar. Mbrojtja ka pasur qasje në të gjitha këto
21 deklarata dhe ka dëgjuar edhe dëshmitë e tyre gjatë gjithë
22 kohës. Ata kanë pasur qasje prej muajsh në këto deklarata të
23 ZPS-së.

24 Qëndrimi ynë në lidhje me këtë çështje është bërë i qartë
25 edhe më shumë në parashtrimet tona. Pikë së pari, në dosjen

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 66

1 paragjyqësore, ne kemi vënë në dukje se të gjithë viktimat
2 janë mbajtur në një vend që është quajtur kompleksi i ndalimit
3 në Zllash dhe asnjëherë nuk kemi vënë në dukje ndonjë ndërtesë
4 konkrete ku ata janë mbajtur, një ndërtesë.

5 Më pas, në dosjen gjyqësore, gjithashtu e bëmë mjaft të
6 qartë se ku janë mbajtur të ndaluarit në këtë kompleks. Dhe,
7 së fundi, e sqaruar pozicionin tonë në përgjigje të vendimit
8 tuaj për ndërtesat konkrete brenda kompleksit të ndalimit në
9 Zllash ku janë mbajtur viktimat dhe ky parashtrim i është vënë
10 në dispozicion Mbrojtjes.

11 U përmend një argument konkret lidhur me 4669, por ky
12 dëshmitar dëshmoi në këtë Gjykatë për ndërtesën ku ai është
13 mbajtur. Ai deklaroi të njëjtën gjë dhe në deklaratën e dhënë
14 ZPS-së disa muaj përpara se të fillonte gjykimi.

15 Pra, ne besojmë se ZPS-ja nuk e ka ndryshuar qëndrimin e
16 vet kur vjen puna tek ndërtesat ku mbaheshin viktimat, kështu
17 që kjo nuk ishte diçka e singertë nga ana e Mbrojtjes që
18 pretendoi ndryshe.

19 Të kthehemi tani tek alibia, shkurtimisht, e Mbrojtjes.
20 Në fakt, nuk është një alibi fare kjo. Nëse dëshmia se i
21 akuzuari ka qenë në një vend tjetër, në Shqipëri të themi, në
22 Mal të Zi apo në Serbi apo në Zvicër dhe si rrjedhojë nuk
23 kishte sesi t'i kryente këto krime për të cilat akuzohet, kjo
24 është një alibi. Kjo është një alibi.

25 Këtu, dëshmitarët e Mbrojtjes thjesht provuan se i

1 akuzuari ka qenë ose në Zllash ose përreth Zllashit për gjithë
2 periudhën e Aktakuzës. Kur i akuzuari ishte larg tij kishte
3 mundësi të përdorte një makinë dhe çdo dëshmitar i Mbrojtjes,
4 pra, ka thënë që i akuzuari mund të ketë qenë në Barilevë në
5 prill, që është 31 kilometra larg Zllashit. Vetëm 31 kilometra
6 larg.

7 Të kesh mundësi të kesh një makinë të lejon, në këtë rast
8 e ka lejuar të akuzuarin, që të udhëtonte, ta bënte këtë
9 distancë brenda një periudhe të shkurtër.

10 Për sa i takon distancës, largësisë nga Zllashi në
11 Barilevë. Është e vërtetë se asnjë nga dëshmitarët nuk
12 përmendi një distancë konkrete, por Gjykata mund të marri
13 njoftimin gjyqësor të fakteve, që është diçka e ditur nga të
14 gjithë, sipas nenit 37, paragrafi 4 i ligjit. Barileva, sipas
15 Hartave të Google, është 31 kilometra me rrugë nga Zllashi dhe
16 të njëjtat rrugë kanë ekzistuar edhe në 1999.

17 Pra, shkurt, lidhur me alibinë, nuk është alibia që ka
18 paraqitur Mbrojtja, pavarësisht nga forma apo mënyra sesi e ka
19 përmendur, nuk është për t'u besuar.

20 Tani ia jap fjalën kolegut De Minicis, të shtjellojë një
21 çështje tjetër që kërkon kundërpërgjigje nga ne si Prokurori.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Keni fjalën, z. Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Përshëndetje. Të nderuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 68

1 Gjykatës, dje Mbrojtja përmendi dëshminë e Dëshmitarit 4669,
2 tregoi fotografi, diagrame për të argumentuar se ky dëshmitar
3 nuk kishte si ta ketë parë të akuzuarin në kompleks nga
4 ballkoni kur ka dorëzuar viktimën e vrasjes.

5 Kërkoj leje për të paraqitur në ekran provën REG00013.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Vazhdoni, ju lutem.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Këtu kemi një fotografi të
9 shënuar nga Selatin Krasniqi që tregon këtë kompleksin e
10 ndalimit.

11 Mbrojtja argumentoi se, nga pika 9 nuk kishte si të
12 shikohej Salih Mustafa në ndërtesën që shënohet në ndërtesën
13 që shënohet me numrin 2 deri 5. Nuk shikohej sepse në atë kohë
14 që është marrë ndërtesa, nuk shihej.

15 Këtu spekulon Mbrojtja dhe është vetëm spekulim, se ai
16 vështrimi i tij pengohej nga ndërtesa 7. Dhe kundërshtimi
17 gjendet në faqet 64 dhe 67 të transkriptit provizor të
18 djeshëm.

19 Megjithatë, ato që tha Mbrojtja janë të paplota dhe të
20 pavërteta. E vërteta është shumë e thjeshtë. Sepse dëshmitari
21 e solli viktimën në kompleks, ai hyri në oborr dhe e shikonte
22 qartë ndërtesën ku i akuzuari, Salih Mustafa, rrinte në
23 ballkon.

24 Dhe po e ilustronj. Avokati i Mbrojtjes lexoi gjerë e
25 gjatë nga dëshmia e 4600 por la jashtë një pjesë kryesore. Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 69

1 përshkrimin dhe ai tha dhe po ju referoj dëshminë e tij të 23
2 shtatorit 2021:

3 "Ne ndaluan te dera, përpara derës dhe një ushtar e hapi
4 derën. Ne hymë në oborr.".

5 4600 hyri në derë dhe kjo vërtetohet nga një hollësi në
6 një provë materiale - që ne do t'jua tregojmë dhe ka numër
7 REG00-004 - ku dëshmitari përshkroi se kishte dy shigjeta, një
8 jashtë dhe shigjeta e dytë tregon kur futen brenda. Prandaj e
9 vendosi aty shigjetën. Dhe është në faqen 731, 23 shtator 2021
10 në këtë dëshmi.

11 Dëshmitari shpjegoi gjithashtu se pasi e ka dorëzuar të
12 burgosurin, ai ndenji në kompleks edhe për disa minuta të
13 tjera dhe pati një bisedë të shkurtër me Saliun. Dëshmitari
14 përcaktoi se Saliu mund ta shihte atë nga ku po rrinte. Dhe
15 këtë e keni në faqen 730, të të njëjtës dëshmi po atë ditë.

16 Në qoftë se e shikoni pamjen që keni në ekran, të
17 kompleksit, e shikoni se nga brenda oborrit, nga disa vende
18 mund ta shikosh shumë mirë ndërtesën ku ka qenë, ku janë
19 numrat 2 deri në 5. Nuk ishte vështirë që nga brenda oborrit
20 dëshmitari ta shikonte Salih Mustafën në ballkonin e
21 ndërtesës, sidomos, meqenëse, siç tha 4600 vetë, në faqen 733,
22 ndërtesa ishte e ngritur. Ishte lart nga hyrja e kompleksit.
23 Pra, po të ngrije sytë shikoje ndërtesën dhe ballkonin.

24 Dua të theksoj se kur dëshmoi 4600, Avokati i Mbrojtjes
25 nuk e kundërshtoi këtë dëshmitar për këto prova.

1 Pohimi i Avokatit të Mbrojtjes se ai nuk kishte si ta
2 shikonte Salih Mustafën është thjesht e pasaktë. Dëshmia e tij
3 lidhur me dorëzimin e viktimës së vrasjes dhe të parit së
4 Mustafës aty është e qartë, e besueshme dhe e provuar në
5 mënyrë të konsiderueshme.

6 Sepse ai shumë qartë e përshkroi largësinë nga vendi ku
7 rrinte Salih Mustafa në ballkon deri ku ai rrinte në oborr. Në
8 faqen 729 të transkriptit të 23 shtatorit, 4600 e vlerësoi
9 këtë largësi, këtë distancë, të ishte rreth 20, 30 metra. Në
10 fakt, është shumë e saktë në bazë të matjeve që ka bërë edhe
11 vetë Mbrojtja.

12 Ju lutem, tregoni në ekran DSM00388. Është një përshkrim
13 i kompleksit që e paraqiti Mbrojtja dje.

14 Dhe distanca besoj, që bazohej në një provë tjetër që
15 është DSM0035. Nuk ka nevojë ta tregojmë tani sepse distanca
16 është e njëjtë.

17 Siç e shikoni, distanca e vlerësuar në pjesën e djathtë
18 të fotografisë nga fundi në pjesën e poshtme deri lart është
19 41 metra. Pjesa e poshtme është pak a shumë ku ka qenë dera,
20 për sa i takon dispensës.

21 Pra, nga brenda oborrit, pasi hyn në oborr, pasi ka hyrë
22 në oborr dhe pasi ka parë Mustafën në atë që quhej si shtëpia
23 e familjes, në një distancë prej 30 metrash, mendoj që kjo
24 distancë e dhënë prej tij është shumë e saktë.

25 Përshkrimi i 4600 i shtëpisë përputhet edhe me mënyrën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 71

1 sesi vetë Salih Mustafa e ka përshkruar shtëpinë ku ka ndenjur
2 BIA dhe ai vetë, në deklaratën që i ka dhënë ZPS-së. Dhe,
3 4600, në faqen 732 të dëshmisë së tij në 23 shtator, aty thotë
4 që Mustafa ka qëndruar në ballkon që lidhej me tre katër
5 dhoma.

6 Kur përshkroi ndërtesën ku ai ka fjetur, Mustafa tha se
7 kishte tre dyer dhe një lloj tarrace. Këto i gjeni në 069404-
8 TR-ET, faqja [sipas përkthimit] 8, faqja 3 dhe 4.

9 Nëse, ju lutem, të shikojmë shpejt ndërtesën që tani
10 quhet si shtëpia e familjes. Mbrojtja ofroi një përshkrim më
11 të afërt të kësaj ndërtese.

12 Të shohim DSM00393.

13 Këto janë ato që Mbrojtja i ka përshkruar si shtëpia e
14 familjes. Këtu ka ndenjur, për mendimin tonë, Salih Mustafa
15 kur 4600 e ka sjellë viktimën në shtëpi dhe ku është
16 përshëndetur me Salih Mustafën.

17 Tani, dua që ta shohim këtë provë materiale përbri provës
18 materiale me numër REG00-005, që është një skicë e shtëpisë
19 vizatuar nga 4600, dëshmitari pra.

20 Është ekzaktësisht e njëjta ndërtesë.

21 Sikurse tha vetë Mbrojtja, Dëshmitari 4600 nuk e ka
22 sajuar nga mendja. Ndryshe do ta kishte bërë takimin më të
23 qartë, më të drejtpërdrejtë. Për shembull, duke e vendosur
24 Salih Mustafën tek dera. Por nuk e bëri këtë. Ai nuk e
25 zbukuroi dëshminë e tij. Ai tha atë që kishte ndodhur dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 72

1 pyeteni veten çfarë interesi mund të kishte ai për të shpikur
2 nga mendja që e kishte parë Salih Mustafën në kompleks? Cili
3 do të ishte motivi i tij për këtë gjë?

4 Ai nuk kishte arsye, të nderuar Gjykatës, që ta sajonte
5 nga mendja një dëshmi të tillë.

6 4600 përshkruan se e ka parë Salih Mustafën aty atë ditë
7 kur dorëzoi viktimën e vrasjes vetëm për një arsye, sepse kjo
8 është ajo që ka ndodhur.

9 Dhe këtu përfundoj parashtrimin tim për këtë pjesë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, z. Prokuror.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kemi dhe disa fjalë të tjera
13 për të thënë dhe Silvia D'Ascoli, kolegia, do të vazhdojë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit, keni fjalën kurdo që të jeni gati.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit shumë.

17 Të nderuar Gjykatës, do të flas për kundërshtimin e
18 Mbrojtjes lidhur me ndalimin arbitrar.

19 Çështja është e qartë. Dhoma e Apelit në çështjen 4 dhe 6
20 konfirmoi se Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë
21 juridiksion ndaj ndalimit arbitrar si një krim lufte i kryer
22 në një konflikt të armatosur jondërkombëtar sipas nenit
23 14(1)(c) të Ligjit. Mund t'ju jap referenca. Në rastin e
24 çështjes 4 është IAE-I4-IA [sipas përkthimit] paragrafi 47, i
25 KSC-BC-2020.

1 Dhe për çështjen tjetër 06, KSC-BC-2020, referenca është
2 IA-009-F-0030, paragrafi 86, 89, 94, 202 [sipas përkthimit],
3 106, 111.

4 Pra, shkurtimisht, nëse ndalimi arbitrar është krim që
5 hyn në juridiksionin e KSC-së a po jo nuk është më një çështje
6 për t'u diskutuar përpara Gjykatës.

7 Tani, dua të flas për përshkrimin e konfliktit të
8 armatosur.

9 Lidhur me konfliktin, llojin e konfliktit të armatosur që
10 është zhvilluar në prill 1999, parashtrimi i Prokurorisë se ka
11 qenë një konflikt jondërkombëtar i armatosur ka qenë i qartë
12 që në fillim. Akuzat, katër pikat e akuzës janë bërë në bazë
13 të nenit 14(1)(c) të Ligjit.

14 Po të lë mënjanë faktin se çdo kundërshtim i përcaktimit
15 të konfliktit të armatosur apo të akuzave është një sfidë
16 juridiksionale, gjë që Mbrojtja duhet ta kishte ngritur këtë
17 çështje me një mocion paraprak në bazë të rregullës 97, ka
18 disa pika që ne duam t'i ngremë që ju duhet t'i merrni
19 parasysh kur të vlerësoni argumentet e parashtruara nga
20 Mbrojtja për këtë çështje.

21 Së pari, krimet e pretenduara janë të gjitha shkelje të
22 rënda të nenit të përbashkët 3, i cili zbatohet sipas të
23 drejtës zakonore ndërkombëtare jo vetëm për konfliktet
24 jondërkombëtare por dhe atyre ndërkombëtare të armatosura pa
25 kufizim. Neni 3 është një matës minimal i mbrojtjeve që

1 zbatohen pavarësisht nga natyra e konfliktit.

2 Dhe mund t'ju japim edhe referenca për këtë. Mbase mund
3 të merrni parasysh jurisprudencën e Dhomës së Apelit të TPNJ-
4 së në çështjen Karaxhixh të datës 9 korrik 2009, çështja IT-
5 95-5/18-IR17.5 [sipas përkthimit] dhe paragrafi është 26.

6 Edhe nëse mund të ngrihet çështja e cilësimit të
7 konfliktit, që ne mendojmë se jo nuk duhet të ngrihet dhe, në
8 qoftë se Mbrojtja do të kishte dhënë indikacione të
9 mjaftueshme të një konflikti të armatosur ndërkombëtar, që nuk
10 e paraqiti edhe në këtë rast krimet e akuzuara janë përsëri
11 krime, krime që futen në juridiksionin e kësaj Gjykate.

12 Së dyti. Krimet e akuzuara që të gjitha kanë ekuivalencë
13 sipas nenit 14(1)(a)(i)(3i) [sipas përkthimit] dhe (4), këto
14 konsiderohen shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës që
15 zbatohen në një konflikt të armatosur ndërkombëtar.

16 Dhoma e Apelit të KSC ka konfirmuar se ndalimi arbitrar
17 dhe shkelje të tjera konkrete të numëruara nga këto vendime
18 janë shkelje të nenit të përbashkët 3. Dhe referencat janë të
19 njëjta si ato të jurisprudencës së Dhomës së Apelit që ju
20 dhashë më lart në kuadër të çështjes 06.

21 Së treti, Prokuroria ka provuar se bëhet fjalë për një
22 konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe mund t'ju referoj
23 dosjen përfundimtare të Prokurorisë të paragrafit 261, 288.

24 Mbrojtja nuk ngre ndonjë argument në mbështetje të faktit
25 se vetëm një konflikt i armatosur ndërkombëtar ka ekzistuar në

1 prill të 1999.

2 Dhe, së fundi, duke filluar nga 24 marsi në 1999 dhe, si
3 rrjedhojë, në prill të 1999, kishte një konflikt të armatosur
4 ndërkombëtar, po, që vazhdonte në Kosovë midis forcave të
5 NATO-s dhe forcave serbe. ZPS-ja nuk ka pretenduar kurrë
6 ndryshe.

7 Megjithatë, atë që Mbrojtja nuk merr parasysh është se
8 një konflikt i armatosur ndërkombëtar dhe një konflikt i
9 armatosur jondërkombëtar mund të bashkekzistojnë, mund të
10 ndodhin paralelisht dhe kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur
11 në kontekstin e Kosovës. Saktësisht ajo që kemi në prill të
12 1999. Dhe kjo është konfirmuar dhe konstatuar nga
13 jurisprudenca e TPNJ-së dhe ju referoj veçanërisht tek
14 konstatimi i TPNJ në të njëjtën çështje Xhorxheviç të
15 përmendur nga Mbrojtja. Por kësaj here nga Gjykata e Apelit.

16 Në gjykimin e Gjykatës së Apelit në Prokurori kundër
17 Xhorxheviçit, IT-05-87/1-A, aktgjykimi i apelit i 27 janarit
18 2014, paragrafi 521, Gjykata e Apelit ka thënë se mund të
19 ekzistojë një konflikt i brendshëm i armatosur njëkohësisht me
20 një konflikt ndërkombëtar të armatosur. Ky konstatim ka
21 treguar Dhoma Gjyquese ka marrë parasysh që ky konflikt në
22 Kosovë ishte një konflikt i brendshëm i armatosur që ka
23 ekzistuar në të njëjtën kohë me konfliktin ndërkombëtar të
24 armatosur midis NATO-s dhe forcave serbe.

25 Në lidhje me këtë, do t'ju referoja gjithashtu komentarin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 76

1 e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, lidhur me
2 paragrafët 402, 405 që komentojnë për nenin 3. Ky paragraf ka
3 përmbledhur qasjen e ndryshme që është pranuar si një koment,
4 duke përfshirë dhe një nga KNK-ja, lidhur me përfshirjen e
5 shteteve të huaja në një konflikt jondërkombëtar të armatosur,
6 duke e përfshirë edhe mundësinë e pasjes së dy konflikteve të
7 atij ndërkombëtar të armatosur dhe kombëtar të armatosur.

8 Gjithashtu, do t'ju referoja më tej jurisprudencën e
9 Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjen Prokurori kundër Latif
10 Gashit dhe të tjerë, me numër AP-139/2004 [sipas përkthimit]
11 vendimi i 30 korrikut, faqja 10 dhe një çështje tjetër të
12 Gjykatës supreme të Kosovës, Prokurori kundër Kolashinaç,
13 çështja me numër AP-Kz-230/2003, në faqen 21, 4 gusht 2004.

14 Tani të kalojmë te një temë tjetër.

15 Avokati i Mbrojtjes sugjeroi se BIA nuk ka ushtruar
16 kontroll ndaj kompleksit të ndalimit në Zllash. Prokuroria ka
17 paraqitur prova të mjaftueshme, që ka vërtetuar kontrollin e
18 ushtruar nga BIA. Dëgjuat dëshmitë e anëtarëve të BIA-s,
19 ndalimin e viktimave në kompleks; komandën e të akuzuarit ndaj
20 BIA-s që është diskutuar argumentet përmbyllëse të ZPS-së;
21 dëshminë e Dëshmitarit 4600 se kompleksi ruhej nga anëtari i
22 BIA-s, Shyti, kur ai dorëzoi viktimën e vrasjes; dhe, nga
23 dëshmia e Fatmir Sopit që tregoi se i gjithë kompleksi, si
24 kundër përmendet nga Prokuroria, ishte në fakt një qendër e
25 vërtetë ushtarake e ruajtur nga BIA.

1 Do kujtoj gjithashtu se ky kompleks ju dha UÇK-së nga
2 familja e dëshmitarit të Mbrojtjes Selatin Krasniqi dhe kjo ka
3 ndodhur në praninë e z. Mustafa.

4 A ka pasur dijeni i akuzuari se ç'ndodhte në kompleksin e
5 ndalimit në Zllash? Sigurisht që dinte.

6 Ai ka marrë pjesë në rrahje dhe ka pasur dijeni mbi çdo
7 gjë tjetër që ka ndodhur brenda kompleksit. Pala Mbrojtëse ka
8 nënvijëzuar vetë sesa i vogël ka qenë ky kompleks. Me një e
9 katërta e një fushe futbolli. Dhe ne e dimë që ai nuk ishte
10 një vend -- ishte në një vend i izoluar.

11 Rrahjet nuk ishin sekret në këtë kompleks, janë bërë
12 haptazi. Janë bërë jashtë në oborr, siç kemi dëgjuar nga
13 dëshmitë e dëshmitarëve. Në këtë kontekst, të nderuar
14 Gjykatës, të kujtojmë Dëshmitarin 04669 ku tha që viktima e
15 vrasjes është rrahur jashtë në oborrin e kompleksit të
16 ndalimit në Zllash.

17 Dhe kjo referencë gjendet në faqet 1434 deri në 1435.

18 Nga dëshmitë e paraqitura para këtij Trupi Gjykues, ne
19 dimë që viktima kanë treguar për klithmat e viktimave, atë që
20 dëgjohej. Klithmat, të cilat dëgjoheshin edhe nga ndërtesat e
21 tjera. Pra, i akuzuari, sigurisht, si komandant i BIA-s, që ne
22 e dimë që ka qenë atje në këtë kompleks dhe ka marrë pjesë në
23 ndalimin dhe në rrahjen e tjera, sigurisht që e dinte një gjë
24 të tillë.

25 Përpara se të përfundoj disa pika të tjera lidhur me

1 provat.

2 Së pari, Pala Mbrojtëse, për herë të parë në deklaratën e
3 tyre mbyllëse, tha që ZPS-ja ju ka treguar dëshmitarëve vetëm
4 një fotografi të vetme kur u ka kërkuar atyre për të
5 identifikuar ndërtesat ku janë mbajtur të ndaluar. Dhe Pala
6 Mbrojtëse tha që kjo ishte bërë në mënyrë sugjestionuese. Dhe
7 kjo gjendet, për shembull, në faqen 73 të transkriptit të
8 përkohshëm të ditës së djeshme.

9 Sigurisht që kjo çështje, së pari, duhej të ngrihej gjatë
10 seancës së gjyqit kur do të diskutohej dhe në seancat e
11 kundërpyetjeve. Po ta kishte ngritur gjatë gjyqit Pala
12 Mbrojtëse, atëherë ZPS-ja do të kishte paraqitur prova që
13 vijnë nga transkripti i intervistave me këta dëshmitarë, ku
14 tregohet që u kemi treguar atyre një numër fotografish. Jo një
15 të vetme siç pretendon Pala Mbrojtëse. Atyre u është treguar i
16 tërë albumi dhe nga albumi kanë përzgjedhur fotografi të cilat
17 ishin të ngjashme me ndërtesat ku ata thanë që i kanë sjellë
18 dhe i kanë ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash.

19 Pra, aktualisht kjo çështje duhet të shmanget nga Trupi
20 Gjykses për shkak se nuk është ngritur gjatë vetë gjyqit.
21 Megjithatë, këto intervista janë në dispozicion të Trupit
22 Gjykses. Ato kanë qenë në dispozicion të Palës Mbrojtëse gjatë
23 gjithë kohës së gjyqit. Dhe, në fakt, Pala Mbrojtëse ka cituar
24 një pjesë të këtyre intervistave gjatë seancës së mëngjesit,
25 pavarësisht se në mënyrë përzgjedhëse.

1 Dhe për procesverbalin, po jap numra rendor ku tregohet
2 që atyre i është dhënë një numër fotografish nga fillimi deri
3 në fund, që në fakt ishte 35 faqe e gjatë, pra, një që i është
4 treguar dëshmitarëve. Për shembull, 00807-TR-ET, Pjesa 1, që
5 është intervista e ZPS-së me një dëshmitar; pra, 100957-TR-ET,
6 Pjesa 1; dhe 082023-TR-ET, Pjesa 2.

7 Dhe, siç e tha kolegu im, z. Michalczuk, ka përmendur
8 faktin që identifikimi i këtyre ndërtesave është bërë gjatë
9 seancave të gjyqit këtu në praninë e Palës Mbrojtëse, kështu
10 që nuk do të flas më lidhur me këtë çështje.

11 Çështja e dytë që doja të sqaroja po kështu është kjo.
12 Dje, Pala Mbrojtëse përmendi deklaratën edhe intervistën edhe
13 për Mbrojtjen dhe për ZPS-në, të z. Adem Shehu. Dhe kjo është
14 faqja 101 të transkriptit të përkohshëm të ditës së djeshme.
15 Megjithëkëtë, z. Shehu nuk ka qenë dëshmitar në këtë çështje.
16 Ai nuk ka ardhur për të dhënë dëshmi para Trupit Gjykses dhe
17 as nuk janë pranuar si prova deklaratat e tij.

18 Megjithëkëtë, thelbi i argumentit të Palës Mbrojtëse
19 lidhur me z. Shehu dhe rolin e tij në trajnimin e kadetëve të
20 rinj do t'u referohet, të nderuar Gjykatës, në kundërpyetjet
21 që i janë bërë z. Halimi, ku dëshmitarit i është paraqitur
22 fakti që në deklaratat e tij për Palën Mbrojtëse kishte thënë
23 që z. Shehu ishte trajnuesi kryesor dhe ka marrë pjesë në
24 seancat e trajnimit.

25 ERN e deklaratës së z. Halimi për Palën Mbrojtëse është

1 DSM00539 deri në 00550, faqe 9 dhe pasazhet përkatëse për
2 dëshminë e z. Halimi para Trupit Gjykues janë në transkriptin
3 3993 deri në 3997 më datën 23 prill 2022.

4 Por, në përgjithësi lidhur me trajnimin, ne themi që
5 dëshmitari i Mbrojtjes Musli Halimi erdhi për të diskretituar
6 dëshminë e 1679 dhe 4669 dhe, në fakt, i ka mbështetur ato në
7 shumë aspekte dhe këto do t'i gjeni në dosjen përfundimtare të
8 ZPS-së. Do t'u referohet, të nderuar Gjykatës, në paragrafët
9 54 dhe poshtëshënimet e këtij paragrafi.

10 Si përfundim, të nderuar Gjykatës, barra e provës së
11 kësaj çështjeje i takon Prokurorisë. Dhe kjo nuk diskutohet,
12 për këtë nuk ka diskutim. Pala Mbrojtëse nuk ka barrë prove
13 për të provuar.

14 Megjithëkëtë, në këtë çështje Pala Mbrojtëse, ka ofruar
15 argumente dhe prova të cilat Trupi Gjykues mund t'i marrë
16 parasysh. Dhe në shqyrtimin e këtyre provave dhe argumenteve,
17 Trupi Gjykues duhet po kështu të analizojë se çfarë ka
18 kundërshtuar dhe çfarë nuk ka kundërshtuar Pala Mbrojtëse.

19 Avokatët e Mbrojtjes kanë kaluar një kohë të gjatë duke
20 folur për dëshmitë e dëshmitarëve të Prokurorisë, përshkrimin
21 e ndalimit të tyre, torturës, ndërtesave. Megjithëkëtë duhet
22 të mbajmë parasysh që nuk kanë trajtuar çështje për të cilat
23 nuk ka përgjigje. Për shembull, mospranimi i të akuzuarit
24 lidhur me praninë e tij në Zllash, në kompleksin e ndalimit në
25 Zllash, atë që ai vetë ka pranuar lidhur me rolin, rolin që ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 81

1 luajtur që ai vetë ka thënë ishte -- siç e kemi dëgjuar dhe
2 aftësinë e dëshmitarëve për të treguar që z. Mustafa kishte
3 qenë i pranishëm në atë kompleks përfshirë edhe identifikimin
4 e ushtarëve të tjerë të BIA-s të cilët kanë qenë në kompleksin
5 e ndalimit në Zllash.

6 Elementet të cilat nuk i ka trajtuar Pala Mbrojtëse, për
7 shembull, ishte dhe lista e të burgosurve dhe shënimi aty për
8 Calin, shënimi që kishte bërë Cali. Dhe po përmend një
9 shembull që ju paraqit sërish gjatë mëngjesit të sotëm. Për sa
10 i përket listës së burgosurve, për shembull, Pala Mbrojtëse
11 pretendon që nuk ka provë që viktima e vrasjes të jetë dërguar
12 apo të ketë qenë i pranishëm në kompleksin e ndalimit në
13 Zllash përpara W1679.

14 Një dokument, në fakt, lista e të burgosurve është
15 përgjigje për këtë. Është një përgjigje, e cila është në
16 përputhje me dëshminë që ka dhënë para Trupit Gjykses
17 Dëshmitari 1679.

18 Këto janë disa dëshmi të cilat nuk trajtuar dhe sipas
19 mendimit të ZPS-së, kjo ka ndodhur për shkak se nuk ekziston
20 një përgjigje.

21 Dhe, si përfundim, të nderuar Gjykatës, Prokuroria e ka
22 provuar barrën e saj të provës, ka provuar përtej dyshimit të
23 arsyeshëm që i akuzuari është fajtor për të gjitha krimet e
24 Aktakuzës dhe ne i kemi të gjitha këto të paraqitura gjatë
25 gjyqit dhe gjatë deklaratave përfundimtare dhe në dosjen

1 përfundimtare të ZPS-së.

2 Këtu përfundojnë komentet e mia, Trupi Gjykses, ju
3 falënderoj për vëmendjen tuaj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit, znj. Prokurore.

6 Mbrojtësja e Viktimave, a dëshironi kohë për t'u
7 përgatitur, duke pasur parasysh ato që ka përmendur apo duke
8 pasur parasysh përgjigjet e ZPS-së, apo mund të filloni
9 menjëherë?

10 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne jemi të
11 gatshëm të fillojmë menjëherë. Kemi marrë shënime dhe do të
12 përqendrohëm në përgjigjet ndaj prezantimeve të mëngjesit të
13 sotëm nga Pala e Mbrojtësve. Dhe nuk besoj se dua më shumë se
14 20 minuta, kështu që mund të përfundojmë në kohën e duhur në
15 orën 13.00. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit. Mbrojtësja e Viktimave, ju e keni fjalën.

18 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Më lejoni të filloj me një aspekt që e dëgjuam në fund të
20 deklaratës mbyllëse të Palës Mbrojtëse, që ishte hera e parë,
21 që i akuzuari, përmes deklaratës së avokatëve të tij, ka
22 pranuar ekzistencën e viktimave dhe vuajtjet e tyre. Ne e
23 mbajmë shënim. Dëgjuam që atij i vjen keq për ta dhe kjo për
24 mua është një çështje të cilën e mbaj shënim në mënyrën
25 serioze.

1 Ne kemi dëgjuar një numër argumentesh të interpretimit
2 ligjor të ligjit si dhe të dokumenteve provuese. Unë do të
3 përgjigjem vetëm lidhur me disa argumente ligjore
4 shkurtimisht.

5 Prokuroria ka treguar deri më tani, që si pikënisje duhet
6 të marrim parasysh faktin që ishte një konflikt i armatosur
7 jondërkombëtar dhe duhet të mbajmë parasysh që vendimin e
8 Gjykatës së Apelit në rastin Xhorxheviç. Dhe nga ana ime, unë
9 mendoj, që jemi pikërisht në një situatë të tillë ligjore ku
10 shqyrtojmë si udhëzues ligjet që zbatohen në rastin e një
11 konflikti jondërkombëtar, pra, për të përcaktuar se çfarë
12 është e çfarë nuk është krim lufte.

13 Po kështu, kemi edhe vendimet e Dhomave të Specializuara
14 të Kosovës lidhur me ndalimin arbitrar si krim lufte.

15 Shkurtimisht, disa komente, lidhur me argumentet ligjore
16 lidhur me interpretimet që ka bërë pala Mbrojtëse, pra, për
17 t'i hedhur ato poshtë, nga pikëpamja ime, për shkak se unë e
18 kam bërë të qartë në deklaratën time myllëse gjatë ditës së
19 djeshme, sesa e rëndësishme është për viktimat që krimi i
20 ndalimit arbitrar të pranohet që është një dhunim serioz i të
21 drejtave të njeriut.

22 Avokati Mbrojtës, për shembull, propozoi që ndalimi
23 arbitrar për shkakun se nuk ishte i paraqitur në mënyrë të
24 qartë në nenin 14(1)(c), por problemi është që kemi fjalën
25 "përfshirë" në përkufizimin e nenit 14(1)(c), ku thuhet në

1 mënyrë të qartë që kjo listë nuk është shteruese.

2 Kemi dëgjuar në Palën Mbrojtëse kur ju përmendi shkarazi
3 çështjen e legalitetit. Por ligji i Kosovës e përfshin të
4 drejtën zakonore ndërkombëtare. Kjo është e qartë. Dhe kjo
5 është paraqitur në tërë ligjin mbi Dhomat e Specializuara të
6 Kosovës, kryesisht në nenin 12 të tij. Dhe më tej, për sa i
7 përket terminologjisë së të drejtës civile, është shumë e
8 thjeshtë që parimi i kodifikimit *nulla poena sine lege scripta*
9 përkufizon që përfshirja e së drejtës zakonore është e
10 zbatueshme.

11 Nuk është e zbatueshme në Kosovë. Por kushtetuta duhet ta
12 ndalonte këtë në mënyrë shumë të qartë kur thuhet në nenin
13 3(1) të saj që nuk është -- që edhe pavarësisht akteve të
14 cilat nuk ishin pjesë të veprave penale në kohën kur janë
15 kryer, janë ato krimet e gjenocidit, krimeve të luftës dhe
16 krimet kundër njerëzimit.

17 Ndalimi arbitrar është një dhunim shumë i rëndë i së
18 drejtës humanitare ndërkombëtare. Më lejoni të përmend se
19 përse.

20 Kush mbrohet në nenin e përbashkët 3 të Konventave të
21 Gjenevës? Është ky nen, i cili është pjesë e të gjithë së
22 drejtës humanitare ndërkombëtare, është kuti matës kur bëhet
23 fjalë për rregullimin e konflikteve jondërkombëtare, për shkak
24 se e drejta humanitare ndërkombëtare fillimisht nuk ka pranuar
25 faktin që mund të kishte konflikte të brendshme

1 jondërkombëtare.

2 Referenca është ndaj personave të cilët nuk marrin pjesë
3 aktive në luftime. Pra, ky është nocioni se kush gëzon
4 mbrojtjen më të madhe, për shkak se në rastet e konflikteve
5 jondërkombëtare ndodh shpesh që janë civilët të cilët marrin
6 armët.

7 Në këtë rast, secila prej viktimave gëzon mbrojtje, pasi
8 nuk kanë marrë pjesë në luftime dhe ishin civilë. Pala
9 Mbrojtëse ka sugjeruar se ndoshta për shkak se disa ishin
10 trajnuar nga UÇK-ja, kjo do të nënkuptonte që mund të mos e
11 gëzonin këtë mbrojtje. Kjo ligjërisht është e gabuar.

12 Vetëm kur ka pjesëmarrje aktive në luftime, që nuk është
13 rasti këtu. Këtu bëhet fjalë për njerëz të cilët nuk kanë
14 marrë armët, njëri ka marrë pjesë në një vend stërvitjeje, që
15 nuk është pjesëmarrje aktive; një tjetër është përpjekur për
16 t'u anëtarësuar në UÇK, por është arrestuar. Po është e qartë,
17 tejet e qartë të gjithë gëzojnë mbrojtjen e nenit të
18 përbashkët 3.

19 Neni i përbashkët 3 dhe të gjitha ndalimet që nuk janë
20 përfshirë dhe që janë krime lufte që të gjitha synojnë që të
21 mbrojnë dinjitetin njerëzor. Edhe, njëherë, po përmend
22 Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, që mbrojtja
23 kundër ndalimit arbitrar është një nga -- në thelb të
24 mbrojtjes që në kohën kur është formuluar Deklarata Universale
25 e të Drejtave të Njeriut, ajo mund të gjendet që në momentin e

1 formulimit të saj dhe është pjesë e të gjitha instrumenteve
2 kryesore të së drejtës ndërkombëtare humanitare, neni 4 i
3 Konventës Ndërkombëtare të Së Drejtave Civile dhe Politike.

4 E drejta ndërkombëtare humanitare nuk pushon së zbatuari
5 në momentin kur fillon një konflikt jondërkombëtar. E drejta
6 humanitare ndërkombëtare shërben si *lex specialis* kur nuk
7 ekzistojnë dispozitat të posaçme që rregullojnë konfliktin e
8 armatosur.

9 Mbrojtja kundër arrestimit arbitrar nuk pushon së
10 ekzistuari. Është në thelb të së drejtës humanitare dhe asnjë
11 nga rregullat bazë të konflikteve të armatosura ndërkombëtare
12 nuk sugjerojnë një gjë të ndryshme. Kjo është diçka që është
13 shumë serioze.

14 Unë po i përmend këto argumente si shtesë të atyre që
15 janë dëgjuar për shkak se mendoj se është e rëndësishme që ta
16 nënvijëzojë në mënyrën më të plotë.

17 Kemi dëgjuar dhe, tani po i kthehem një çështjeje tjetër,
18 argumentin lidhur me çështjen e trajtimit mizor dhe nëse ai
19 ishte pjesë e torturës apo mënyra sesi është formuluar
20 Aktakuza në këtë drejtim dhe ku qëndrojnë këto dy vepra
21 penale.

22 Këtu bëhet fjalë për një akt të torturës. Dhe unë nuk dua
23 të diskutoj që marrja në pyetje, së bashku me rrahjet, nuk
24 përbën torturë. Kjo është torturë sipas torturës klasike. Këtu
25 kemi pyetje, "Përse je këtu?" pse po rrihesh, po digjesh, po

1 ka stimulime ekzekutimesh, "Kush janë hajdutët?" e kështu me
2 radhë që çdo gjë -- të gjitha këto përbëjnë torturë. Si mund
3 të jetë ndryshe tortura?

4 Po kemi momente kur keqtrajtimi mizor nuk është
5 konsumuar. Atëhere pas këtyre rrahjeve ke thyerje të
6 gjymtyrëve, ke plagë të hapura, të hedhin në ahur të ftohtë
7 dhe të lënë pa kujdes mjekësor, ky është trajtim mizor.

8 Dhe kemi kështu, pra, në këtë rast trajtim mizor pa
9 torturë, por kemi në mënyrë të hapur trajtim mizor i cili
10 është një vepër penale dhe duhet të jetë një pikë e veçantë e
11 Aktakuzës.

12 Edhe një aspekt tjetër i natyrës aprovuese së provës.

13 Pala Mbrojtëse po sugjeron, ose siç e kam kuptuar unë
14 argumentin e tyre, është që nuk ka pasur viktimë, që s'kishte
15 ndodhur asgjë, ndërkohë që tani sugjerimi është që diçka mund
16 të ketë ndodhur por mund të ketë ndodhur në një vend tjetër.

17 Shkurtimisht, dua të them që duhet ta trajtojmë në tërësi
18 provën apo provat, duhet t'i shohim në tërësi provat dhe të
19 gjitha elementët e tyre. Nuk kërkohet që secili dëshmitar të
20 mund të identifikojë se ku ishte ky vend. Për sa i përket për
21 shembull, Dëshmitarit 3953, kur erdhi në këtë ndërtesë ai
22 kishte një thes në kokë. Por kur u lirua ai ishte në gjendje
23 që të përshkruante se ç'rrugë kishte marrë.

24 Dhe t'i referohem shkurtimisht dëshmisë së tij në faqen
25 608, 609 të transkriptit, ku përshkruan që kishte parë që

1 ishte një rrugicë e vogël, jo rrugë shumë e mirë. Dhe rruga e
2 mirë erdhi më tutje, kur kaluam në një livadh. Dhe na kujtohet
3 fotografia që kemi parë gjatë gjithë gjyqit, është pikërisht,
4 është ajo rruga të cilën ka marrë për të shkuar në rrugën që
5 të dërgonte për Prishtinë.

6 Pak më vonë, në të njëjtin paragraf, ka dhënë një
7 shpjegim personal dhe nuk dua ta jap në hollësi pasi nuk dua
8 të kalojë në seancë private. Por, të nderuar Gjykatës, kur të
9 analizohet transkripti në faqen 609, ai ka shpjeguar se përse
10 e njihte mirë këtë zonë. Dhe ka dhënë një shpjegim të qartë.

11 Këta janë elementë të vegjël, por që të gjithë krijojnë
12 një pamje më të gjerësishme. Dëshmitari 1679 nuk ka shpjeguar
13 shumë mirë sesi ishte ky vend. Por ajo që ka bërë është që
14 ishte 20 minuta nga shkolla në Zllash deri aty. Dhe këtë do
15 gjeni në transkript -- mund ta jap referencën pak më vonë po
16 të jetë e domosdoshme, por ishte pjesë e dëshmisë së tij para
17 Trupit Gjykses. Dhe këta janë të njëjta 20 minuta që i ka
18 paraqitur edhe Pala Mbrojtëse, pra, për të ilustruar faktin që
19 kjo ishte largësia nga -- deri tek ai vend në Zllash.

20 Kombinojeni këtë me kartat e identitetit dhe dokumentet e
21 tjera të cilat bëjnë ndërlidhjen midis vendit, kompleksit ku
22 ishte mbajtur viktima e mbrojtjes dhe, po të merren këto në
23 tërësi të kombinuara, që të gjitha të çojnë tek ky vend ku ka
24 ndodhur çdo gjë në Zllash.

25 Dhe, pika e fundit, lidhur me personat e pranishëm.

1 Është e vërtetë që jo të gjitha viktimat kanë qenë në
2 gjendje që të japin një listë të njerëzve dhe jo çdo viktimë
3 ka përshkruar të njëjtin grup njerëzish që kanë qenë të
4 pranueshëm, por kjo ndodh në kujtesën e njerëzve, në kujtesën
5 e secilit person pasi kanë kaluar 20 vite. Të gjithë juristët
6 penalë e dinë që duhet të arrijmë të nxjerrim thelbin nga
7 elemente apo të vërteta subjektive.

8 Secili prej nesh ka variantin e tij apo saj të vërtetës
9 mbi një ngjarje të caktuar. Dhe thelbi është ku të gjitha kanë
10 përputhje, përputhen njëra me tjetrën. Dhe aty arrijmë, që nga
11 ky thelb së bashku me këto të vërteta subjektive, të arrijmë
12 në elementet objektive, siç është lista e të burgosurve dhe
13 kështu arrij tek rrëfimi i përbashkët.

14 Po të kombinohet kjo me efekte të traumës, me kujtesën e
15 cila nuk është lineare në kohë për disa dëshmitarë bëhet e
16 qartë se arrijmë në përgjithësi që të kemi një argument të
17 fuqishëm, të qëndrueshëm. Ndërkohë, që veçimi i një pjese të
18 kufizuar në mënyrë përzgjedhëse nga dëshmitë nuk të krijon
19 këtë pamje të përgjithshme, në të cilën të gjitha viktimat
20 kanë qenë pjesë e kësaj çështjeje dhe në mënyrë të vërtetë
21 kanë treguar atë që ka ndodhur. Kjo e gjitha ka ndodhur
22 pikërisht në këtë kompleks të ndalimit në Zllash.

23 Shoh që referenca ime 1679 mund të gjendet në faqen 980
24 të transkriptit, në rreshtat nga 1 deri në 8. Kjo sa për
25 referencë, të nderuar Gjykatës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 90

1 Dhe këtu, po i përfundoj komentet e mia që kam lidhur me
2 përgjigjen që ka dhënë Pala Mbrojtëse. Faleminderit për
3 vëmendjen tuaj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit, Mbrojtësja e Viktimave.

6 Tani është pothuajse ora 13.00. Sa për të planifikuar,
7 Avokati Mbrojtës, pas pushimit të drekës sa kohë do t'ju duhet
8 për të dhënë përgjigjen tuaj ndaj komenteve që bëri ZPS-ja dhe
9 Mbrojtësja e Viktimave?

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Maksimumi 30 minuta.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Atëhere vazhdojmë me planifikimin siç e kemi parashikuar në
13 urdhrin për rendin e ditës. Tani do të marrim pushimin e
14 drekës deri në orën 14.30.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

16 --- Seanca rifillon në orën 14.31

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se jeni kthyer përsëri.

19 Sot pasdite do të fillojmë me komentet e Mbrojtjes ndaj
20 përgjigjeve të Prokurorisë. Pastaj do të diskutojmë pyetjet e
21 Panelit, nëse ka. Dhe pastaj do të dëgjojmë deklaratat
22 përmbyllëse të Mbrojtjes dhe të Avokates së Viktimave lidhur
23 me zhdëmtimet nëse kanë.

24 Në varësi të ecurisë së mbasdites, sot mund ta mbyllim
25 çështjen ose nesër.

1 Por për momentin fjalën e ka Avokati i Mbrojtjes.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar
3 Gjykatëse.

4 Sa për të bërë një koment të përgjithshëm, të nderuar
5 Gjykatës. Desha të them se nuk trajtuam ndonjë çështje të
6 veçantë, që do të thotë se nuk mund t'i diskutosh të gjitha.
7 Jo sa për t'u shfajësuar. Nuk mund t'i argumentosh të gjitha,
8 por kjo s'do të thotë që nëse nuk e përmend një temë të
9 caktuar në veçanti, kjo do të ishte e pakundërshtuar.

10 Sigurisht, në një çështje penale e rëndësishme është të
11 dalë e vërteta dhe ne mendojmë se për ta bërë këtë përpjekje
12 të zgjedhim ato tema që na duken sa më të rëndësishme për ta
13 bërë të qartë çështjen. Dhe ne mendojmë se e bëmë këtë.

14 Gjëja e parë që dua të ngre është ajo që ZPS-ja tha
15 lidhur me motivimin e dëshmitarëve. Dhe në veçanti motivimin e
16 dëshmitarëve të Mbrojtjes.

17 Nuk e di, por gjithmonë nxirret ndonjë supozim apo mendim
18 që kur ka një -- vjen një dëshmitar i Mbrojtjes, nuk është i
19 besuar sepse janë nga UÇK-ja, apo nga BIA. Edhe nëse nuk janë
20 prej tyre, mund të kenë ndonjë arsye apo motiv të veçantë për
21 të thënë diçka që të favorizojnë z. Mustafa.

22 Nëse i marrim dëshmitarët e Mbrojtjes, këta ishin njerëz
23 të thjeshtë që kanë jetuar gjatë konfliktit ashtu si e kanë
24 përjetuar. Kështu dhe diskutuan, për këto diskutuan dhe
25 asnjëherë nuk dëgjova gjatë dëshmisë së tyre që për shembull,

1 ZPS-ja ka bërë ndonjë mocion për të kundërshtuar diçka që do
2 të kishte thënë një dëshmitar.

3 Ishte interesant për shembull, më kujtohet në një rast,
4 se kur ZPS-ja e vodhi, por është një term i përgjithshëm dua
5 të them, e mori Fatmir Humollin si dëshmitar i Mbrojtjes dhe e
6 bëri të sajën dhe gjatë kohës së pyetjeve ata filluan që të
7 kundërshtonin besueshmërinë e z. Humolli, që në atë kohë ishte
8 dëshmitar i vet. Nuk e di pse, por mbase ngaqë dëshmitari tha
9 diçka që nuk i përshtatej çështjes së Prokurorisë.

10 Megjithatë, mendoj se dëshmitarët kanë dëshmuar për një
11 vend ndalimi. Këtë kanë bërë dëshmitarët e ZPS-së në fakt.
12 Vendi i ndalimit është një pikë qendrore në çështjen tonë, që
13 ne mendojmë që nuk është vendndodhja e Zllashit, sikurse
14 paraqitet nga Prokuroria. Është një problem që e kemi pas
15 gjatë gjithë çështjes. Dhe besoj që kalimi nga Prokuroria
16 tregon -- ndryshimi nga Prokuroria i vendit, tregon se i
17 akuzuari duhet ta di se përse akuzohet, por dhe *locus delecti*
18 është pikë qendrore në çdo çështje penale. Kështu është fjala
19 edhe këtu, me çështjen që po diskutojmë.

20 Tani, e kemi shprehur qëndrimin tonë për ndryshimin e
21 vendit që bëri Prokurori dhe e shpjegova gjerë e gjatë. Vura
22 në dukje një numër pikash në dosjen paraprake në kohën që do
23 të konfirmohej Aktakuza dhe më vonë. Nuk dua që të merrem më
24 me këtë pikë. Për ne është e qartë se ka ndodhur një ndryshim
25 i vendit lidhur me ndërtesat që kemi parë në çështjen e

1 paraqitur nga Prokuroria.

2 Çështja e alibisë. Sipas Prokurorisë, alibia e Mbrojtjes
3 nuk është një alibi, sepse ai nuk ka qenë në ndonjë vend të
4 huaj apo dëshmitarët e Mbrojtjes thonë që ka qenë ose në
5 Zllash, ose përreth Zllashit, apo ka pasur qasje të përdorte
6 një makinë, ose mund ta shohim edhe në hartat në Google,
7 largësia. Gjëra të tilla ka paraqitur.

8 Por, të nderuar Gjykatës, është një perceptim i keq i
9 situatës që ekzistonte në atë kohë. Z. Mustafa, vetëm në një
10 rast mendoi që dëgjua dikë që të fliste që ai shkoi me makinë
11 nga Barilevë në Rimanishtë dhe pastaj vazhduan ose në këmbë
12 apo diçka e tillë.

13 Gjithsesi, nuk mund të thuhet se gjatë gjithë kohës
14 kishte mundësi të përdorte makinë. Nuk mund të nxirret një
15 përfundim i tillë nga provat.

16 Kujtoj, për shembull, se në një moment z. Humolli
17 deklaroi se shkoi nga Prishtina në këmbë deri në Barilevë dhe
18 pastaj u ndanë. Z. Humolli vazhdoi më tej në Llapashticë dhe
19 aty përfundoi. Pra, nuk mund ta pranoj supozimin se vetëm 31
20 km larg është, kështu që është e lehtë të shkosh e të vish.

21 Ne dëgjua dëshmi në gjykatë dhënë nga njerëz të cilët
22 thanë se sa të vështira ishin kushtet. Njerëzit ishin dëbuar
23 nga shtëpitë e tyre. Sigurisht situata në dhe përreth
24 Prishtinës, Barelëves, Zllashit dhe kështu me radhë, është
25 krejtësisht e ndryshme nga ajo që ne mund të shohim tani. Dhe

1 Prokurori tha: Rrugët janë përsëri të njëjtat, janë aty akoma.
2 Por, ai nuk mori parasysh postblloqet për të cilat folën disa
3 dëshmitarë, apo të gjithë situatën e vështirë duke pasur
4 parasysh zhvendosjet e brendshme të njerëzve të cilët ishin në
5 lëvizje gjatë asaj kohe. Pra, faktorë të tillë apo forcat
6 serbe që vendosen në garnizone. Ne dëgjuam për vështirësitë e
7 kalimit në Barilevë ku njerëzit në një moment duhej të
8 zhvendoseshin, të kalonin rrugë dytësore.

9 Sa për të dhënë një ide të përgjithshme të rrethanave të
10 kohës. Duke pas parasysh këtë situatë nuk mund të thuash që,
11 "Z. Mustafa nuk ishte në Zvicër apo në një vend tjetër që nuk
12 shkonte dot aty", siç tha Prokuroria. Pra, në këtë mënyrë s'ka
13 ndonjë alibi. Në fakt alibi do të thotë se mund të jesh diku
14 gjatë. Jo patjetër të jesh në një vend tjetër për të
15 paraqitur një alibi si mbrojtje apo për të thënë që të kesh
16 njerëz që të vinë e të thonë që e pashë këtë person në filan
17 vend.

18 Pra, dëshmitarët e Mbrojtjes kanë demonstruar qartësisht
19 se sa herë që ishte në Butovc, Prishtinë apo në zonat urbane
20 Barilevë, këto zona pra, për të cilat ata dëshmuar se e kanë
21 parë në një kohë të caktuar. Kjo është për sa i takon alibisë
22 të ngritur nga Mbrojtja, këto doja të thoja.

23 Po, tani do të trajtoj çështjen e ngritur nga Prokurori de
24 Minicis lidhur me Dëshmitarin 4600, vendin ku ai ishte, ku e
25 pa z. Mustafa në vendin e ndalimit në Zllash.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 95

1 Në këtë drejtim dua të them se nuk spekuloj për ndërtesat
2 që e pengonin shikimin. Unë po them atë që tha dëshmitari. Për
3 ta thënë këtë dua të citoj dëshmitarin në 23 shtator 2021,
4 faqe 732. Dhe për reference mbase do të ishte e dobishme.

5 I kërkoj Punonjësës së Gjykatës të paraqesë në ekran
6 dokumentin, më duket është me numër 072909, po. Që është
7 diskutuar në atë seancë gjyqësore asokohe.

8 Mendoj se mbase duhet të kalojmë në seancë private.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
10 kalojmë në seancë private.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

6 Pra, po diskutoj dëshmitarin 4600, deklaratën e tij dhënë

7 në 23 shtator 2021. Dhe shkëmbimin që zhvillohet si më poshtë

8 në faqen 732. Pyetja që bëhet është:

9 "Ku është vendi në këtë skicën ku Komandant Cali të
10 përshëndeti?"

11 Dhe përgjigja është:

12 "Nga kjo pjesa këtu."

13 Pastaj pyetja:

14 "Faleminderit shumë. Ju keni qenë në këmbë. Mund të
15 shënoni me të njëjtin stilolaps vendin ku keni qëndruar ku
16 ndodhi ky shkëmbimi i fjalëve?"

17 Përgjigja është:

18 "Po, ne ishim këtu tek porta."

19 Faleminderit shumë. Pra, unë besoj se është e qartë ajo
20 që ka treguar dëshmitari.

21 Dhe pastaj Prokurori ka thënë, dhe kjo gjendet në
22 transkript në faqen 61 a në faqen 11 [sipas përkthimit].

23 "Avokati i Mbrojtjes nuk e kundërshtoi këtë dëshmitar për
24 këtë provë."

25 Ne nuk e kundërshtuam, të nderuar Gjykatës, por kjo s'ka

1 rëndësi nëse e kundërshtuam apo jo deklaratën. Dëshmitari
2 thjesht tha se ku po qëndronte në kohën që ndodhi ky shkëmbim.
3 Nuk ka ndonjë gjë të madhe për të kundërshtuar. Ai e shënoi
4 dhe e tha sikundër sa po e citova.

5 Pastaj është çështja e llojit të konfliktit të armatosur.
6 Mbrojtja mendon kështu si vijon.

7 Nuk është çështje juridiksioni. Është çështje e cilësimit
8 të një krimi sipas nenit 14(1)(c)(1). Nuk ka mundësi që
9 ndalimin arbitrar ta fusim në këtë kuti, sepse ky nen nuk
10 parashikon për këtë krim në paragrafin apo nën-paragrafin e
11 përmendur në aktakuzë. Pra, nuk është aspak çështje
12 juridiksioni.

13 Megjithatë, do të ishte e mundur, me gjasa, sipas nenit
14 15 të Ligjit dhe bëhet fjalë për kodin e Republikës Socialiste
15 të Jugosllavisë që renditet në nenin 15 të Ligjit të Dhomave
16 të Specializuara të Kosovës. Janë krime të tjera sipas Ligjit
17 të Kosovës.

18 Pra, cilësimi i konfliktit të armatosur nuk është çështje
19 juridiksioni për shkak se neni 14(1)(b) parashikon bazën
20 ligjore të një akti të kryer në kuadër të një konflikti të
21 armatosur ndërkombëtar. Ndërsa ZPS-ja thjesht bëri akuzë në
22 bazë të nenit 14(1)(c) dhe jo në bazë të nenit 14(1)(b) të
23 Ligjit.

24 Çfarëdo që të ketë thënë Dhoma e Apelit kjo nuk është
25 aspak çështje juridiksioni, por thjesht çështje e cilësimit të

1 një krimi sipas ligjit.

2 Atëherë, të nderuar Gjykatës, konflikti i armatosu me
3 karakter ndërkombëtar apo jo dhe bashkekzistenca e konfliktit
4 të armatosur ndërkombëtar dhe jo ndërkombëtar.

5 Është thjesht një qasje teorike nga ZPS-ja. Fakti është
6 se territori i konfliktit është në kuadër të Republikës
7 Federale Socialiste të Jugosllavisë pa bërë ndonjë dallim. Ka
8 një dallim të qartë midis të dyve kur palët ndërluftuese janë
9 nga vende të ndryshme në kohën e aktakuzës, që është në rastin
10 tonë dhe që lufta zhvillohet në territorin e RFSJ-së. Momenti
11 kur forcat e huaja të armatosura bëhen pjesë e teatrit të
12 operacioneve të themi të fushëbetejës, atëherë nuk mund ta
13 cilësojmë më, në këtë rast, si një konflikt i armatosur
14 jondërkombëtar.

15 Dhe po, në të vërtetë kemi të bëjmë me një situatë në
16 1998 kur kishte një konflikt të armatosur me karakter
17 jondërkombëtar. Dhe këtë duam të themi, që nga 24 mars e këtej
18 ky konflikt i brendshëm pushoi se ekzistuari. Dhe që nga ai
19 moment mori karakter ndërkombëtar të armatosur. Dhe
20 jurisprudenca e TPNJ-së kryesisht flet për çështje që kanë të
21 bëjnë me 1998 e jo me 1999 dhe jo për prillin e 1998 [sipas
22 përkthimit]. Të paktën jo tek Xhorxheviç.

23 Pastaj, kjo ka të bëjë me diçka që unë do ta quaja pak si
24 futje në kurth. Një person i quajtur Muhamet Ajeti,
25 vazhdimisht përmendet me emrin Shyti, por ai s'tha asnjëherë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 99

1 që e quanin Shyti. Ai tha Shyt Mareci, e quanin. Në qoftë se
2 dikush tjetër e quan Shyti, nuk vjen nga ai. Nuk është vendimi
3 i tij, nuk e pranon ai këtë gjë. Nëse dikush e pranon, është
4 puna e tij. Nëse është në regjistrin e z. Mustafa kur thuhet
5 "Shyti AAK", pra ndryshe Shyti.

6 Pra, gjithmonë ta përmendësh Muhamet Ajetin me Shyti,
7 askush s'e ka përcaktuar apo provuar, as dëshmitari 4600 nuk
8 ka provuar që Muhamet Ajeti është personi që në fakt është
9 Shyti. Nuk ka prova për këtë gjë.

10 Dhe meqë ra fjala Dëshmitarin Muhamet Ajetin e pyetën
11 nëse kishte pritur njeri në kompleks. Ai tha, jo.

12 Edhe njëherë, identifikimi i 4600 për personin që ia
13 dorëzoi viktimën e vrasjes, ai person nuk është identifikuar
14 kurrë prej tij. Thjesht u dha një emër dhe kaq. Ne nuk dimë
15 asgjë tjetër më shumë se kaq për atë person. Dhe nuk mund t'ia
16 ngjisim emrin. Mbase në shumë vende mund të thuhet se në qoftë
17 se përdor këtë apo atë emër, emri që përdoret, s'do të thotë
18 që ai emër ka parasysh atë person të caktuar në atë kohë.

19 Pastaj, çështja e asaj hartës. Në materialet që kam
20 parë, nuk kam parë ndonjëherë një fotografi të plotë të hartës
21 që t'i jepet dëshmitarëve nga e cila ata të mund të zgjidhnin
22 diçka. Nuk kemi parë në transkript ndonjë gjë të tillë ku të
23 thuhet se, "Dëshmitari e pa këtë fotografi dhe tha këtë dhe
24 atë gjë". Nuk kemi parë një gjë të tillë. Vetëm se kanë
25 komentuar për një foto të caktuar dhe rrjedhimisht është ajo

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 100

1 që me siguri iu është treguar atyre për të komentuar.

2 Nuk kam nevojë fare ta ngre këtë çështje në gjykatë.

3 Thjesht nuk do bëj punën e Prokurorisë. Unë analizoj atë që
4 thotë dëshmitari. Dhe për hatër të argumentit, edhe po ta
5 kishim bërë këtë po t'i kishin parë të gjitha fotografitë, në
6 fakt janë gjithmonë të njëjtat ndërtesa që dalin.

7 Në këtë drejtim atë që tha Mbrojtja është kjo.

8 Dëshmitarëve nuk u është dhënë mundësia të zgjedhin. Siç thamë
9 përpara, shumë prej tyre dhe e shpjegova me shumë hollësi
10 madje, kanë përshkruar vetëm pjesën e brendshme të një stalle
11 apo hauri dhe asgjë për sa i takon pjesës së jashtme. Le më
12 pastaj për të thënë se iu është dhënë mundësi të zgjedhin të
13 marrim vendime për to.

14 Adem Shehu. Nuk diskutohet që ky zotëri ka ardhur në fund
15 të marsit. Nuk e kemi dëgjuar vetë, kemi dëgjuar për të nga të
16 tjerë Sopi, Musli Halimi dhe të tjerë. Po të kishte qenë data
17 28 mars, atëherë gjithë kronologjia e ngjarjes, për sa i takon
18 kohës, lidhur me Dëshmitarin 1679 nuk do të përputhej dhe bie
19 ndesh me listën e të burgosurve ku tregohet një datë tjetër
20 për sa i takon këtij personi.

21 Ndërkohë këtë e ka thënë edhe z. Mustafa. Ka thënë që ka
22 qenë një ose dy herë dhe mbase kjo ka qenë gjatë periudhës së
23 evakuimit. Është një dallim i fortë të dëgjosh që shumë njerëz
24 thonë se ai ka qenë shumë i zënë duke larguar, duke evakuuar
25 të plagosurit nga kompleksi në atë kohë dhe ndërkohë ky njeri

1 do të kishte pas një axhendë të dyfishtë duke ditur që ka
2 pasur njerëz që kanë qenë në kushte shumë të këqija dhe që t'i
3 kishte lënë atje. Kështu që kjo në vetvete nuk ka logjikë, nuk
4 përkon me deklaratën për shembull të Teuta Hadrit, Fatmir
5 Humollit, Ibadetes në momentin që ata flisnin për evakuimin.

6 Parashtroj më tej që për shembull Nuredin Ibishi e të
7 tjerë, janë dëshmitarët që i kanë marrë -- nuk e di se si e
8 kishte emrin ky vendi në mes -- Orllan, në mos gaboj. Orllan e
9 kishte. Dhe që i ka shoqëruar deri në Potok. Dhe të gjithë
10 këta na shpjeguan që ishte një rrugëtim, një udhë shumë e
11 vështirë për t'u bërë. Nga ana tjetër, ky është një tjetër
12 shembull se sa të vështira ishin kushtet.

13 Z. Parduzi dhe z. Ibishi ishin të plagosur. U deshën dy
14 ditë që të shkonin deri në Potok, kjo për të thënë se sa të
15 vështira ishin situatat.

16 Duke menduar që Barileva është vetëm 31 km larg, besoj që
17 nuk është një përshkrim dhe cilësim i drejtë i vështirësive me
18 të cilat janë hasur njerëzit në atë kohë.

19 Më pas, së fundmi, të nderuar Gjykatës, thujse kam
20 përfunduar, por në fund dua të trajtoj çështje të cilat u
21 ngritën nga znj. Avokate e Viktimave. Gjegjësisht faktin që
22 neni 14(1)(c) përmbledh akte dhe që lista në vetvete nuk është
23 shteruese. Kjo është ajo çfarë tha Avokatja e Viktimave në
24 faqen 75, rreshti 4.

25 Të nderuar Gjykatës, ne nuk mund të kemi një situatë ku

1 themi që për shkak të faktit që lista në vetvete nuk është
2 shteruese, ne mund të fusim edhe ndalimin arbitrar tek lista,
3 meqë ajo nuk është shteruese. Nuk e bëjmë dot këtë gjë. Nuk
4 mund të themi që mund të fusim edhe këtë vepër për shembull,
5 në këtë paragraf ose në këtë nën-paragraf. Këtë gjë nuk e
6 bëjmë dot sepse do të shkonte shumë përtej fushës së veprimit
7 të nenit përkatës. Thjesht duhet ta shohim, duhet ta gjejmë
8 dhe duhet ta shohim nëse ekziston, për shembull, i përmendur
9 ndalimi arbitrar. Edhe, ose është i pranishëm, ose nuk është.
10 Në rastin konkret nuk është dhe nuk kemi pse e komplikojmë më
11 tej. Ky është qëndrimi i Mbrojtjes lidhur me këtë.

12 Sa i takon parashtrimin tjetër të Avokates së Viktimave
13 që kemi të bëjmë me torturë dhe trajtim mizor, unë në fakt i
14 dhashë të gjitha shpjegimet për të gjithë dëshmitarët lidhur
15 me atë se si janë trajtuar ata, çfarë vuajtjesh kanë pësuar
16 dhe të gjitha shembujt i kam marrë njëri pas tjetrit. Ja u
17 bëra atë me dije. Por, unë nuk mora ndonjë informacion konkret
18 se për çfarë qëllimi të posaçëm është bërë kjo gjë edhe për
19 çfarë bëhej fjalë më konkretisht. Dhe nuk dëgjova konstatime
20 të Avokates së Viktimave lidhur me këtë.

21 Besoj se Avokatja e Viktimave theksoi më tepër llojet e
22 ndryshme të vuajtjeve. Dhe me shumë lloje vuajtjesh e kanë
23 kaluar viktimat dhe në qoftë se kjo të çon në trajtim mizor
24 apo torturë, ose të dyja, unë këtë gjë nuk e pata të qartë nga
25 ajo që parashtroi Mbrojtja e Viktimave. Mbrojtja ka thënë që

1 është e nevojshme që të provohet krimi i torturës.

2 Të nderuar Gjykatës, këto ishin konstatimet që unë kam.

3 Kam përfunduar këtu me konstatimet e miya dhe ju falënderoj

4 shumë për vëmendjen.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Shumë faleminderit, Avokati i Mbrojtjes.

7 Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga Trupi Gjykses, në

8 qoftë se ka.

9 Me sa di unë nuk kishte pyetje, por ndoshta nga komentet
10 e fundit mbase kolegët kanë ndonjë pyetje.

11 Jo, nuk kanë.

12 Mirë atëherë, mund të vazhdojmë me deklaratën përmyllëse
13 të Mbrojtjes së Viktimave sa i takon zhdëmtimeve.

14 Fjala për ju Avokatja e Viktimave.

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 Ne kemi diskutuar gjerësisht përgjegjësinë e të akuzuarit
17 tani për krimet që kanë ndodhur. Në këtë parashtrim unë do të
18 diskutoj për pretendimet për zhdëmtim në kuadrin e çështjes
19 aktuale.

20 Ajo çfarë do të bëj është që së pari do jap disa komente
21 paraprake dhe më pas do të bëj një përmbledhje të shkurtër të
22 proceseve që kanë të bëjnë me zhdëmtimet për të krijuar
23 mjedisin për të diskutuar argumentet ligjore. Më pas do të
24 diskutojmë efektet ligjore të mungesës së angazhimit të
25 Mbrojtjes, sa i takon zhdëmtimit. Dhe së fundmi do të them

1 disa komente lidhur me zbatimin e të drejtës së viktimave për
2 zhdëmtimin.

3 Për publikun edhe për të qëndruar në seancë të hapur, unë
4 nuk do të jap informacion individual. Informacioni individual
5 është bërë në parashtrimet me shkrim dhe për rrjedhojë nuk
6 mendoj se më duhet t'i përsëris ato të cilat janë parashtruar
7 me shkrim.

8 E drejta për zhdëmtim është një e drejtë themelore për
9 viktimat e krimit, në veçanti për ato viktimë që kanë qenë
10 objekt i shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut dhe shkelje
11 të rënda të së drejtës humanitare. Kjo e drejtë për zhdëmtim
12 është e mishëruar në të drejtën ndërkombëtare, është e
13 reflektuar në rendet juridike të brendshme dhe është e
14 garantuar edhe në Ligjin për themelimin e Dhomave të
15 Specializuara të Kosovës.

16 Ajo zbatohet për viktimat e drejtpërdrejta dhe tërthorta
17 të krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari: për krime të
18 luftës të ndalimit arbitrar, trajtimi mizor, tortura dhe
19 vrasja janë ndërmjet krimeve më të rënda.

20 Çfarë lloj zhdëmtimi kërkojnë viktimat? Koncepti i
21 zhdëmtimeve është i gjerë. Ai përfshin masat të ndryshme, për
22 shembull njohja e vuajtjes së viktimave ose mund të jetë edhe
23 një kërkim publik faljeje, ose mund të përfshijë edhe zhdëmtim
24 kolektiv. Megjithatë, zhdëmtimet mund të jenë edhe të natyrës
25 individuale dhe mund të përfshijnë edhe të drejtën për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 105

1 kompensim ose për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar
2 individëve.

3 Viktimat në këtë çështje. Së pari, shpresoj që të shohin
4 dhe t'ju dëshmohet që vuajtjet e tyre njihen dhe kjo të mund
5 të bëhet nëpërmjet marrjes së një vendimi dhe drejtësia të
6 vihet në vend. Ky është një element i rëndësishëm për ta.

7 Në këtë pikë dëshiroj të përfitoj nga rasti të theksoj se
8 të gjitha viktimat në këtë çështje e kuptojnë se shumë, shumë
9 njerëz kanë vuajtur gjatë luftës në Kosovë. Janë bërë masakra
10 të ndryshme të cilat kanë qëndruar në thelb të luftës. Forcat
11 serbe kanë persekutuar shqiptarët e Kosovës, kanë ushtruar
12 dhunë seksuale, pastrim etnik e të tjera. Dhe kjo është
13 panorama e përgjithshme e cila nuk duhet të harrohet. Kjo
14 është shumë e rëndësishme për t'u mbajtur mend sepse viktimat
15 janë shumë të ndërgjegjshëm për fatkeqësitë që kanë pësuar për
16 të cilat akoma nuk është dhënë llogari edhe sot e kësaj dite.
17 Dhe ata shpresojnë që drejtësia do të vihet në vend për shumë
18 e shumë viktimat të cilat nuk kanë pasur mundësi që çështja e
19 tyre të trajtohej.

20 Pavarësisht kësaj pengesat për t'ju përgjigjur kësaj
21 larmie të madhe krimesh të kryera nuk i heq të drejtat e
22 viktimave në këtë çështje. Ata duan që gjykata t'ju njoh që
23 ndaj tyre është bërë një padrejtësi. Kjo gjykatë në fakt është
24 shpresa e fundit për viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje për
25 të parë që drejtësia do të vihet në vend për krimet e kryera

1 ndaj tyre.

2 Edhe pse e dimë nga tribunale të tjerë se zhdëmtimet
3 kolektive janë të mundura edhe kur viktimat mund të
4 identifikohen si grup viktimash, në rastin në fjalë viktimat
5 duan që të trajtohen individualisht pasi krimet që ata kanë
6 pësuar janë përjetuar në nivel individual. Këto trajtohen në
7 parashtrimet me shkrim tonat dhe dua të theksoj që ky dëm
8 është i pa tjetërsueshëm dhe nuk do të çojë në kthimin e
9 jetëve të humbura. Është shumë e rëndësishme që të njihen
10 vuajtjet e tyre dhe të merret kompensim.

11 Tani më lejoni të bëj një përmbledhje të shkurtër të
12 argumenteve.

13 Që prej deklaratës hyrëse e në vijim, ne e kemi bërë
14 pozicionin tonë të qartë që pretendimet për zhdëmtim duhet që
15 të bëhen në kuadrin e këtij gjykimi dhe, të nderuar Gjykatës
16 Trupi Gjykues, shikoj opsionin në mënyrë të tillë që
17 zhdëmtimet të mund të ofroheshin nga gjykatat vendore në
18 Kosovë. Tre ekspertë dhanë mendimet e tyre sa i takon përvojës
19 me zhdëmtimet në gjykatat në Kosovë. As në këtë pikë dhe as në
20 një fazë më të vonë, Mbrojtja nuk është përfshirë në mënyrë të
21 përnjëmend për pikat e bëra për argumentet e nxjerra ose me
22 faktet e paraqitura. Mbi bazën e këtyre raporteve ne me të
23 drejtë mendojmë që u mor vendimi që pretendimet për zhdëmtim
24 të mund të trajtoheshin në kuadër të kësaj çështje. Të nderuar
25 Gjykatës, ju keni qenë shumë transparent nga fillimi sa i

1 takon nxjerrjes së vendimeve dhe keni lënë Mbrojtjen në çdo
2 moment që të japë strategjinë e vet që të bëjë argumentet dhe
3 gjithashtu edhe të përgatisë për gjyqet për pretendimet për
4 zhdëmtim.

5 I akuzuari dhe Mbrojtja kanë qenë të informuar për këtë
6 pretendim që në fillim fare. Kjo është një e drejtë e cila
7 parashikohet në nenin 22 të Ligjit dhe ne këtë qëndrim tonin e
8 kemi bërë të qartë që prej fillimit.

9 Kur Trupi Gjykues vendosi që të kryejë procese zhdëmtimi
10 si pjesë e kësaj çështje gjyqësore, që padyshim është qasja e
11 duhur sipas mendimit tonë, ne sugjeruam që Trupi Gjykues të
12 urdhëronte ekspertiza mjeko-ligjore në mënyrë që të mund të
13 zbulohet shkalla e dëmtimit që kishin pësuar viktimat e
14 drejtpërdrejta. Kjo çoi në një raport të hollësishëm para
15 gjykatës të ekspertizave. Ne gjithashtu sugjeruam që të
16 dëgjonim një ekspert ekonomik për të llogaritur humbjet dhe
17 dëmtimet. Kërkesa u miratua, eksperti u caktua dhe raporti
18 akt-ekspertiza tregoi se sa i madh ishte dëmtimi i akumuluar
19 ndaj viktimave në aspektin ekonomik.

20 Ky raport tregoi se në qoftë se dikush nuk është i aftë
21 që të punojë ose që të bëjë një punë apo që të zhvillojë jetën
22 e vet profesionale për shkak të demit, ky dëm akumulohet në
23 mënyrë masive, në mënyrë të jashtëzakonshme me kalimin e
24 viteve. Raporti përdori metoda për llogaritje të cilat
25 përdoren gjerësisht në sistemet civile ligjore europiane për

1 të matur dëmin ekonomik.

2 Siç është treguar nga eksperti dhe mbështetur në
3 standardet dhe në këto lloje llogaritjesh, ne e kuptojmë që ka
4 një nivel të lartë të aspekteve hipotetike të cilat kanë
5 ndikim mbi humbjen ekonomike dhe po ashtu duhen marrë parasysh
6 faktorë të tjerë si për shembull mosha dhe arsimi. Përveç
7 kësaj kemi paraqitur dhe fakte dhe argumente ligjore
8 mbështetur në jurisprudencën ndërkombëtare për të mbështetur
9 pretendime konkrete për zhdëmtimet. Qëndrimi ynë është që të
10 gjitha viktimat pjesëmarrëse kanë të drejtë që të marrin
11 zhdëmtim. Në këtë linjë ne kemi vërejtur -- në fakt në të
12 gjithë procedurën që është vërtetuar që të gjitha viktimat e
13 tërthorta kishin një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me një
14 viktimë të drejtpërdrejtë në këtë çështje.

15 Në fakt, vetëm të hënën e kësaj jave Dhoma e Apelit e
16 Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare nxori një vendim për çështjen
17 Ntaganda, që në fakt është shumë e rëndësishme sa i takon
18 zhdëmtimit. Viktima e tërthortë ka të drejtë që të marrë
19 zhdëmtim për dëmin e pësuar nga një viktimë e drejtpërdrejtë.
20 Kjo u citua edhe në çështjen e përmendur më sipër. Në qoftë se
21 kemi një lidhje të rëndësishme ndërmjet viktimës së tërthortë
22 me atë të drejtpërdrejtë, në këtë rast i takon që viktima e
23 tërthortë ka të drejtë që të marrë zhdëmtim.

24 Të gjitha viktimat e tërthorta kanë dhe dëshmi lidhur me
25 lidhjen e tyre të veçantë dhe të ngushtë me viktimën e vrasjes

1 dhe për rrjedhojë cilësohen për të drejtën për të marrë
2 zhdëmtim. Kanë të drejtë që të marrin zhdëmtim.

3 Ndërmjet argumenteve të tjera të ngritura, ne
4 argumentojmë, të nderuar Gjykatës, që pretendimet për
5 zhdëmtime janë bazuar në një standard që është më i mundur
6 sesa jo, për sa i takon asaj çfarë kanë vuajtur viktimat. Sa i
7 takon parashtrimeve të konsoliduara, ne shpjeguar bazën për
8 shumat individuale të zhdëmtimit. Ne propozojmë që Trupi
9 Gjykues të mund të vlerësojë secilën prej pretendimeve në
10 qoftë se vendos që i akuzuari është fajtor dhe të mbështetet
11 në tri shtylla kryesore: Gjetjet, për sa i takon dëmtimeve siç
12 janë parashtruar nga ekspertizat ligjore. Shtylla e dytë është
13 jurisprudenca ndërkombëtare. Dhe së treti, legjislacioni i
14 Kosovës, në veçanti Ligji 04-L054 dhe është ligji që ka të
15 bëjë me viktimat civile dhe anëtarët e familjeve të tyre gjatë
16 luftës.

17 Ky është një ligj i cili ofron udhëzim se çfarë të
18 drejtash kanë personat të cilët janë lënduar gjatë luftës. E
19 kuptoj që kjo ndoshta nuk e ka vendin shumë qartë aty,
20 megjithatë mendoj që në qofte se do t'i shikojmë në mënyrë
21 akumulative të tre këto shtylla, na ofrohet një bazë e mirë
22 ligjore për të përcaktuar se cila do të ishte një masë
23 proporcionale zhdëmtimi, duke marrë parasysh ashpërsinë e
24 shkeljeve dhe dëmtimet e shkaktuara prej tyre. Viktimat nuk
25 kërkojnë asgjë më shumë, asgjë më pak.

1 Këto parashtrime janë pjesë e proceseve për zhdëmtime të
2 cilat janë të kombinuara me gjykimin kundër të akuzuarit dhe
3 janë kryer pa asnjë paragjykim ndaj pafajësisë apo fajësisë së
4 të akuzuarit. Trupi Gjykues e bëri të qartë në vendimin e vet
5 të datës 4 shkurt 2022 për zhdëmtimin se këto procedura janë
6 objekt i fushës së veprimit të nenit 6(1) të Konventës
7 Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku viktimat dhe të
8 akuzuarit janë pjesë e këtij procesi gjyqësor.

9 Dhe këtu ndodhemi në këtë pikë, me parashtrime të
10 hollësishme në emër të viktimave pjesëmarrëse për të
11 mbështetur pretendimet për zhdëmtime. Me akt-ekspertiza që
12 duhet të vërtetojnë se cila është masa e dëmit të shkaktuar.
13 Ndërkohë nga ana e Mbrojtjes nuk kemi asgjë.

14 Mbrojtja vendosi që të mos angazhohej fare në procedurat
15 për zhdëmtim, deri tani. Sipas meje kjo është një model për
16 injorimin e viktimave, është një tipar i cili ka përshkruar të
17 gjithë procesin gjyqësor. Vetëm sot në fakt, neve dëgjuam
18 përmendjen e viktimave nga të akuzuarit.

19 Modeli filloi që me mungesën e të akuzuarit gjatë
20 deklaratës së hapjes time si Mbrojtëse e Viktimave, vazhdoi më
21 tej me mungesën e dëshmive të viktimave në këtë çështje të të
22 akuzuarit.

23 Megjithëse i akuzuari kërkoi ndjesë për sjelljen e tij
24 fillestare për mua si avokate, megjithatë më duhet të them që
25 ky është një model sjelljeje që e kemi parë në të gjithë

1 procesin gjyqësor. Sipas mendimit tim ky është një sinjal që
2 ka një shpërfillje tërësore për viktimat.

3 Ndërkohë që Mbrojtja dhe i akuzuari mund të zgjedhin ta
4 bëjnë këtë gjë, se kjo është e drejta e tyre, ata e kanë
5 paraqitur çështjen e tyre lidhur me akuzat penale duke u
6 përpjekur që të kërkojnë pafajësi për të akuzuarin. Ndërkohë,
7 mosangazhimi me deklaratat e viktimave në këtë kontekst është
8 një strategji, një strategji që do parë se ku do të çojë. Por,
9 sa i takon perspektivës për pretendimin për zhdëmtim, mund të
10 thuhet që heshtja dhe mosangazhimi në këto procedura zhdëmtimi
11 si pjesë e çështjes më të madhe, duhet të ketë disa pasoja
12 juridike.

13 Më lejoni të jem e qartë sa i takon mosveprimit të
14 Mbrojtjes. Mbrojtja nuk bëri asnjë koment për asnjë nga
15 ekspertët e caktuar. Nuk bëri asnjë koment për ekspertizat e
16 tyre. Nuk parashtroi asgjë në përgjigjet e zhdëmtimeve të
17 konsoliduara të parashtrimit të konsoliduar për zhdëmtimet.
18 Dhe asgjë tjetër lidhur me zhdëmtimet.

19 Kur Trupi Gjyqës nxori vendimin për caktimin e ekspertit
20 financiar për të ndërmarrë hapat e tjerë procedurale për sa i
21 takon zhdëmtimeve me vendimin e datës 1 janar 2022, Trupi
22 Gjyqës parashikoi që Mbrojtja kishte 7 ditë për t'ju
23 përgjigjur kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave. Përsëri
24 Mbrojtja nuk bëri asgjë.

25 Sigurisht, nga strategjia e Mbrojtjes mund të arrijmë në

1 përfundimin, mund të deduktojmë, që i akuzuari ndërkohë që ai
2 në mënyrë aktive po shpërfill çdo përgjegjësi penale gjë e
3 cila zbatohet edhe për rastin e pretendimeve të zhdëmtimit.
4 Ndërkohë që ne këtë mund ta themi në parim, sa i takon pyetjes
5 në qoftë se duhet dhënë zhdëmtim apo jo, jo e njëjta gjë mund
6 të thuhet për aspektet e tjera specifike të pretendimeve. Këtu
7 e kam fjalën për parashtrime për pika të tilla, si për
8 shembull, të drejtën e të gjitha viktimave për sa i takon
9 pretendimeve për zhdëmtim si dhe fakte të cilat përcaktojnë
10 fushën e veprimit të pretendimit të bërë. Dhe këto nuk janë
11 vënë në pikëpyetje nga pala kundërshtare. Në qoftë se Trupi
12 Gjykses mbërrin në përfundimin se prova përpara tij tregon se
13 i akuzuari ka përgjegjësi penale, kjo mund të nënkuptojë që i
14 akuzuari ka plotësisht besim tek ju tek Trupi Gjykses për të
15 nxjerrë përfundimet e sakta nga secili prej raporteve të bëra
16 dhe për të marrë vendimin e saktë, sa i takon pretendimeve të
17 viktimave.

18 E drejta për proces me palë të ndryshme dhe proces të
19 rregullit ligjor sipas nenit 6(1) të Konventës Europiane,
20 kërkon që në çdo proces gjyqësor që palët të kenë njohuri dhe
21 të komentojnë për të gjitha provat e paraqitura si dhe për
22 konstatimet e parashtruara. Mbrojtja kishte njohuri të plotë
23 të të gjitha provave, të të gjitha parashtrimeve dhe
24 parashtrimet i kishte të gjitha në dispozicion dhe asaj iu dha
25 çdo mundësi e mundshme përgjatë rrugës që të parashtronte

1 konstatimet e veta dhe që të ofronte perspektivën e vet
2 juridike. Megjithatë, Mbrojtja për zgjedhi të mos e bënte një
3 gjë të tillë.

4 Nga këndvështrimi i Mbrojtjes, kjo është një zgjedhje që
5 ata ndoshta e kanë bërë në mënyrë të vullnetshme të
6 ndërgjegjshme. I takon çdo pale për të vendosur në qoftë se
7 një dokument i ofruar nga pala tjetër ose dëshmitë e dhëna nga
8 dëshmitarët, meritojnë komente apo jo. Palët ndërgjyqëse kanë
9 besim në proceset gjyqësore dhe mbështeten tek mundësia për të
10 ofruar qasjet e tyre dhe pikëpamjet e tyre. Ndërkohë që
11 Mbrojtja nuk e ka bërë një gjë të tillë mbështetur në afatet
12 kohore të parashikuara nga rregullore, është zgjedhje e tyre
13 me vullnetin e tyre dhe që duhet të respektohet. Megjithatë,
14 kjo është një sjellje që nuk është se vjen pa pasoja.

15 Shkurtimisht këtu sa i takon kuadrit ligjor të Dhomave të
16 Specializuara të Kosovës, rregulla 75, 76, dhe 9 e Rregullores
17 së Procedurës dhe Provave.

18 Çështjet rutinë, çështjet të cilat nuk janë
19 domosdoshmërisht komplekse, ato mund të argumentohen dhe mund
20 të vendosen me gojë. Megjithatë, në të kundërtën sugjerohet që
21 çështjet të cilat janë komplekse duhen të trajtohen me shkrim.
22 Dhe proceset e zhdëmtimit janë pa pikë dyshimi procese
23 komplekse. Si rezultat, proceset e zhdëmtimit janë kryer me
24 shkrim në përputhje me vendimin tuaj, të nderuar Gjykatës.

25 Ndërkohë, rregulli 76 i detyron palët, Mbrojtjen në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 114

1 rastin në fjalë, që të përgjigjet në një kërkesë për
2 zhdëmtimin brenda 10 ditësh nga dorëzimi i mocionit. Avokati i
3 Viktimave pastaj do të kishte mundësinë që të përgjigjej
4 brenda 5 ditëve të tjera, siç parashikohet në këtë rregull.
5 Çdo kërkesë për zgjatjen e kohës duhet që të ishin parashtruar
6 në kohën e duhur të mjaftueshme përpara se sa të mbaronte
7 afati përkatës.

8 Tani, sigurisht gabime mund të ndodhin. Të gjithë jemi
9 qenie njerëzore. Dhe ndonjëherë edhe afatet mund të kalohen.
10 Nuk ka dyshim lidhur me këtë. Megjithatë, në këtë rast
11 rregulla 9, paragrafi (5) ju jep juve, të nderuar Gjykatës, që
12 të merrni ose të mos merrni parashtrimet pas kalimit të afatit
13 kohor. Dhe në qoftë se Mbrojtja zgjedh që të bëjë një
14 parashtrim thelbësor për sa i takon fushëveprimin të
15 zhdëmtimit pasi ka injoruar të gjithë zhdëmtimet, për neve kjo
16 nuk është qëndrimi që duhet të kishte mbajtur mbrojtja.

17 Sepse Mbrojtja nuk ka treguar një shkak të arsyeshëm, nuk
18 është se ka nxjerrë në pah ndonjë gabim apo nuk ka ngritur
19 vështirësi që do ta pengonin Mbrojtjen që të përshihej më
20 përpara në proceset e zhdëmtimit. Thjesht duke pranuar që kjo
21 formë mospërbushje me rregullat do të cenonte punën e Dhomave
22 Speciale të Kosovës dhe siç do ta shpjegoj edhe pak më tej, do
23 të shkelte gjithashtu edhe standardet e drejtësisë së procesit
24 për viktimat në këtë çështje.

25 Është një parim i përgjithshëm në ligj që palët në

1 procese ligjore duhet të respektojnë afatet kohore të cilat
2 janë të përcaktuara për parashtrimet në gjykatë. Në fakt ky
3 është një parim që është shtylla kurrizore e një rendi juridik
4 të mirë. Palët duhet të respektojnë afatet kohore përndryshe
5 do të duhej që të thonë që ka arsye bindëse se pse nuk e bëjnë
6 parashtrimin në kohën e caktuar. Sepse në të kundërtën do të
7 ishte e pamundur që të bëhen procese gjyqësore në mënyrë
8 efikase, eficiente dhe të drejtë. Çdo argument që paraqitet
9 mbas kalimit të kohës pa arsye të qenësishme dhe të qëna, nuk
10 mund të pranohen.

11 E drejta për proces të rregullt ligjor shtrihet edhe për
12 viktimat si palë në procesin e zhdëmtimit. Në qoftë se një
13 palë në proces gjyqësor nuk angazhohet dhe nuk na lejon neve
14 që të përfshihemi në diskutime të balancuara dhe të drejta sa
15 i takon kundërshtimeve, atëherë kjo nuk të ndihmon. Dhe në
16 qoftë se nuk shprehet as lidhur me zgjedhjen e ekspertëve ose
17 metodën e punës së tyre, gjithsesi as kjo nuk ndihmon.

18 Në qoftë se ata zgjedhin sot që të angazhohen më në fund
19 me çështjen e zhdëmtimit, çdo argument, të paktën sipas nesh,
20 duhet që të bëhet në mënyrë *ad hoc*. Sepse do të ishte e
21 padrejtë për viktimat si palë në proces gjyqësor, do të ishte
22 dhe shkelje e nenit 6(1) të Konventës Europiane të Drejtave të
23 Njeriut. Dhe duke marrë parasysh edhe kohën që Trupi Gjyqësor
24 ka planifikuar për disa përgjigje, për shembull nuk do të kemi
25 mundësi që të mund të shqyrtojmë argumente për shembull me

1 ekspertët për çështje të caktuara të së drejtës të ligjit
2 kosovar ose të çështjeve që ndoshta do të ishin dashur që të
3 ishin ngritur me klientët.

4 Më lejoni që ta përmbledh duke thënë që faktet dhe
5 rrethanat që mbështesin zhdëmtimet, pretendime për zhdëmtime
6 dhe siç paraqiten nga ne, janë të pakontestueshme pavarësisht
7 nga fakti në qoftë se do paguhen ose duhet të jepet zhdëmtim
8 apo jo për viktimat. Ato duhet të trajtohen si të tilla. Për
9 rrjedhojë viktimat duhet që të marrin zhdëmtimet që kërkohen
10 në mënyrë të tillë që të kompensohet dëmtimi fizik mendor dhe
11 material që ata kanë pësuar, e kam fjalën këtu për viktimat e
12 drejtpërdrejta por gjithashtu edhe të kompensohen dhe viktimat
13 e tërthorta si rrjedhojë e krimeve për të cilat ka përgjegjësi
14 i akuzuari.

15 Tani një aspekt i fundit lidhur me zbatimin e
16 pretendimeve për zhdëmtime.

17 Është detyrimi ligjor i të akuzuarit të paguajë
18 zhdëmtimet, në qoftë se urdhërohet të bëjë këtë gjë.
19 Megjithatë, siç ndodh shpesh në raste të tilla, mund të jetë
20 shumë apo jashtëzakonisht e vështirë që të zbatohen urdhrat e
21 zhdëmtimit kundër të akuzuarit. Kjo do t'i linte viktimat me
22 një urdhër në letër por pa asnjë rezultat të prekshëm që mund
23 të bënte një dallim ose mund të sillte një ndryshim në
24 situatën e tyre.

25 Në Gjykatën Ndërkombëtare Penale ky problem është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 117

1 kompensuar përmes një Fondi Besimi për Viktimat. Një gjë e
2 tillë në fakt nuk ndodh në rastin e kësaj Gjykate.

3 Dua të përfitoj nga rasti që t'i bëj thirrje Qeverisë së
4 Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar për të siguruar që
5 viktimat do të kenë mundësi që të gëzojnë të drejtat e tyre
6 për zhdëmtim. Trupi Gjykues në fakt ndërmoi një hap të
7 lavdërueshëm për t'i shkruar Qeverisë së Kosovës dy herë, që
8 është e paprecedentë në natyrë dhe kërkoi gjithashtu
9 informacion për mundësinë për t'u siguruar që zhdëmtimi do
10 t'ju paguhet viktimave. Megjithatë, përgjigjet lanë paqartësi
11 dhe ndonjëherë ishin edhe në kundërshtim me atë çfarë kishin
12 thënë ekspertët edhe lidhur me zbatueshmërinë e ligjit.

13 Fondi për Kompensimin e Viktimave duket sikur është i
14 vetmi fond për kompensimin e viktimave të krimit. Mbetet e
15 paqartë në qoftë se viktimat në çështjen aktuale mund të
16 tërheqin ndonjë kompensim nga ai fond. Mbetet e paqartë edhe
17 nëse kompensimi do ishte i mjaftueshëm që të përmbushte
18 pretendimet që janë bërë për zhdëmtime. Megjithatë, ne do jemi
19 gati që të aplikojmë në emër të viktimave dhe do ta testojmë
20 kuadrin në qoftë se zbatimi kundër të akuzuarit nuk është i
21 suksesshëm.

22 Aktualisht i kërkojmë qeverisë dhe në mënyrë të veçantë
23 Ministrin të Drejtësisë të bëjë të mundur që të ekzistojnë
24 fonde të mjaftueshme që të vihen në dispozicion ose në kuadrin
25 e Fondit për Kompensimin e Viktimave ose ndonjë tjetër për të

1 mbështetur viktimat e kësaj çështje.

2 Do të ishte një sinjal shumë i fuqishëm i vullnetit të
3 mirë që viktimat të mos detyrohen t'i nënshtrohen procedurave
4 shumë të gjata për të marrë zhdëmtimet e tyre kundër të
5 akuzuarit pa pasur nevojë që të mbështeten në -- me vullnetin
6 e mirë të Ministrisë së Drejtësisë për ta bërë këtë.

7 Të theksoj këtu edhe përgjegjësitë që kanë shtetet për
8 viktimat e dhunimit të rëndë të të drejtave të njeriut.
9 Pavarësisht se Kosova nuk është palë e shumë konventave
10 ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të cilat janë në thelb
11 të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,
12 angazhimet detyrimet e tyre që ato kanë zbatohen përmes nenit
13 22 të Kushtetutës së Kosovës. Neni 22(8) përfshin në mënyrë të
14 hapur garancitë e Konventës Kundër Torturës. Kjo nënkupton që
15 të drejtat dhe detyrimet që përmban konventa zbatohen në
16 mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në rastet e konflikteve kanë
17 prioritet mbi legjislacionin vendor.

18 Konventa Kundër Torturës jo vetëm që mishëron ndalimin e
19 torturës por i jep të drejtën viktimave që të kërkojnë
20 zhdëmtim dhe vë përgjegjësinë përpara shteteve për të bërë të
21 mundur që viktimat t'i marrin këto zhdëmtime. Neni 14 i
22 Konventës Kundër Torturës është i qartë. Secila palë, çdo
23 shtet "duhet të bëjë të mundur që sistemi i tyre ligjor të
24 ketë mundësinë e adresimit të kompensimit të viktimave të
25 torturës. Në rastin e vdekjes të ndonjë viktime si rezultat i

1 një akti të torturës, fëmijët e tyre duhet të kenë të drejtën
2 e kompensimit”.

3 Nuk mund të thuhet më qartë. E drejta për kompensim që
4 është mishëruar në të drejtën ndërkombëtare ka prioritet mbi
5 legjislacionin kombëtar. Konventa Kundër Torturës i detyron
6 shtetet që ta zbatojnë atë. Republika e Kosovës duhet të bëj
7 të mundur që viktimat të marrin dëmshpërblimin e tyre.
8 Pavarësisht kuadrit ligjor, ne jemi të gatshëm që të japim
9 ndihmën viktimave dhe t’i mbështesim ato, për të bërë të
10 mundur që të bëhet një gjë e tillë, sapo të nderuarit e
11 Gjykatës të kenë nxjerrë vendimin e tyre dhe të dalë edhe
12 vendimi mbi zhdëmtimet.

13 Ne presim që qeveria të tregojë gatishmërinë për të
14 bashkëpunuar për të ndihmuar viktimat dhe ne do t’ju kërkonim
15 juve të nderuar Gjykatës që të bëni të mundur si gjykatë e
16 Kosovës që ta theksoni që kjo përgjegjësi është në duart e
17 shtetit.

18 Dhe si përfundim, ne i kërkojmë Trupit Gjykues që të
19 urdhërojë të akuzuarin të paguajë dëmshpërblim viktimave
20 pjesëmarrëse një nga një dhe të urdhërojë konfiskim të çdo
21 pasurie apo të ardhurash të cilat kanë ardhur si rezultat i
22 kryerjes së një krimi, në masën që ato eksitojnë, me qëllim që
23 ato të shiten dhe t’u jepen të gjitha viktimave.

24 Dhe me kaq e vetmja gjë që mbetet është që t’ju
25 falënderoj juve të nderuar Gjykatës për bashkëpunimin e gjerë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 120

1 që keni pasur me viktimat dhe me përpjekjet e Prokurorisë për
2 këtë çështje, si dhe me shumë të tjerë brenda Dhomave të
3 Specializuara të Kosovës të cilët kanë punuar në emër të
4 viktimave.

5 Ju falënderoj.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

8 Tani i drejtohem palës Mbrojtëse. Ju e keni fjalën për të
9 bërë deklaratën tuaj myllëse lidhur me zhdëmtimet.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara

11 Gjykatëse.

12 Z. Mustafa që në fillim i ka mohuar akuzat e ngritura
13 kundër tij dhe qëndrimi ynë është që ai duhet të shpallet i
14 pafajshëm. Dhe për këtë arsye ne nuk do t'ju përgjigjemi në
15 mënyrë thelbësore Mbrojtjes së Viktimave.

16 Kjo nënkupton qëndrimin e z. Mustafa që ai nuk ka kryer
17 asnjërën prej këtyre veprave penale të këtyre akuzave dhe nuk
18 ka dëmshpërblim për tu bërë këtu për viktimat. Kjo rrjedh nga
19 qëndrimi që kemi mbajtur ne gjatë kësaj çështje. Ky është
20 qëndrimi ynë.

21 Nuk kam çështje të tjera për të ngritur. Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit Avokati i Mbrojtjes.

24 Po hedh sytë nga kolegët për të parë nëse ka ndonjë
25 pyetje që duan t'i bëjnë Mbrojtjes së Viktimave. Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 121

1 Atëherë, tani do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore. Pak
2 më herët sesa kishim parashikuar. Dhe kur të kthehemi do të
3 përbylлим të gjithë këtë çështje, por së pari do të marrin
4 pushim.

5 --- Pauza fillon në orën 15.39

6 --- Seanca rifillon në orën 16.10

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 shoh që jemi të njëjtët palë, sa për procesverbal.

9 Ne i përfunduar deklaratat përbyllëse për të gjitha
10 çështjet. Tani dua t'i drejtohem të akuzuarit dhe ta pyes nëse
11 e konfirmon qëndrimin e tij se nuk do të përdorë të drejtën e
12 tij si pas rregullës 135(4) të Rregullores për të folur i
13 fundit?

14 Mund ta konfirmoni se nuk doni të flisni, sikur tha më
15 përpara avokati juaj i Mbrojtjes?

16 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, znj. Gjyqtare. Nuk
17 do ta shfrytëzoj këtë të drejtë për shkak se unë jam i bindur
18 që i kam thënë të gjitha në fjalën time hapëse që iu kam
19 drejtuar Panelit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit z. Mustafa. Tani e kemi në procesverbal se nuk do
22 ta ushtroni të drejtën tuaj për të folur i fundit.

23 A kanë ndonjë problem tjetër palët për të folur?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Asgjë nga ne.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Kam një pyetje. E di rregulloren që
3 parashikon kohën për diskutime edhe e kuptoj që është diçka
4 për të cilën nuk mund të jepni ende një përgjigje të qartë.

5 Por e di që ka njerëz aty që presin me ankth vendimet
6 tuaja dhe në një farë mënyre kam nevojë që t'ju përgjigjem
7 pritshmërisë së tyre dhe t'ju jap një përgjigje për atë që
8 mund të presin, nëse mund të më jepni një afat të përafërt
9 lidhur me vendimin.

10 E kuptoj që rregulli i përgjithshëm është 90 ditë, mund
11 të zgjatet. E kuptoj se gjithçka që ju mund të thoni do të
12 jetë e përkohshme. Por ngaqë kam një rol dhe duhet t'i jap
13 informacion këtyre njerëzve që kanë marrë pjesë, pres të bëjnë
14 pyetje. Kështu që, nëse mund të më jepni ndonjë përgjigje do
15 të isha shumë mirënjohëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

18 Avokati i Mbrojtjes, doni ndonjë gjë për të thënë?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të ngritur
20 nga ana jonë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
22 mirë. Faleminderit.

23 Po i kthehem përgjigjes.

24 Përpara se të mbyllim çështjen, u kujtoj palëve dhe
25 Avokates së Viktimave sipas rregullës 136, në këtë fazë nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 123

1 mund të bëhet asnjë parashtrim dhe asnjë provë materiale nuk
2 mund të paraqitet, vetëm me kusht që të mos ekzistojë ndonjë
3 arsye e fortë për këtë. Kjo nuk përfshin çështjet që duhen
4 shqyrtuar gjithmonë siç është paraburgimi.

5 Dua të falënderoj palët për kontributet e tyre,
6 përkthyesit, stenografët, personeli i sigurisë, të gjithë
7 stafin e zyrës administrative, të gjithë stafin e jashtëm për
8 ndihmën që kanë dhënë gjatë gjithë këtij gjykimi.

9 Dhe në momentin e duhur, e kam fjalën për ju Mbrojtësja e
10 Viktimave, Paneli do të nxjerrë një ditë kur do të japë
11 gjykimin në një afat të mjaftueshëm dhe gjithçka në këtë
12 çështje është parashikuar në Rregulloren e Procedurës të
13 Provave. Atëherë çështja mbyllet dhe seanca sot përfundon
14 këtu.

15 --- Seanca mbyllet në orën 16.15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25